

KONFERENCA SHKENCORE

“Ndërkommunikimet kulturore / ‘Ditët e Naimit’ dhe poeti kombëtar

Naim Frashëri”

Edicioni i XX, i Festivalit Ndërkombëtar të Poezisë “DITËT E NAIMIT”

20 VJET FESTIVAL

21 tetor 2016, Kodra e Diellit

SCIENTIFIC CONFERENCE

“Cultural Intercommunications / ‘Ditët e Naimit’ and the National

Poet Naim Frashëri”

20th Edition of the International Poetry Festival “DITËT E NAIMIT”

20 YEARS OF THE FESTIVAL

October 21st, 2016, Kodra e Diellit

Biblioteka: HEJZA

Redaktor: Shaip EMËRLLAHU

Recenzentë: Ndue UKAJ
Xhelal ZEJNELI

Këshilli botues

Ymer ÇIRAKU

Xhelal ZEJNELI

Ndue UKAJ

Xhuzepe NAPOLITANO

Niels HAV

Silke Liria BLUMBACH

Shaip EMËRLLAHU

Ballina: Majlinda KELMENDI

**‘DITËT E NAIMIT’ DHE POETI
KOMBËTAR NAIM FRASHËRI**

**‘DITËT E NAIMIT’ AND THE
NATIONAL POET NAIM FRASHËRI**

(Ndërkommunikimet kulturore / Cultural Intercommunications)



Ditët e Naimit
Tetovë, 2017

EDICIONET E PARA TË ISTORI E SHQIPËRISË DHE SHQIPËRIA NGA NAIM FRASHËRI JANË BOTUAR NË SOFJE, BULLGARI

Dr. Anton BAEV

*Shoqëria patriotike shqiptare “Dëshira” themelohet në vitin
1893 në hanin e Dhimitër Molesë*

*Zonja dhe zotërinj,
të dashur kolegë,*

më lejoni të ndaj me ju një fakt letrar jo aq të njohur për Naim Frashërin që e lidh me atdheun tim - Bullgari.

Më 1899, një vit para vdekjes së tij, shtëpia botuese Mbrothësia botoi librin e tij Istori e Shqipërisë dhe 3 vite më vonë veprën e tij Shqipëria. Deri atëherë, librat e Naimit u botuan në Stamboll, ku jetonte, dhe në Bukuresht - kryeqytetin rumun, që në gjysmën e dytë të shekullit XIX ishte një qendër letrare të vendeve ballkanike ende të paçliruara.

Po pse Bullgaria? Pse Sofja? Kujt i përkiste shtëpia botuese Mbrothësia? Kush në Bullgarinë e porsaçliruar do ta lexonte Naim Frashërin në shqip?

Lagjja Arnaut, fshati Arbanasi - këto janë toponime në Bull-

gari të lëna nga punëtorë mërgimtarë shqiptarë. Ardhja e tyre në Bullgari ndodhi në kohën e zgjerimit të Mbretërisë Osmane në perëndim.

Në gjuhën e re bullgare përdorim fjalë të huazuara nga shqipja, si fjalët кекав, кинта, скивам; келеш e të tjera.

Por mund të flasim për bashkësinë kulturore shqiptare vetëm pas çlirimit të Bullgarisë nga pushteti osman në vitin 1878, kur u vunë themelet e shtetit të ri bullgar. Leonid Grabotska, njëri prej ekspertëve më të mëdhenj të historisë shqiptare në Bullgari, shkruan: “Në këto rrethana shumë shqiptarë, veçanërisht nga jugu i Shqipërisë, nuk kishin paqe dhe nuk kishin mundësi për të fituar jetesën në vendin e tyre, kështu që emigruan në Bullgarinë e sapoçliruar, ku gjetën mikpritje dhe strehim nga populli mirëdashës bullgar.”

Idetë e vëllezërit Frashëri për Rilindjen shqiptare depërtuan fuqimisht mes punëtorëve mërgimtarë në Bullgari. Para çlirimit të Bullgarisë, ata dëgjuan vetëm për veprimtaritë e shoqërive shqiptare në Stamboll dhe Bukuresht, por nuk kishin asnjërinë në Sofje, kryeqytetin e ri bullgar.

Dy lokale u bënë qendrat e ngritjes shqiptare: kafeneja Shqypria, që u përkiste të dy poetëve Adam Shkaba dhe Spiro Garo, dhe hani i Dhimitër Molesë në rrugën “Serdika”, ku gjendej një pus me ujë mineral.

Moleja, i cili erdhi nga Bukureshti në vitin 1886, solli andej libra dhe gazeta në gjuhën shqipe për lexim nga mërgimtarët. Mësimi i gjuhës shqipe ishte i ndaluar në shkollë, ku gjuhët zyrtare ishin greqishtja dhe turqishtja.

Pako letrare në shqip filluan të vinin nga Stambolli dhe Bukureshti. Dhimitër Mole nuk ishte vetëm pronari i hanit, por u bë mësues për refugjatët shqiptarë. U themelua një shoqëri patriotike e quajtur Dëshira, e ngjashme me shoqëritë kulturore shqiptare në Stamboll dhe në Bukuresht.

Kjo ndodhi më 1 janar 1893 në hanin e Dhimitër Molesë.

Kryetari ishte mjeshtri murator Ligor Prifi Borova dhe sekretari ishte Dhimitër Mole i pashoq, që nuk dinte vetëm shqip dhe bullgarisht, por edhe gjermanisht dhe greqisht. U zgjodhën edhe këshilltarë dhe një arkëtar, kurse 53 anëtarë iu bashkuan shoqërisë. Njëri nga anëtarët ishte Spiro Garo, i ri dhe i zgjuar, i cili një vit më vonë u dërgua në Stamboll për të krijuar një lidhje me vëllezërit Sami dhe Naim Frashëri, me Jani Vreton, Vaso Pashën, Ismail Qemalin etj.

Spiro Garo u kthye i eksituar nga ato që dëgjoi nga anëtarët e shoqërisë Drita dhe takimet në Stamboll me Naim dhe Sami Frashërin. Nga Stambolli solli shumë libra dhe revista. Kështu Dëshira shqiptare në Sofje u lidh me vëllezërit e famshëm Frashëri.

Autoritetet bullgare e ndihmuan shoqërinë shqiptare, e cila u regjistrua në gjyq me një rregullore dhe një vulë.

Mbreti bullgar Ferdinand simpatizoi me luftimin shqiptar për çlirim dhe madje dërgoi dy të rinj shqiptarë në një shkollë ushtarake bullgare. Ata ishin Lek Margini nga Mirdita në veriun e Shqipërisë dhe Stefan Kandilari nga Korça në jugun e Shqipërisë. Përveç kësaj, mbreti ftoi profesorin Perikli Çilev për t'u mësuar djemve të tij - princit Boris dhe princit Kiril - gjuhën shqipe.

Veprimtaria arsimore e shoqërisë Dëshira vazhdoi deri në vitin 1940. Njëra nga nismat më të rëndësishme të shoqërisë ishte themelimi i një shtëpie botuese në Sofje me emrin Mbrothësia nën drejtimin e Kristo Luarasis.

Libri i parë shqip i botuar nga shtëpia botuese qe Ditërfenjësi (kalendar). Në vitin pasues, ky kalendar u botua nga Mit'hat Frashëri (i njohur edhe si Lumo Skëndo), djali i rilindasit shqiptar Abdyl Frashëri, vëllait të madh të Sami dhe Naim Frashërit. Kalendari atëherë u quajt Kalendari Kombiar dhe vazhdoi të botohej deri në fund të Luftës së Parë Botërore.

Dalëngadalë Sofja filloi të bëhej qendra e re e mërgimit shqiptar, ngaqë ishte vendi më afër vetë Shqipërisë. Bukureshti

dhe Stambolli ishin tepër larg. Lumo Skëndo drejtoi Kalendarin Kombiar dhe Shahin Kolonja gazetën Drita, që filloi të botohej në vitin 1901.

Shtëpia botuese Mbrothësia ka botuar shumë tituj, në mes të të cilëve mund të gjesh njërin nga librat më të famshëm për Rilindjen shqiptare: Shqipëria ç'ka qënë, ç'është e ç'do të bëhet nga Sami Frashëri. Ky libër u botua në Sofje në gjuhët turke dhe greke. U botua edhe drama Besa nga i njëjti autor, u përkthye në bullgarisht dhe u shfaq në skenë në teatrin "Bullgaria".

Mbrothësia, që përmenda në fillim të këtyre shënimeve të shkurtra, botoi edhe veprat e Naim Frashërit Istorja e Shqipërisë (1899) dhe Shqipëria (1902). Pas Luftës së Parë Botërore, shtëpia botuese u zhvendos për në Tiranë.

Shqipëria u çlirua në vitin 1912 gjatë Luftës Ballkanike. Bullgaria e mirëpriti dashamirësisht pavarësinë e Shqipërisë. Poeti i madh bullgar, revolucionari Peio lavorov u dërgoi një telegram autoriteteve shqiptare në Vlorë.

Në fund të Luftës së Parë Botërore, aktivistët më të njohur të Dëshirës, Mit'hat Frashëri, Dhimitër Mole, Kristo Luarasi, Kosta Jani Trebicka dhe të tjerë u kthyen në Shqipërinë e çliruar me shtëpinë e tyre botuese Mbrothësia.

Përktheu Silke Liria BLUMBACH

**THE FIRST EDITIONS OF ALBANIAN HISTORY AND ALBANIA
FROM NAIM FRASHERI ARE PUBLISHED IN SOFIA, BULGARIA**

Anton BAEV, PhD

*The Albanian patriotic society Dashira is established in 1893
in Dimitar Mole's tavern*

*Ladies and gentlemen,
Dear colleagues*

Let me share a not so famous literature fact about Naim Frasheri that connects him to my homeland - Bulgaria.

In 1899, a year before his death, the printing house Napredak (Progress) releases his book History of Albania and 3 years later his work Albania. Till that moment Naim's books had been printed in Istanbul where he lived and Bucharest - the romanian capital that during the second half of 19th century is a center of literacy of the not yet liberated Balcan countries.

But why Bulgaria? Why Sofia? Whose is the printing house Napredak (Progress)? Who is the newly liberated Bulgaria would read Naim Frasheri in albanian?

The Arnaut neighborhood, Arbanasy route - these are to-

ponyms in Bulgaria left from Albanian migrant workers. Their coming to Bulgaria concerns the time of the expansion of the Ottoman empire to the west.

In the new Bulgarian language we use borrowings from Albanian like the words кекав, кинта, скивам; келеш and so on.

But we can speak about the Albanian cultural community only after the liberation of Bulgaria from the ottoman power in 1878 when the foundations of the new Bulgarian country are made. Leonid Grabotska, one of the biggest experts of the Albanian history in Bulgaria, writes: "In this surroundings many Albanians, especially from the south of Albania, have no peace and no chance to make a living in their own country, so they emigrated in the newly liberated Bulgaria, where they found hospitality and shelter from the kind Bulgarian people."

The ideas of the Frasher brothers for the Albanian Renaissance penetrate powerfully between the migrant workers in Bulgaria. Before the Liberation they only listen about the activities of Albanian societies in Istanbul and Bucharest but have none in Sofia, the new Bulgarian capital.

Two locals become centers for albanian rising - the coffee shop Albania that belongs to the two poets Adam Shkaba and Spiro Garo and the tavern Dimitar Mole on Serdika street, where you could find a mineral water well.

Mole, who came from Bucharest in 1886, brought Albanian books and newspapers from there to read them to the migrant workers. The Albanian language was forbidden to be learnt in school where the official languages were Greek and Turkish.

Albanian literacy packages start coming in from Istanbul and Bucharest. Dimitar Mole, other than tavern owner, becomes a teacher to these refugees. There's been established a patriotic society called Dashira (Desire) that resembles the Albanian cultural societies in Istanbul and Bucharest.

This happned on the 1st of January 1893 in the Dimitar

Mole's tavern. The chairman is the master mason Ligor Prifi Borova, and the secretary is the one and only Dimitar Mole who knew not only Albanian and Bulgarian, but also German and Greek. They also chose council members and a cashier, 53 members have joined the society. One of the members was Spiro Garo, alert young man, who a year later was sent to Istanbul to establish a connection with the brothers Sami and Naim Frasheri, Iani Vreto, Vaso Pasha, Ismail Kemali and so on.

Spiro Garo returns back excited about what he saw and heard from the members of the Drita society, the meetings in Istanbul with Naim and Sami Frasheri. From there he brings a lot of books and magazines. This way the Albanian Desire in Sofia makes a connection with the famous Frasheri brothers.

The Bulgarian authorities help the Albanian society, it's registered in court with a regulation and a stamp.

The Bulgarian king Ferdinand sympathises to the Albanian fight for liberation and even takes 2 Albanian youngsters to study in a Bulgarian military school. These are Lek Margini from Mirdita, North Albania, and Stefan Kandilari from Korcha, South Albania. Other than that, the king invites professor Perikli Chilev to teach his sons - prince Boris and prince Kiril - Albanian language.

The educational activity of Desire continues till 1940. One of the most important initiatives that the society takes up is the establishing of a printing house in Sofia with the name Mbrotasia (Progress) that has been led by Kristo Lioarasi.

The first albanian book released by the printing house is Ditarfensi (Calendar). Next year this calendar is been released by Midhat Frasheri (also known as Liumo Skendo), son of the Albanian revival Abdul Frasheri, the older brother of Sami and Naim Frasheri. The calendar was then called National Calendar and it continued being released till the end of the First World War.

Sofia slowly started to become the new center of Albanian emigration being the closest place to the Albania itself. Bucharest and Istanbul are too far away. Liumo Skendo leads the National Calendar and Shahin Kolonia - the newspaper Drita that starts coming out in 1901.

The print house Napredak (Progress) has published many titles from which you can find one of the most famous books about the Albanian Renaissance - What has been, what is and what will be Albania from Sami Frasheri. The book has been released in Sofia in Turkish and Greek. The drama Besa (Given word) from the same author has also been published and it has been translated to Bulgarian and presented on stage of the circus-theater Bulgaria.

Napredak (Progress) that I mentioned in the beginning of these short notes, publish also the works of Naim Frasheri's History of Albania (1899) and Albania (1902). After the First World War the print house moves to Tirana.

Albania has been liberated in 1912 during the Balcan War. Bulgaria welcomed kindly the Albanian independance. The huge bulgarian poet Peio Iavorov and revolutionary sends a telegram to the Albanian authorities in Valiora.

After the end of the First World War the most well known activists of Dashira Midhat Frasheri, Dimitar Mole, Kristo Liurasi, Tanas Trebitska and others come back to the liberated Albania with their printing house Napredak (Progress).

ПЪРВИТЕ ИЗДАНИЯ НА ИСТОРИЯ НА АЛБАНИЯ И АЛБАНИЯ НА НАИМ ФРАШЕРИ СА ОТПЕЧАТАНИ В СОФИЯ

Д-р Антон БАЕВ

*Албанското патриотично общество Дъшира е
основано през 1893 г. в хана на Димитър Моле*

Дами и господа,

Позволете ми да споделя един може би не толкова известен литературен факт за Наим Фрашери, който го свързва и с моята страна – България.

През 1899 г., година преди смъртта му, в печатница Напредък в София излиза неговата книга История на Албания, а три години по-късно и трудът му Албания. Дотогава книгите на Наим се печатат в Истанбул, където живее, и Букурещ – румънската столица, която през втората половина на XIX в. е средище на книжовността на неосвободените още Балкански страни.

Но защо в България? Защо в София? Чия е книжарница Напредък? Кой в освободена вече България ще чете Наим Фрашери на албански?

Арнаутската махала, Арбанашкият път – това са топоними в България, оставени от албанските гурбетчии. Идването им в България се отнася към времето на разпространето на Османската империя на запад.

В днешния български език се използват заемки от албанския като думите кекав, кинта, скивам; келеш и др.

Но за албанска културна общност може да говорим едва след освобождението на България от османска власт през 1878 г., когато се полагат основите на новата българска държава. Леонид Грабоцка, един от най-големите познавачи на албанците в България, пише: „В тази обстановка много албанци, особено от южната част на Албания, нямайки спокойствие и възможност да изкарат препитанието си в родината, емигрираха в новоосвободена България, където намираха гостоприемство и подслон от дружелюбния български народ.”

Идеите на братята Фрашери за Албанското Възраждане проникват мощно между гурбетчиите албанци в България. Допреди Освобождението те само слушат за дейността на албанските дружества в Истанбул и Букурещ, но нямат свое в София, новата българска столица.

Два локала стават център на албанското надигане - кафене Албания на двамата поети Адам Шкаба и Спирос Гаро, и ханът на Димитър Моле на ул. Сердика, където е имало кладенец с минерална вода.

Моле, дошъл от Букурещ през 1886 г., донася оттам албански книги и вестници и ги чете на гурбетчиите, които в по-голямата си част са неграмотни. Албанският е забранен за изучаване в училищата, където се преподава на гръцки и турски.

Започват доставки на книжнина на албански от Истанбул и Букурещ. Димитър Моле, освен ханджия, става и учител на тези бежанци. Тук се създава патриотичното дружество

Дъшира /Копнеж/ по подобие на албанските просветни дружества в Истанбул и Букурещ.

Това става на 1 януари 1893 г. в хана на Димитър Моле. За председател е избран майсторът зидар Лигор Прифи Борова, а за секретар - самият Димитър Моле, който знаел не само албански и български, но и немски и гръцки. Избрани били съветници и касиер, записват се 53 членове. Между съветниците бил Спиро Гаро, буден младеж, който година по-късно бил изпратен в Истанбул, за да влезе в пряка връзка с братята Сами и Наим Фрашери, Яни Врето, Васо Паша, Исмаил Кемали и др.

Спиро Гаро се връща въодушевен от това, което е видял и чул от членовете на дружество Дрита, от срещите в Истанбул с Наим и Сами Фрашери. Оттам той донася и много книги и списания. Така албанският Копнеж в София се свързва със знаменитите братя Фрашери.

Българските власти съдействат на албанското дружество, то е регистрирано в съда с устав и печат.

Българският цар Фердинанд симпатизира на албанската борба за освобождение и дори взема двама албански младежи да се изучат в българско военно училище. Това са Лек Маргини от Мирдита, Северна Албания, и Стефан Кандилари от Корча, Южна Албания. Освен това царят поканва и проф. Перикли Чилев да преподава на синовете му - принцовете Борис и Кирил - албански език.

Просветната дейност на дружество Копнеж продължава до 1940 г. Една от най-важните инициативи, която предприема дружеството, е основаването на печатница в София с името Мбротъсия (Напредък) и ръководена от Кристо Люараси.

Първата албанска книга, излязла от тази печатница, е Дитърфенси (Денопоказалец, т. е. календар). На другата година този календар се издава вече от Мидхат Фрашери (с

превдоним Люмо Скендо), син на албанския възрожденец Абдул Фрашери, по-големият брат на Сами и Наим Фрашери. Изданието вече се нарича Календари Комбиар (Народен календар) и продължава да излиза в България до края на Първата световна война.

София постепенно става новият център на албанската емиграция като най-близко средище до самата Албания. Букурещ и Истанбул са твърде отдалечени. Люмо Скендо ръководи Народен календар, а Шахин Колоня - в. Дрита, който започва да излиза през 1901 г.

Печатница Напредък е обнародвала десетки заглавия, между които една от най-известните книги на Албанското възраждане - Каква е била, каква е и каква ще бъде Албания от Сами Фрашери. В София книгата е отпечатана и на турски, и на гръцки език. От същия автор излиза и драмата Беса (Дадената дума), преведена на български език и представена на сцената на цирк-театър България.

Напредък, както споменах в началото на тези кратки бележки, издават и творбите на Наим Фрашери История на Албания (1899) и Албания (1902). След Първата световна война печатницата се премества в Тирана.

Албания се освобождава през 1912 г. по време на Балканската война. България посреща радушно албанската независимост. Знаменателна е телеграмата, която големият български поет и революционер Пейо Яворов изпраща по този повод на албанските власти във Вльора.

След края на Първата световна война най-изтъкнатите дейци на Дъшира Мидхат Фрашери, Димитър Моле, Кристо Люараси, Танас Требицка и др. се връщат в свободна Албания заедно със своята печатница Напредък.

Преди това Димитър Моле оставя нещо безценно в най-стария жив европейски град, основан от траките преди повече от 6 хиляди години – Пловдив. На 1 януари 1912 г.

обиграният ханджия отваря най-големия и модерен хотел в града – хотел „Молле”, с новогодишно тържество. Сградата, която е на самата Главна улица, е строена през 1910-1911 г. и е първата със самостоятелно парно и асансьор, генератор за собствено електричество, над 90 стаи за гости, голям ресторант, чиито орнаментирани чугунени колони са лети във Виена, а във вътрешния двор албанецът изгражда площадка за кънки.

Тук е приветстван националният поет на България Иван Вазов за 70-годишния му юбилей през 1920 г. Хотелът просъществува до Втората световна война и е официално място за приеми на министри, депутати и чуждестранни делегации. Сградата е проектирана от италианския архитект Марио Пернигони, който строи и Пловдивския университет, а Димитър Моле я превръща в най-оживеното място на Пловдив – гранд-хотел „Молле”, просъществувал по-късно като хотел „Република”.

JETOJMË NË NJË BOTË KAOSI DHE HUMBJEJE TË KUPTIMIT

Nicole BARRIERE

I falënderoj organizatorët e Festivalit Ndërkombëtar të Tetovës ashtu si Reshat Sahitajn që më ka ftuar.

T'i kalosh kufijtë për të ardhur në një festival, kjo do të thotë të kapesht në foljet e veprimit të paraudhëtimit, që janë për mua të ëndërrosh, të rezistosh, të takosh.

Të ëndërrosh është dimension i utopik i poezisë dhe dalja nga mërgimi për t'u bashkuar me njerëzimin e madh, si thotë Nazim Hikmet.

Të rezistosh do të thotë të dëshmosh me fjalë të ndryshme nga ato të mediave të mëdha dhe uniformizimit të gjuhëve.

Të takosh, kjo do të thotë që nisësh për të fituar toka shprese pa kufij, të ndiesh njerëzimin që vizatohet në hapësirat në mes, në ato distanca që janë vendi dhe burimi i ëndrrave të reja për të ndërtuar bashkë.

Pastaj vij në foljet të njohësh, të duash dhe të mbrosh.

Poezia është tejkalimi; nganjëherë për ta njohur, duhet tejkaluar origjinalin dhe ta përkthesh; përkthimi është në zemër të festivaleve ndërkombëtare dhe mundëson njohjen e sensibiliteteve të tjera, kulturave të tjera, mundëson kuptimin

e shpirtit të popujve të tjerë, është një vegël thelbësore për takimet tona.

Të duash dhe të mbrosh, kjo rrjedh nga njohja, për mua është edicioni i poetëve nga pesë kontinentet, të bësh të njohura dhe të përhapësh njëkohësisht poezitë e poetëve bashkëkohore, të femrave poete dhe të poetëve që shkruajnë në gjuhët minoritare.

Kjo është një pjesëmarrje në ndërtimin kolektiv të kozmopolitizmit, dmth. dialogut të popujve mes tyre, diskutimit rreth mërgimeve, të gjitha mërgimeve, atyre kolektive të të zhvendosurve, imigrantëve dhe refugjatëve, dhe atyre individuale të secilës dhe secilit prej nesh.

Besoq që me foljet dhe sfidat e tyre mund të definosh punën e poetit, që i jep kuptim dhe që ia jep kuptim përgjegjesisë së tij. Kjo ndërtohet individualisht mbi faqen e bardhë dhe kolektivisht në pavetëdijën e errët të botës.

Poezi, po pse? Jetojmë në një botë kaosi dhe humbjeje të kuptimit; ky kaos dhe kjo humbje kuptimi nuk janë fatalitete, por pasojat e integritizmave, si definoohen nga filozofi afro-amerikan Cornel West: një militarizëm agresiv, autoritarizmi, fundamentalizmi ekonomik dhe nihilizmi.

Roli i poezisë është të kundërshtosh me fjalët, burimet dhe pasojat e këtyre integritizmave, sepse para se të jetë strategji dhe ndërhyrje në terren, militarizmi agresiv është diskurs; ndërsa roli i poetëve është të mbështesim jetën, ta përkrahim në dialog dhe në tolerancë, por edhe në qëndresë për të ruajtur bazamentet universale të njerëzimit.

Po ashtu kundër goditjeve të mendimit unik, të hapen fusha të tjera raportimi, të sillen pikëpamje të tjera. Cornel West thotë: “Kur kam blues-in (ndihem depresiv), këndoj blues-in”, duke na dhënë mësim të mrekullueshme të artit afro-amerikan.

Këto mësim janë mësimet e angazhimit dhe mësimi i

mendimit të blues-it, dmth. qëndrimi që e bën të mundur të jetosh: përballë të gjitha vuajtjeve, poshtërimeve të përjetuara nga zezakët dhe popujt e shtypur prej kohës së skllavërimit; ky qëndrim përgjigjet me tragjiko-komikën, si tallje me të gjitha autoritarizmat, fundamentalizmat dhe dhunën. Ky qëndrim u flet të gjithave, në globalizimin i flet veprës, është një mendim shprese, mendimi i jetës, kundër të gjitha strategjive vdekjeprurëse të kapitalizmit të globalizuar.

Ky është një mendim rebel, ashtu si poezia, fuqia e së cilës hapet për të vërtetën e gëzimit dhe dashurisë si kundërhelm ndaj nihilizmit.

Unë ju uroj gëzimin e utopive, takimeve dhe krijimit.

13. X. 2016

Përktheu Silke Liria BLUMBACH

NOUS VIVONS DANS UN MOND DE CHAOS ET DE PERTE DE SINGIFICATION

Nicole BARRIERE

Je remercie les organisateurs du festival international de Tetovo ainsi que Reshat Sahitaj de m'y avoir invitée.

Passer les frontières pour venir dans un festival, c'est être prise dans des verbes d'action d'avant le voyage qui sont pour moi rêver, résister, rencontrer

Rêver c'est la dimension d'utopie du poème et la sortie de l'exil pour rejoindre la grande humanité ainsi que le dit Nazim Hikmet,

Résister, c'est témoigner avec d'autres mots que ceux des grands medias et de l'uniformisation des langages.

Rencontrer c'est se mettre en marche pour gagner des terres d'espérance sans frontières, de ressentir l'humanité qui se dessine aux interstices, dans ces écarts qui sont le lieu et la source de nouveaux rêves à bâtir ensemble.

Viennent ensuite les verbes connaître, aimer et protéger

La poésie est transgression, parfois pour connaître, il faut transgresser l'original et traduire, la traduction est au cœur des festivals internationaux et elle permet de connaître d'autres

sensibilités, d'autres cultures, elle permet de comprendre l'âme d'autres peuples, c'est un outil essentiel de nos rencontres.

Aimer et protéger c'est ce qui découle de la connaissance, pour moi c'est l'édition de poètes des cinq continents, de faire connaître et diffuser à la fois les poèmes des poètes contemporains, des femmes poètes et des poètes qui écrivent dans des langues minoritaires.

Cela participe de la construction collective de la mondialité, c'est-à-dire du dialogue des peuples entre eux, du débat autour des exils, de tous les exils, collectifs des déplacés, immigrés et réfugiés, individuel de chacune et chacun d'entre nous.

Avec des verbes et leurs enjeux je crois que l'on peut définir ce qu'est le travail du poète, qui lui donne sens et ce qui donne sens à sa responsabilité. Cela se construit individuellement sur la page blanche et collectivement dans l'inconscient obscur du monde.

Poésie , mais pourquoi faire ? nous vivons dans un monde de chaos et de perte de sens, ce chaos et cette perte de sens ne sont pas des fatalités mais les conséquences d'intégrismes ainsi que les définit le philosophe noir américain Cornel West : un militarisme agressif, l'autoritarisme, le fondamentalisme économique et le nihilisme.

Le rôle de la poésie c'est de contrer par les mots, les sources et les effets de ces intégrismes, car avant que d'être des stratégies et des interventions sur le terrain, le militarisme agressif est discours, le rôle des poètes est de soutenir la vie, de la promouvoir dans le dialogue et la tolérance, mais aussi dans la résistance pour préserver les fondements universels de l'humanité.

C'est aussi, contre le martèlement de la pensée unique, ouvrir d'autres champs de réflexion, apporter d'autres points de vue, Cornel West, dit « lorsque j'ai le blues, je chante le blues » en nous donnant de magnifiques leçons d'art afro-américain.

Ces leçons, ce sont celles de l'engagement et celle de la pensée du blues, c'est-à-dire la posture qui permet de vivre : face à toutes les souffrances, humiliations vécues par les noirs et les peuples opprimés depuis l'esclavage, elle y répond par le tragique, comme un pied de nez à tous les autoritarismes, aux fondamentalismes et la violence. Cette posture parle à tous, dans la globalisation à l'œuvre, c'est une pensée de l'espoir, la pensée de la vie, contre tous les stratégies mortifères du capitalisme mondialisé.

C'est une pensée rebelle comme l'est la poésie dont la puissance ouvre à la vérité de la joie et de l'amour comme antidotes au nihilisme.

Je vous souhaite la joie des utopies, des rencontres et de la création.

FESTIVALI I POEZISË “DITET E NAIMIT” MIRËPRET POETET ME TË NJOHUR BOTËROR

Silke Liria BLUMBACH

Tetova të zbukuron. Vizaton një buzëqeshje në fytyrën tënde kur ecën nëpër rrugët e qendrës së lashtë në vjeshtën e artë – së paku, kur nuk je vendas i papunë ose i diskriminuar, por një mysafir në Festivalin Ndërkombëtar të Poezisë „Ditët e Naimit“.

Me siguri edhe Naimit të madh do t’i kishin pëlqyer ritualet e çdo viti në nder të tij. Pas ngutjes së fundit të disa zonjave për të zgjedhur një gardërobë aq mbresëlënëse sa poezia, takimi është në sheshin para Qendrës së Kulturës. Vendosija e kurorës para shtatores së Naimit (e vendosur me iniciativën e drejtorit të Festivalit, Shaip Emërllahu - shtatore e rrëmbyer dhe e rimëkëmbur), valltarët e rinj me veshje tradicionale, ndezja e fishekzjarreve -ritual, të cilin e ke parë mbase më shumë se dhjetra herë dhe që megjithatë vazhdon të të tërheqë. Pastaj, ekspozita e pikturës në Qendrën e Kulturës, admirimi i skenave të përvitshme, ekzekutimi i pjesëve muzikore (më pëlqen fjala „ekzekutim“ me dykuptimshmërinë e saj), eleganca e moderatores, fjalimet formale dhe më në fund fjalët e Shaipit që të shpëtojnë nga ky tension i këndshëm: „E deklaroj të hapur Fes-

tivalin Ndërkombëtar të Poezisë “Ditët e Naimit”!

Një gjysmë jave është tepër e shkurtër për të vibruar më shumë se në 51,5 javët e tjera të vitit, dhe kjo vlen edhe për ne poetët, edhe për qytetin e Tetovës. Dhe kjo antologji mbetet një ngushëllim i zbehtë, kur Shaipi e mbyll Festivalin përsëri, si një derë për misterin, si një arkë me një thesar nga një monedhë jashtëkohore.

Një mikrokozmos – a na mungon vetëm Antarktida si kontinent apo edhe Australia? – grumbullohet në provincën më perëndimore dhe më shqiptare të njërit prej vendeve më të bukura që kam parë: Maqedonia. Në fakt sfida kryesore e „Ditëve të Naimit“ është të balansohet qasja kozmopolite, duke përfshirë multietnicitetin e Maqedonisë, me afirmimin e poezisë dhe kulturës shqiptare. Këtë sfidë, vallëzimin mbi një tel, ku rrezikon të biesh në humneren e mospërfilljes së identitetit shqiptar ose në atë të përkrahjes së tij me fanatizëm, Festivali e ka zgjidhur për mrekulli. Në „Ditët e Naimit“, poezia dhe celebrimi i saj përbëjnë në të vërtetë një urë midis përfaqësuesve të popujve të ndryshëm e nganjëherë armiqësorë – dhe njëkohësisht, poezia flet shqip. Kjo pasqyrohet edhe në strukturimin gjuhësor të mbrëmjeve poetike: në njërën anë gjendet shqipja, në anën tjetër, të gjitha gjuhët e tjera të botës.

Poezia si urë lidhëse mes kombesh, si gjuhë e kuptuar nga të gjithë, si gjuha e zemrës, ndërthurëse e zemrave, poezia si shpresë për paqe dhe si veprim madhërisht modest, ku secili prej nesh mund të kryejë në favor të saj – kjo nuk kuptohet vetvetiu, është një klishe që shpesh ngjitet mbi takime të tilla si një etiketë në sipërfaqen e enës që na mbulon shikimin për përmbajtjen. Me fjalë të thjeshta, poezia mund të jetë e mirë ose e keqe. Ose, më saktë, materiali poetiko-gjuhësor mund të përdoret për qëllime fisnike, si dhe për qëllime shkatërrimtare. Çdo diktator ka poetët e tij të oborrit, çdo gjenocid përcillet dhe përligjet me poezitë dhe këngët e tij të egra. Lavdërohet

ajo që nuk është për t'u lavdëruar dhe shahet ajo që nuk është për t'u sharë. Ndaj, një metaforë që e afron poezinë me paqen duhet përdorur me kujdes, se krahas poezive të shumta dashurie ka edhe poezi urrejtjeje.

Gjithsesi, kjo nuk u takon „Ditëve të Naimit“. Këtu kam vëzhguar mini-mrekulli të mirëfillta. Një izraelit dhe një palestineze që gjejnë gjuhën e përbashkët. Një amerikan dhe një irakian, të cilët përqafohen. Dhe nuk bëhet fjalë vetëm për vende të largëta. Vijnë dhe kuptohen poetë dhe poete nga të gjitha vendet e Ballkanit tonë, madje nga të gjitha etnitë e Maqedonisë. Ndërsa, në „Ditët e Naimit“, të parin që mora pjesë ishte luftë dhe Festivali ishte shtyrë deri në nëntor, binte borë për kënaqësinë fëmijërore të mesdhetarëve të Shqipërisë, Xhevhir Spahiut me shokë, zhvilluan një betejë me topa bore në orën katër të mëngjesit, derisa erdhi policia...!

Ka mysafirë, sidomos nga trojet shqiptare, që janë bërë inventar të „Ditëve të Naimit“ (dhe këtu e përfshij edhe veten time). Vijnë edhe poetë të formatit, si për shembull ende-jonobelisti Ismail Kadare, Podrimja, Arapi..., të cilët janë bartësit e letërsisë shqipe. Janë kryeura të afirmimit të saj për të gjetur vlerësimin e merituar për nga cilësia, që letërsitë në vende dhe gjuhë të vogla meritojnë po aq shumë sa letërsitë e numrave të mëdhenj.

Për shumë mysafirë të tjerë, Festivali është vizita e parë në Maqedoni, nganjëherë në Ballkan ose madje në Europë, dhe atëherë zakonisht është edhe përvoja e parë me kulturën shqiptare. Pra, „Ditët e Naimit“ luajnë një rol të rëndësishëm (sipas përshtypjeve të pjesëmarrësve poetë), madje mjaft suksesshëm, duke iu treguar atyre përfaqësuesve të „botës së jashtme“, se shqiptarët, jo vetëm sipas përvojës sime, janë populli më bujar dhe më mikpritës në botë.

Përveç njerëzve-pemë të Tetovës dhe të botës, një përbërës kryesor i magjisë së „Ditëve të Naimit“ është hapësira. Mad-

hështia që të kaplon kur kontempon Malet e Sharrit. Nostalgjia, të cilën e ngjallin rrugicat – dhe vitrinat e dyqaneve! – të qendrës së lashtë të Tetovës, ura, Xhamia e Larme me pikturat nga mijëra kokrra veze. Pastaj, pikat që janë si të skalitura në gur në program: të dy universitetet e Tetovës, njëri falas dhe fruti i luftës për arsim të lartë për shqiptarët e Maqedonisë, tjetri modern si emblemë e Evropës Juglindore të së nesërmes, të këndshëm të dy, ku studentët gëzohen për një ndërrim të orarit të tyre.

Dhe vendi më paqësor, më i përshpirtshëm i Tetovës: teqeja bektashiane, që dëshmon që Bektashizmi i Naimit është i gjallë dhe që bektashitë vazhdojnë të jenë miq dhe mbështetës të letërsisë. Në kopshtin e trëndafilëve, pimë një gotë raki ose më shumë! Po, bektashitë, edhe pse janë myslimanë, nuk e ndalojnë alkoholin! Edhe për shumë tema të tjera kanë një mentalitet të hapur, tolerant – dhe ky është në botën e sotshme një kontribut shumë i rëndësishëm i tyre dhe i „Ditëve të Naimit“: Ka një Islam që nuk i pushton ekranet e lajmeve, një Islam paqësor, që nuk lufton, por respekton njerëzit, të cilët besojnë dhe mendojnë ndryshe. Kjo, sipas motos shqiptare: „As kisha, as xhamia, feja jonë është shqiptaria!“

Shqiptaria e „Ditëve të Naimit“, e gërshëtuar me kozmopolitizëm, lulëzon më së bukur në ekskurzionet, që në vitet e fundit u kurorëzuan me mbrëmje poetike në Teatrin Kombëtar të Prishtinës dhe në hotelin shumëkatësh në Tiranë. Para këtyre shfaqjeve u admiruan qytetet që janë perlat e trojeve shqiptare për nga bukuria dhe nga rëndësia historike: Prizreni i Lidhjes dhe Kruja e Skënderbeut. Nuk harrohen pejsazhet malore, ku rrugët e vjetra vetëm zgjasin kënaqësinë e udhëtimit. Shqipëria, Argjentina, Maroku dhe Italia të bashkuar në „aaaaaaah“ përballë perëndimit të diellit në malet e Brezovicës. Martiniku, Greqia, Algjeria dhe Tunizia të humbur në të qeshura lozonjare. Befas kolona e furgonëve poetikë ndalet,

sepse poeti Rudolf Marku ka parë një qenush në rrugë, të cilin kërkon ta shpëtoj nga makinat. Mirëpo, sapo e largon, qenushi vrapon përsëri në mes të rrugës, dhe Rudolfi pas tij...!

Shumë e shumë detaje dhe anekdota të tjera mund t'i tregoj, por „Ditët e Naimit“ nuk është Festivali Ndërkombëtar i Parathënieve (edhe pse një festival kushtuar vetëm parathënieve do të ishte diçka origjinale), por, Festival Ndërkombëtar i Poesisë! Pra, le të hapim perden e skenës, le të dëgjojmë „Fjalët e Qiririt“ dhe le të shijojmë kryesoren: veprat e motrave dhe vëllezërve tanë të fjalës!

Ftoj të gjithë lexuesit, të cilët ende nuk kanë vizituar asnjë mbrëmje poetike të „Ditëve të Naimit“! Shpresoj, të kem ndezur kureshtjen tuaj!

Ejani!

Ejani në mbrëmjet e leximeve poetike të Festivalit në Qendrën e Kulturës, sepse është falas dhe **IA VLEN SHUMË!**

CIKLI BUKURIA I NAIM FRASHËRIT KODIFIKIMI POETIKO-ESTETIK

Dr. Riza BRAHOLLI

Është pranuar tashmë, që impenjimi, përpjekja, deri në përkushtim e gjakim për çështjen kombëtare, bëri që vepra e Naim Frashërit - shumica e kësaj vepre - të merrte një rezonim të theksuar kombëtar e didaktik, gjë që, në një farë mënyre, solli një vetësakrifikim estetik të poetit. Themi kështu pasi te lirizmi që gjendet te poemat e mëdha: “Bagëti e bujqësi”, “Historia e Skënderbeut”, “Qerbelaja”; po dhe në vjersha të veçanta te vëllimet e tij poetike: “Tejhyjlat (Ëndërrimet, 1885)”; “Lulet e verës”, 1890; “Fjala flutarake, (vjersha)” 1894, etj.; dhe sidomos te cikli – që ne kemi marrë përsipër të vështrojmë e hulumtojmë, – kodifikimin e saj gjuhësor poetik – shohim të spikatë një gjuhë e artikuluar artistikisht, në funksion të koncepteve estetike, morale e filozofike nën frymën e iluminizmit e romantizmit, sipas asaj që nënvizon edhe Rexhep Qose në veprën e vet: “ Poemthi në fjalë (Cikli Bukuria; shën. i aut.) përmban të gjitha përsiatjet, lektisjet dhe emocionet e poetit: mendimtar, romantik, ekzotik dhe sentimental. Me një fjalë: aty gjejmë të kompletuar edhe njëherë mendimtarin, moralistin, estetin dhe

poetin skofiar”.

Cikli “Bukuria” përbëhet nga 16 këngë. Poezitë janë shkruar kohë pas kohe, derisa janë përmbledhur në këtë cikël. Objekti i përbashkët i këtij frymëzimi është bukuria e mitizuar në: grua, Perëndi, dashuri, duke e ngritur gruan, femrën që dashuron dhe idilin e saj në një simbol gati të imagjinuar. Naimi këndoi për dashurinë në mënyrë abstrakte, idealiste apo platonike. Këndoi për një dashuri të madhe, por të parealizuar. Poeti është i përvëlur, i shqetësuar nga dashuria, i mahnitur nga bukuria, i hutuar, por edhe i brengosur prej mospërfilljes së saj. Kjo mënyrë të konceptuari, me gruan, femrën në qendër të përjetimit, si dhe filozofimit të tij panteist nëpërmjet shprehjes artistike, ka sjellë dhe ka kushtëzuar edhe gjuhën, elementet formalë të krijimit, që nga fonema e deri te fjalët, imazhet, figurat, njësitë objektive dhe ato mungesore.

Por le të hyjmë te lënda e të shikojmë përse na entuziazmon, na hidhëron, na bën t’i gëzohemi bukurisë, dashurisë e Perëndisë? E ndjekim në kapërcimet dhe ndërthurjet e tij intime e idilike, dashurore me ato filozofike, por, shpesh, të shkri-
ra në një. Kjo kërkon dhe një vëmendje të posaçame të hetimit e përfytyrimit tonë për të arritur në një konvergim të imazheve dhe mesazheve që na propozon poeti.

“Bukuria dhe femra për poetin janë një; element hyjnor, në kuptimin panteik” – na thotë Rexhep Qosja. Le ta shohim në tekstin e parë të ciklit:

*Do të këndonj bukurinë
E të lëvdonj Perëndinë,
Perëndin’ e bukurisë,
Q’i dha shije gjithësisë.*

Dhe pastaj:

*Ty të falem e të lutem!
Më vjen në gji të të futem,
O zonja përkëdheloshe,
Që me je si mbretëreshë!
Te keqen, o pëllumbeshë!*

Gjysma e parë e poezisë vjen me një tonalitet më të ngritur tingëllues që më pas fillon e zbret në një zë gati pëshpëritës edhe pse në të evidentohen fonemat pasthirmore o. Kjo ndodh, sepse nëse shikojmë rimat e tre vargjeve, janë të përputhura, si për ta ëmbëlsuar e këngëzuar deri në fund me rimën e spikatur "...eshë". Është sh-ja, që e zbut zërin e krijon një klimë përgjimi deri në një fëshfërimë, e cila duket sikur del, jo nga fjalët, por drejtpërdrejt nga zemra. O-ja dhe rimat e buta lëkunden në një amplitudë ngjithëse dhe zbritëse, që e bën poezinë të rezonojë shpirtërisht me lexuesin. Gjithashtu, ndërkalimi ndodh natyrshëm, pa kurrfarë sforcimi, duke krijuar intimitetin e nevojshëm që i duhet lexuesit për ta identifikuar bukurinë e Perëndisë dhe të femrës të njësuar. Pra, transfigurimi ndodh në një mënyrë harmonike e të pamenduar dhe marrëdhënia e heroit lirik bëhet me një subjekt poetik, e cila është sa tokësore aq dhe hyjnore.

Nëse vazhdojmë të shikojmë kontributin e vlerën shprehëse të fonemave të tjera në këtë cikël, do të vemë re se kjo zanore O, shpesh edhe si zanore e prapashtesës, ore, është mjaft e pëlqyer prej Naimit. Gjithashtu ajo përdoret jo vetëm si pasthirmë ngazëllimi, kur i drejtohet Zotit; o-ja kthehet në zanore të zgjatur dhe këngëzon me timbër adhurues e dashuror, duke u bërë mjet i domosdoshëm i muzikalitetit të vargjeve. Shpesh shfaqet dhe si timbër i dhimbjes dhe kjo realizohet edhe nëpërmjet konteksteve e pranëvënieve me fjalët e tingujt e tjerë në varësi

të ndjenjës, emocionit, mendimit apo konceptit që kërkon të përcjellë.

Nuk duhet të harrojmë që jo fjalët, por pranëvëniet e tyre me njëra-tjetrën fshehin kuptimet e vërteta. Natyrës, thellësisht intime dhe hymnizuese të kësaj poezie për bukurinë, ku është Perëndia dhe femra dhe ku zgjaten mijëra fije të padukshme të heroit lirik, me këtë dualitet panteik të njësuar në një trup te ajo, i përgjigjen më së miri edhe rimat e ndërtuara me bashkëtingëllore të pazëshme si: etë, ërë, uar, ese, ira, ore, ohet, pakë, etj. Në vecanti, po të shikojmë zanoret e theksuara te rimat, ato janë të zgjatura si klithma dhimbjeje, adhurimi apo deri dhe përgjërimi. Veç O-së përsëritet dendur i-ja; si te Poezia 3:

*Në fëtyrë tënde gjeta bukurinë
Si aji që gjeti në mal perëndinë
Lulëzet' e majit sa janë të mira!
Po përpara teje m'erdh të pështira*

Në dy vargjet e para zanorja i nuk është aq e gjatë; e theksuar por jo e gjatë, te dy vargjet e tjera, ku ndjenja, emocioni bëhet më përgjërues, ledhatues plot ëmbëlsi, i-ja bëhet një zanore më e gjatë, duke marrë e mbartur mbi vete pikërisht këto ndjese që sa më sipër thamë, duke iu përgjegjur edhe logjikës artistike të mënyrës krahasimore që ka strofa.

Përveçse në fund, fonemat luajnë një rol të madh kuptimor edhe brenda fjalëve dhe vargjeve duke u përdorur si efekte aliterative në pajtim me ëmbëlsinë, dashurinë, dhimbjen, lutjen, përgjërimin, betimin e përbetimin, që ndodh në këtë marrëdhënie; por edhe në hyjnizimin e filozofimin që kërkojnë tonalitete e sintoni të tjera në varësi të pëlqimeve e sublimiteteve që përdor poeti i mrekulluar nga bukuria.

Një element tjetër, shumë i rëndësishëm dhe tepër spikatës,

në ndërtimin e kuptimësisë dhe mesazheve që sjell poeti, është muzikaliteti që, përveç rimave të jashtme e të brendshme, vjen edhe prej ritmit në pajtim harmonik me logjikën që i kërkon lënda ideore si tharm, rreth së cilës lind, akumulohet e ndërtohet gjithë kodifikimi i gjuhës poetike.

Metri i vargut nuk mbetet i ngurtë, por ndryshon në varësi të ritmit të diktuar nga përmbajtja. Aty ka vargje tetërrokësh, dhjetërrokësh apo dhe dymbëdhjetërrokësh. Po kështu edhe strofat, po kështu edhe rimat janë ndërtuar në funksion të ideve dhe emocioneve që përcjellin. Kjo mbase dhe pse është një poemë që u shkrua pak e nga pak duke shtuar nga një vjershë e nga një vjershë, derisa u bë një cikël, dhe kështu, përveç unitetit, secila ka mëvetësinë e saj edhe në këtë element: ka poezi strofa katërshe, ka me strofa tetëshe, dhjetëshe, etj. Pra, vërejmë se ndikimi romantik te poeti nuk është vetëm ideor, konceptual, por edhe teknik e stilistik.

Natyrisht që këto elemente ia shtojnë bukurinë dhe forcën poemës, por elementet, që fenomenologjia na i jep si mundësitë më rëndësishme të interpretimit, janë fjalët, njësitë kuptimore dhe sidomos njësitë mungesore, ato çka na jep boshësia midis situatave dhe fjalëve. Vargje si:

*“Dielli zënë me rezë,
Vera në qelqe të zezë,
Shpirti brënda nër qivure
Zot’i madh nër katrë mure!”*

si për nga fuqia e mendimit, ashtu edhe për nga bukuria dhe thellësia poetiko-estetike, e kemi të pamundur t’u gjejmë të dyta në poezinë shqipe. Paralelizmat që ndërtohen vijnë si shkallëzim, si pamjaftueshmëri për të thënë skajin e të pamundurës, bukurisë divine. Ato janë paralelizma dhe njëkohësisht edhe shkallëzime kontrastuese ndërtuar me figura metonimike.

Të gjithë vargjet, secili më vete, janë një paralelizëm analog me zemrën e së bukurës që në vargun e parë thotë se është “është hekur brenda n’ergjënd” Është në ngjitje a në zbritje shkallëzimi? Kush mund ta thotë këtë, sepse vjersha nis me këtë varg dhe pastaj të gjashtë vargjet e tjerë sjellin një varg metonimik, sipas parimit të zhvendosjes kuptimore. Ka vargje si: dhe në linj'ai krahuar / si në dhë gur' i paçmuar, apo “dielli zënë në rezë” dhe e përfundon strofën me nis “Zot'i madh nër katrë mure!” Alogjizmi mental këtu arrin kulmin e pamenduar: Zoti i burgosur. Si mund të burgoset Zoti? Atëherë na mbetet të definojmë se zemra e femrës, së bukurës, është hyjnore si perëndia vetë, duke na çuar pikërisht në ;përfundimin që thamë më sipër për identifikimin e bukurisë me Perëndinë e dashurinëdhe këto simbolizohen te gruaja. Kritiku Ali Aliu do të konstatojë:” Do të ishte mëkat më i rebeluar, më blasfemik edhe kundër çdo natyre njerëzore, kurthimi i zotit brenda katër mureve të ftohta e të vdekura”. Po mjetet e poetit s’kanë kufij; nuk i druhen as Atij, sepse i duhet blatimi i Tij për dashurinë edhe si një rreth ciklik të menduari të idesë panteiste. Dashuria është aq e madhe sa, ndoshta, Naimi e ka ndjerë se ka bërë një mëkat, aq sa ai nuk ka frikë të mëkatojë më, por të kurthojë edhe Zotin brenda katër mureve. Mos ka një mëkat të vërtetë!? Poeti është mëkatar i më i madh i dashurisë. A ka bërë përjashtim Naimi...? Një dashuri si kjo:

*Do të shkrihem të venitem
si kandili, kur s’ka vaj
balt’ e pluhur do të bëhem
të më shkëlqejë këmb’ e saj;*

*e të prehem duke puthur
atë këmbë pasandaj
As më thua: ç’ke me mua?*

Pse te dua, paskam faj?

*Pse heq unë hidhërime
a në vdeçka, ti mos qaj;
vdekja ime s'të prish punë
haj, e zeza jetë, haj!*

nuk mund të vinte pa muzikën imazhet e figurat që përdor. Vini re rimat e brendshme, shkrihem-venitem, balt-vaj dhe balt saj; apo dhe haj e haj. Rima e fundit ...aj, që bëhet lajtmotiv në të tria strofat, në një dhimbje vajtuese, si në një elegji të mirëfilltë. Mbase është dhe poezia ku poeti anon më shumë nga tokësorja, sepse ai endet në të dy hapësirat, duke u përpjekur t'i bashkojë e shkrijë ato në një. Dhe gjithmonë ai i drejtohet femrës, sepse aty janë të gjitha bukuritë. Vemë re se poeti këtu na flet më shumë me nëntekst dhe me një alogjizëm që i jep frymë. Ai nuk i thotë që nuk më do, që është e lakmuar, por dhe e paarritshme, por i thotë: vdekja ime s'të prish punë. Dhe kur vdekja nuk prish punë? Dhe kujt nuk i prish punë? Natyrisht atij që nuk të do apo që nuk është në nivelin apo sërën tënde. Dykuptimësia këtu është evidente për të dyja rastet: si për mospërfilljen e gruas, e cila nuk e bën asnjë hap në dhembjen e poetit, ashtu edhe për lartësinë e perëndisë që është e paarritshme për të.

Pra, poeti bëhet një pasqyrë e tërë reflektimeve që vijnë nga idili që është bukuria që simbolizohet nga gruaja, por ku është edhe Perëndia e dashuria...

më 20. 10. 2016, Tiranë

TESTAMENTI POETIK I NAIMIT

ose:

(Poeti i gjuhës së zjarrtë)

Ymer ÇIRAKU

Në vitin 1925, një grup studentësh shqiptarë, të vendosur për studime në Grac të Austrisë, me rastin e mbushjes së 25 vjetëve pas ndarjes nga jeta të Naim Frashërit, organizuan botimin e librit me titull: Naim Frashërit! Vjershëtorit dh`edukatorit kombëtar. Libri përmban një parafjalë, ku i parashtrahet lexohet pengu për të nderuar e ndjekur rrugën e çelur nga etërit dhe arkitektët e shpirtit të kombit. Pastaj më tej, vijjnë shkrime e poezi kushtuar Naimit, duke u përmbyllur ai me radhoin, ku shënohet me skrupulozitet çdo frangë e derdhur nga dashamirësit për botimin e saj.

Mosha e re e tyre, mundësitë e kufizuara financiare (si studentë që ishin), pastaj, të ndodhurit në një vend të huaj, të gjitha këto nuk peshuan aspak - përpara vendosmërisë e betimit të tyre sovran, të skalitur qysh në hyrje të këtij libri, se kjo nisje nuk vinte aq dhe vetëm si përmbushje e një detyre kujtimi, se sa prej detyrës për të rrënuar e për të depërtuar në magjinë e veprës së Naimit - në palcën e saj dritëdhënëse për një stër-

vitje kombëtare të vërtetë...

Autorët e përfshirë në këtë libër, janë zgjedhur nga të gjitha anët e botës shqiptare, madje deri edhe nga arbëreshët e Italisë. Krahas disa prej vet këtyre studentëve si: Krist Maloki, Et`hem Haxhiademi, Safet Butka, Helenau (Kolë Mirdita), janë dhe emra të njohur si Lasgush Poradeci, Lumo Skëndo, Asdreni, Sevasti Qiriazhi... Madje nuk do të mungojë edhe shkrimi i albonologut të nivelit evropian N. Jokl-it përmbi pasurimin e shqipes, që e solli plot begati vepra e këtij poeti, si model i vyer në letërsinë shqipe.

Në veprën e tij fundamentale për nga tezat dhe formatin e lartë shkencor të shpalosur në të, të titulluar: Romantizmi në Europën Lindore e Juglindore dhe në literaturën shqiptare, E. Çabej e ka portretizuar Naimin si një apostull të idesë nacionale, si një patriot të madh panshqiptar e jo lokalist, si një idealist të kthyer me të drejtë në simbol e gati një mit, një legjendë e nacionit shqiptar.

Përgatitësit e rinj e të zellshëm të këtij libri, m`u në një nga metropolet e mëdha kulturore të Europës, sikundër ishte Austria, dëshmonin se ishin ndjekësit e pishtarit udhëndritës, apo dritësjellës, siç e quante Çabej veprën e poetit prej Frashëri . Personaliteti i kësaj figure nuk vlerësohet e venerohet thjesht e vetëm si një memorie e historisë kulturore shqiptare, por para së gjithash, si një referencë e fortë ku duhej të ballafaqohej aso kohe aktualiteti i shoqërisë shqiptare, me sfidën e madhe që i kishte dalë përpara - për të konstruktuar sovranitetin e vet etnokulturor.

Si një hyll i mallshëm e përcjell ky emën (pra, N. Frashëri) rokullitjen e botës s`onë shqipëtare ...do të shprehej studenti dhe kritiku i ardhshëm Krist Maloki në pasazhin e shkrimit të vet, shkrim ky që rezulton të jetë pjesë e një studimi të gjerë e mjaft skrupuloz për nga rrokja filologjike e interpretimit dhe ku me këtë rast, kritiku do të inagurojë për herë të parë në stu-

dimet letrare shqiptare edhe aplikimin e metodës psikanalitike. Në fakt, kjo metodë sapo kishte nisur të buiste edhe në rrethet letrare europiane të kohës, nën ndikimin e teorisë së Frojdit, të cilën, studiuesi i ri, kishte patur rastin ta përvetësonte m'u në gjuhën, në kohën dhe në vendin e saj të lindjes (Austri). Në cakun e këtij fragmenti tekstor, në trajtë fare koncize, dëshmo-het ajo marrëdhënie sublime e Naimit me popullin e vet, që për nga përmasat e ndërtuara prej fuqisë/mjeshtërisë/magjisë së fjalës së tij artistike, konkuron apo i tejkalon edhe limitet kozmike. Prandaj, nuk është e rastësishme prania e dendur e yllit, si një metaforë identifikuese kjo me Poetin, duke mbartur e përcjellë të shtresuara kjo metaforë, kuptimësi të tilla si: e larta, sipërorja, qiellorja, e shndritshmja, e pafundmja, nordi i orientimit - për nga ku duhet shkuar... Kjo mund të na sjellë për asociacion yllin lajmëronjes mesianik, në këtë rast pikërisht për poetin tonë, i cili, do t'i vinte atdheut të tij (citojmë): ...posi yll i përvëlur n`horizontin shqipëtar, dhe nër bijt` e mëmës s`ate, - yll i ndritur! Yll me zjarr!..., sikundër do ta portretizonte në vargjet e tij L. Poradeci figurën e N. Frashërit, në poezinë e përfshirë në këtë libër. Por njëherazi, mund ta dekodojmë atë edhe si shenjën me të cilën poeti kombëtar do të identifikohet nga/dhe për të mëpasmit. Në poezinë lasgushiane, topiku "Yll" do të përsëritet disa herë, si një frekuencë e nevojshme për ta dominuar e për ta shpalosur semantikisht madhështinë e këtij bardi të racës shqiptare.

Si një zhbirues i ngulët i motivit të përjetësisë - në disa prej poezive të tij e madje edhe në formatime ciklesh poetike, Lasgushi i mëshon fort idesë së raporteve të njeriut me jetën, të frymës me qëllimin/detyrën e tij, ku është fort e spikatur përcjellja e devizës: Kam qëllim prej vetvetiut/ T'i shty lundrëzën njeriut... Prandaj, ai do t'ia çmojë drejtpërdrejtë Naimit këtë vlerë, duke i kushtuar vargjet:

*Ti rapsod që pranë Shqipes dit` e nat` i lodhe ballët,
Ball i zbet` e-i adhuroar sikur t`ishe nër të gjallët..
Se guxove të na thuash me kalem të zi në kartë
Mall` e Math që të pat djegur: fjalët e Gjuhës së Zjartë.*

Kur e përgatitën këtë libër, studentët shqiptarë të Austrisë ishin ende të ulur në aulat universitare. Studionin kush për drejtësi, apo për ekonomi, filologji, mjekësi... Por në fakt mund të thuhet se kjo përmbledhje shkrimesh kushtuar Naim Frashërit, ishte diploma e tyre e vërtetë, më e merituar. Në frymën e kësaj diplome, të certifikuar me ndjenja e shërbesa të larta atdhetarie, ata do t`i hynin jetës së tyre të mëpasme - me angazhimet dhe përpjekjet intelektuale nëpër aksionet dhe sfidat sociale të kohës. Naimi, me sa dukej do të ishte zëri që do të kumbonte në zemrën dhe në koshiencën e tyre. Ai zë do të ishte këmbana gjëmonjëse e thirrjes kombëtare, që siç do të shkruante Helenau, do të dëgjohej e do të triumfonte përtej zhurmës politike, zhurmës së hasmërive, inateve e grykësisë. Duke i ndjerë e përcjellë këto mesazhe, si aq aktuale edhe sot për botën shqiptare, rikonfirmohet prania vijuese, madje e nevojshme e poetit mes nesh.

Ky libër i studentëve shqiptarë të përgatitur në përkujtim të 25 vjetorit të ndarjes nga jeta të Naimit, ishte në fakt dëshmi dhe apel i fortë antiamnezije, dëshmi e mbajtjes gjallë të kujtesës e të shpresës. Autorët e përfshirë në të, me zellin e dëshmuar shërbestar e adhurorjës për misionin/detyrën e marrë përsipër, na kujtojnë e ngjajnë ashtu si rojtarët e kujdestarët besnikë, apo si rabinët e përkushtuar ndaj librave të shenjtë, ndaj Testamentit të Madh, në këtë rast, të Testamentit Poetik Naimian. E këta rojtarë besnikë, vazhdojnë sot e kësaj dite, ku përfshihen edhe organizatorët e paepur dhe pjesëmarrësit e Festivalit Ndërkombëtar të Poezisë në Tetovë: Ditët e Naimit. Gjithëshka që bëhet në përkujtim të kësaj figure, i ngjan një

thjerrëze gjigande që i tërheq porositë që vijnë prej kësaj vepre, për t`i rrezatuar pastaj në një regjistër të shumëfishuar, që merr përmasën e metaforës së njohur të Porosisë së Madhe, të artikuluar bukur prej dijetarit të shquar Rexhep Qosja.

‘DITËT E NAIMIT’ – MODEL I NDËRKOMUNIKIMIT BASHKËKOHOR LETRAR E KULTUROR

Shaip EMËRLLAHU

Letërsia dhe kultura në përgjithësi, ndër vite kanë njohur modele dhe tipe të ndryshme ndërkomunikimi. Këto nivele dialogimi, të cilat kanë qenë shumështrësore, kanë bartur peshën e zhvillimit dhe afirmimit letrar e kulturor. Në dhjetravjeçarët e fundit, ato formate komunikimi janë begatuar, duke bërë që plotënia e polivalencës, polifonisë, shumëkuptimësisë dhe e shumështrësimit të veprave letrare, pra e botës së veprave kulturore në përgjithësi, ngado që ta ketë origjinën, të shkojë te recepiensi (publiku).

Në mesin e shekullit XX nisën proceset integruese në koin-tinentin tonë dhe më gjërë. Tendencat e globalizimit morën formë të qartë në projektin - Identiteti evropian. Arkitektura e Bashkimit Evropian u frymëzua kryesisht nga kultura e et-nive të saj, nga trashëgimia e diversitetit kulturor. ”Krerët e shteteve dhe qeverive, kulturën e quajnë si, themelin kryesor të Evropës, e cila përcaktohet më pak nga gjeografia, se sa nga vlerat e përbashkëta që i bashkon popujt e saj.”¹ Ndërkaq, ar-

1 EUROMEDINCULTURES: “Cili është vendi që zë kultura në Evropën e së nesërme

tizani i ndërtimit evropian Denis de Rogemont, i cili kuptimin e nocionit kulturë e ka më të gjërë, shprehet se, "kultura është bashkimi i ëndrrave dhe punëve, të cilat synojnë realizimin e plotë të njeriut. Kultura kërkon të arrijë këtë marrëveshje paradoksale: të ndryshojë parimin e bashkimit, të thellojë dallimet, jo për t'i ndarë ato, por për t'i përmirësuar më tepër.² Politikat kulturore, gjithënjë e më shumë gjejnë vend në politikat e të ardhmes evropiane. Në frymën e globalizimit, deri më sot, janë miratuar deklarata të shumta dhe po implementohen programe kulturore disavjeçare, me qëllim të ngritjes së strategjive dhe gjetjes së teknikave të ndërkomunikimit kulturor. Ndëkaq, mekanizma të ndryshëm të Bashkimit Evropian në qendër të veprimtarive të tyre kanë projektuar dialogun ndërkulturor, këmbimin e përvojave "promovimin e identitetit evropian përmes promovimit të dallimeve kulturore"³.

Kështu, një model i promovimit të diversiteteve, të ndërkomunikimit letrar e kulturor është edhe ai i festivaleve ndërkombëtare. Ato kanë qenë dhe vazhdojnë të jenë edhe tani një arenë, ku dialogohet nga afër në nivel subjekti letrar dhe kulturor, në nivel prodhimi letrar, gjuhësor dhe të atij etnik. Tek ata ekzistojnë hapësira përkatëse për të ngritur urat e një bashkëpunimi ndërkulturor, për të këmbyer përvojat dhe informacionet në mes artistëve, poetëve, njerëzve të muzikës etj, por, edhe në mes të operatorëve të ndryshëm kulturor. Festalet paraqesin shenjë e një lëvizshmërie të përbërësve të strukturës së trashëgimisë dhe të diversitetit kulturor. Ata janë një kuvend, i një ndërkomunikimi shpirtëror e frymor, i një kryqëzimi të prirjeve dhe rrezatimeve të vlerave të zhvillimit të popujve nga qytetërime të ndryshme. Ta riafirmojmë, të diturën, se, "Kultu-

së bashkuar", f. 2, Tiranë, 2010

2 Denis de ROGEMONT: "28 shekuj Evropë", "Kultura", Shkup, 1997

3 Biljana PRENTOSKA: Programa 'Kultura na Evropska Unija 2007-2013' edinstvo lo raznolikost / unity in diversity, st..2, Skopje, 2009

ra, ndodhet në zemër të qytetërimit dhe zhvillimit njerëzor⁴. Kualiteti i qytetërimit, ndikohet nga performanca e ndërtimit të një bashkëbisedimi, pra, “nga cilësia thelbësore e kuvendimit frymor dhe shpirtëror⁵. ”Shpirti i një populli, thotë Alen Boske, pasqyrohet në poezinë e tij, më mirë se, në çdo formë tjetër të artit”. Dialogimi i eksperiencave, koncepteve e ideve letrare të popujve të ndryshëm, përmes takimeve letrare dhe kulturore të formatit të një shënjesi kulturor e letrar, shpërfaq më së miri ngecjet dhe ecuritë përkatëse të tyre.

Një model i këtillë i ndërkomunikimit bashkëkohor letrar e kulturor është padyshim edhe Festivali Ndërkombëtar i Poezisë “Ditët e Naimit” me seli në Tetovë. Ai u ngrit para 20 vitesh për të përkujtuar figurën e poetit tonë kombëtar. U ideua në frymën e ndërtimit të një komunikimi e dialogimi brendashqiptar, i cili ishte prerë me kufi getiozimi të totalitarizmit komunist dhe atij të hegjemonizmit sllav. Ky projektshënjesi kulturor paraqiste një sprovë, ku do të vendoseshin pranë e pranë subjekti letrar e kulturor në përgjithësi, dhe letërsia shqipe, përkatësisht poezia shqipe në veçanti, si një dhe e pandarë në një dialogim mes veti dhe me vonë me ate të huajën. Takimi letrar i Tetovës, shenjoji rinjohjen mes vete, pra, aty u promovua ndërkomunikimi i shumëzuar brendashqiptar. Më vonë, ky komunikim u zgjerua jashtë kufijve të arealit letrar e kulturor shqiptar. ‘Ditët e Naimit’, thotë kritiku dhe njëri nga themeluesit e këtij institucioni, Ahmet Selmani, udhëhiqet nga një synim i këtillë, duke thyer barrierat pak nga pak, të arrijë atje ku është vonuar letërsia shqiptare, të paktën t’i hapë dyert dhe t’i krijojë këto mundësi ndërkomunikuese me botën...’.

Në fjalët tona të hapjes së edicioneve të Festivalit Ndërkombëtar të Poezisë ‘Ditët e Naimit’, vazhdimisht kemi nënvizuar dhe afirmuar vlerat e ndërkomunikimeve bashkëkohore letrare

4 EUROMEDINCULTURES: Po aty, f. 3

5 Dr. Agron TUFA: “Simfonia e qëndresës”, (Parathënie e antologjisë së poetëve pjesëmarrës), f. 10, “Ditët e Naimit”, Tetovë, 2008

e kulturore që kanë reflektuar 14 edicionet e këtij shenjuesi kulturor, i cili çuditërisht flet nga cepi i gjeokulturës sonë, Tetova. Mbase, kjo është edhe një tregues se, aty ku ndodh ndeshja e diversiteteve, kjo formë komunikimi favorizon shkëputjen nga "rrethi vicioz i provincializmit dhe izolimit kulturor"⁶, rimburson rrjedhjet dhjetravjeçare në këtë drejtim, si dhe paraqet formën e vetëdijes sonë globaliste për të komunikuar, ruajtur dhe afirmuar identitetin tonë kulturor e shoqëror.

Festivali Ndërkombëtar i Poezisë "Ditët e Naimit" është operatori i parë poetik dhe kulturor, i cili në krye të herës, e gjykoj si të domosdoshme rivendosjen e një infrastrukture moderne ndërkombëtare me kulturën dhe letërsinë e huaj, (pra me subjektin poetik dhe me vetë poezinë botërore). Ky festival, ka marrë dimensionin e një institucioni të shquar kulturor, (...) aktivitet ky, ku takohen jo thjesht poetët e vendeve të ndryshme të botës, por para së gjithash, kulturat e popujve, si dëshmi komunikimi, njohjeje e stime reciproke⁷. Ai u bë prurësi dhe përhapësi i llojit të vet të multikulturalizmit, ku kryefjala është poezia, kjo "formulë magjike që i lidh njerëzit dhe popujt"⁸.

Ismali Kadare, pas përfundimit të edicionit të VI të Festivalit, (ku u laurua me çmimin e madh 'Naim Frashëri'), do të deklarojë, se "Duke parë ate pjesëmarrje të gjërë të poetëve që vinin nga vende të ndryshme u pa qartë prirja për hapje drejt Evropës dhe botës. Kultura shqiptare dhe vetë kujtimi i Naimit të Madh, të gjitha këto bëjnë pjesë në qytetërimin evropian"⁹.

Në këtë aktivitet të përvitshëm kulturor, i cili ngritet mbi një program të larmishëm të artit poetik, pamor, muzikor, e skenik vijnë dhjetëra poetë, piktorë, këngëtarë, aktorë të skenës dhe

6 Dr. Agron TUFU: Po aty, f. 10

7 Prof.dr. Ymer ÇIRAKU: 'Drita e poezisë' (Parathënie e antologjisë 'Këngë deti'), f.5, 'Ditët e Naimit', Tetovë, 2010

8 Ahmet SELMANI: 'Komunikimi poetik si utopi dhe vizion' (Parathënie e antologjisë "Kur të digjemi", f.6 'Ditët e Naimit', Tetovë, 2006

9 Ismail KADARE: "Ditët e Naimit"-manifestim dinjitoz" (deklaratë), f. 14, 22 tetor 2002, FLAKA, Shkup

botues nga vende të ndryshme. Aty përmes aktiviteteve të shumta dhe të ndryshme brenda një edicioni, shpalosen vlerat e botës së artit dhe kulturës shqiptare, por edhe të asaj botërore. Janë një sërë performancash të leximeve letrare, përrurime të librave të poetëve pjesëmarrës të botuara nga shtëpia botuese e festivalit, pastaj debate mbi letërsinë dhe artin nëpërgjithësi, sesione shkencore, ekspozita të pikturave dhe skulpturave të autorëve shqiptarë dhe të huaj, revy e valleve dhe veshjeve kombëtare shqiptare të regjioneve të ndryshme, ekzekutime të korreve, interpretime të instrumentistëve, të këngëve folklorike dhe të muzikës klasike shqiptare, shfaqje teatrale, recitime të vargjeve të ndryshme të poetëve shqiptarë dhe atyre të huaj, vizita nëpër muze e monumente kulturore e fetare të qyteteve të ndryshme shqiptare, pastaj afirmimi i figurës dhe veprës së poetit tonë të madh Naim Frashëri, (emrin e të cilit e mban festivali), përmes ngritjes së shtatores së tij në qendër të Tetovës, organizimit të sesionit shkencor e botimit në një libër të punimeve të tij në 100 vjetorin e vdekjes, ndarjes së disa çmimeve që mbajnë dhe lidhen me emrin e tij, (si çmimi i madh 'Naim Frashëri', 'Qiriu i Naimit', dhe 'Ditët e Naimit'), pastaj botimi i një kolane të gjërë librash të autorëve shqiptarë e të huaj, botimin e përvitshëm të antologjisë së poetëve pjesëmarrës (dy antologji edhe në gjuhë të huaja), katalogjet e ekopozitave të artit pamor, broshura e pankarta, web faqja e Festivalit etj., të cilët flasin për gamën e gjërë të shumësorësisë, shumëkuptimësisë, shumëzërësisë dhe shumëvlerësisë së ndërkomunikimeve të rrafsheve kulturore të këtij shenjuesi të madh e të rëndësishëm poetik e kulturor të shqiptarëve.

Pjesa kryesore e programit të Festivalit, zhvillohen në salla kulture dhe në amfiteatro të universiteteve, përplot me artdashës. Ndërkaq, hapjet si dhe mbylljet e Festivalit, që brenda vetes mbajnë një program me shumësi ngjarjesh kulturore, e që zhvillohet në një transmetim të drejtëpërdrejtë televiziv

paraqesin një komunikim më të gjërë me pubilkun dhe shikuesin. Kështu, në këtë shenjues ndërkombëtar letrar e kulturor, ndërkomunikimi ndodh në disa rrafshe. Njëherë, brenda vetë poetëve, pjesëmarrësve dhe arteve të tyre, pastaj në mes tyre dhe publikut shqiptar. Publiku dialogon drejtëpërsëdrejti me poetët. Ai, ka mundësinë e mirë të komunikimit edhe me poetikën, pra me vlerat artistike e estetike të lirikave të autorëve, herë në gjuhët origjinale të krijimit përmes leximit nga vetë poetët, e herë në gjuhën shqipe, përmes deklamimit nga ana e aktorit. Këtë komunikim me botën letrare të tyre e bën më të lehtë edhe antologjia e botuar e poezive të pjesëmarrësve, që publikut i servohet falas para fillimit të festivalit. Kjo antologji, e cila përmban, përveç poezive, shënime biografike, fotografitë e poetëve, ilustrime e piktura të shkollave të ndryshme të piktorëve, edhe parathënie nga kritikë dhe studiues të letërsisë, të cilët theksin e vendosin në rolin dhe rëndësinë që ka ky institucion letrar e kulturor në afirmimin e poezisë e kulturës shqiptare dhe të huaj, në këmbimin e përvojave dhe informacioneve, në dialogun ndërkulturor dhe në promovimin e diversiteteve kulturore. Në të gjitha antologjitë e botuara poetike të krijuesve pjesëmarrës, (...) është krijuar një bibliotekë e vyer dhe serioze, ku mund të hetohen tendencat dhe rrugëtimet estetike të poezisë së sotme botërore¹⁰. Kështu, pra ajo mundëson hetimin më të lehtë dhe më të shpejtë të shenjave universale e sistemin tematik e motivor të ligjëritimit, mitet e legjendat, kompozicionin, figurën dhe stilin, sistemin e vargënimit etj. Jep një pasqyrë të shënimeve mbi autorin dhe veprën e tij etj.

Në 'Ditët e Naimit', kemi edhe një tip komunikimi, i cili ndodh përmes përkthimit të letërsisë së huaj në gjuhën shqipe dhe anasjelltas. Këto përkthime vijnë nëpërmjet publikimeve të veçanta, si dhe përmes botimit të antologjive të poezisë së

10 Prof.dr. Ymer ÇIRAKU: Po aty, f. 6

poetëve pjesëmarrës. Botimet elektronike, janë gjithashtu, një tjetër menyrë komunikimi e poezisë së poetëve, të cilët gjatë tërë vitit janë në dispozicion të lexuesit faqen e internetit. Poetët, theksuam më lartë se, realizojnë sipas programit vizita në qytete, ku takohen me qytetarë dhe veprimtari të tyre. Ata, njihen dhe marrin informacione mbi kulturat e ndryshme, por edhe ndikojnë në mënyrën e tyre të jetuarit. Pra, kemi ngritje të një komunikimi të drejtëpërdrejtë me botën shqiptare dhe të tjerëve të atij nënqielli. Poeti i ndjerë danez, Erik Stinus, i cili sëbashku me gruan e tij poete nga India dy herë ka qenë në Tetovë, pat deklarur, se "Ne jemi familjarizuar pak më shumë me popullin që na mirëpriti, me letërsinë e tyre, këngët e tyre, kulturën dhe historinë e tyre. Kjo përvojë do të duhej t'u garantohej të gjithë njerëzve - se sa i ngjajnë vetes së tyre"¹¹. Gjithsesi, në anën tjetër, "ky festival ka përcjellë natyrshëm dhe jehonën e poezisë e të kulturës shqiptare në këto vende, në të katër anët e rruzullit"¹². Pra, ata kanë objektivuar botën shqiptare, në poezi, cikle poezishë e vëllime të tëra, në tregime e romane, të cilat i kanë publikuar në gjuhët e tyre.

E gjithë kjo që thamë më lartë, provon se letërsisë, kulturës dhe qytetërimit tonë, me hapa të përshpejtuar i është dashur të rivendosë urat tradicionale të shkëputura të komunikimit me botën. Ndonëse, nën rregullat e frymës së hapjeve dhe të integritimeve, kjo infrastrukturë ekzistuese e shkëmbimeve kulturore e letrare nuk është më, aq funksionale. Sot, ato formate komunikimi kanë evoluar, siç kanë ndryshuar edhe sisteme e kode të tjera të ecurisë së zhvillimit të njerëzimit, duke iu përshatur tendencave të reja, të cilat na i imponon epoka e botës së dialogimit dhe e frymës integruese, pra e asaj të globalizimit. Në dritën e një formatimi të ri global, këtyre modeleve të interkomunikimit iu nevojitet një rishikim, pra një kod që do

11 Erik STINUS: Mbresat (http://ditetenaimit.org/index.php?option=com_content&view=article&id=95&Itemid=68&lang=sq)

12 Prof.dr. Ymer ÇIRAKU: Po aty.

t'iu përgjigjet kërkesave, të cilat i dikton kjo epokë unifikuese.

Cila është vetëdija, sa ekziston gadishmëria dhe sa arrijmë ta akceptojmë nevojën e modifikimit të këtyre modeleve ndërkomunikuese, kur sa vjen e dëshmohet edhe përmes këtyre festivaleve poetike, se "poezia (letërsia-SH.E.) është një mjet interkomunikues dhe interkulturore, që mund të shfrytëzohet racionalisht dhe praktikisht edhe në këto kushte moderne, kur flitet për një frymë globale"¹³.

LITERATURA

1. ÇIRAKU, Prof.dr. Ymer: 'Drita e poezisë' (Parathënie e antologjisë 'Këngë deti'), "Ditët e Naimit", Tetovë, 2010
2. Denis de ROGEMONT: "28 shekuj Evropë", "Kultura", Shkup, 1997
3. EUROMEDINCULTURES: "Cili është vendi që zë kultura në Evropën e së nesërme së bashkuar", Tiranë, 2010
4. FLAKA: 'Manifestimi ishte dinjitoz' (deklarate e Ismail KADARE), 22 tetor 2002, Shkup
5. PRENTOSKA, Biljana: Programi 'Kultura na Evropska Unija 2007-2013' edinstvo vo raznolikost / unity in diversity, Skopje, 2009
6. SELMANI, Ahmet: 'Prurjet ekzotike të poezisë' (Parathënie e antologjisë "Trokitje në mur"), "Ditët e Naimit", Tetovë, 2004
7. SELMANI, Ahmet: 'Komunikimi poetik si utopi dhe vizion' (Parathënie e antologjisë "Kur të digjem"), 'Ditët e Naimit', Tetovë, 2005
8. SELMANI, Ahmet: 'Misoranët e paqës së përjetshme' (Parathënie e antologjisë 'Zogjtë që nuk ngordhin nga helmi', 'Ditët e Naimit', Tetovë, 2006
9. STINUS, Erik: Mbresat (http://ditetenaimit.org/index.php?option=com_content&view=article&id=95&Itemid=68&lang=sq)
10. TUFA, Dr. Agron: "Simfonia e qëndresës", (Parathënie e antologjisë së poetëve pjesëmarrës), "Ditët e Naimit", Tetovë, 2008

13 Ahmet SELMANI: 'Misoranët e paqës së përjetshme' (Parathënie e antologjisë 'Zogjtë që nuk ngordhin nga helmi', 'Ditët e Naimit', Tetovë, 2006

“DITËT E NAIMIT – A MODEL OF CONTEMPORARY LITERARY AND CULTURAL INTERCOMMUNICATION

Shaip EMERLLAHU

Through years the literature has known different typologies and models of intercommunication. Along the time, these dialoguing stereotypes have carried forward the importance of literary development and affirmation. Such is also the festivals' model, which is widely known in the cultural world. The international literary festivals worldwide represent special and unique communication stereotypes. They have been and still continue to be an arena, where there is a dialogue at a closer distance of at the level of a cultural and literary subject, at a level of literary, linguistic and ethnic product.

The quality of humanity, of civilization, depends on the performance of building a conversation, a dialogue, thus 'from the spiritual dialoguing'. 'The soul of a people is reflected in its poetry more than in any other art form', Alain Bosque says. Thus, this dialogue of literary experiences of different ethnics through these literary events evidences the respective gaps and developments.

During our opening speeches of International Literary Festi-

val 'Ditët e Naimit' (Tetova), we have continually isolated and affirmed the values and the role of the contemporary literary intercommunications, reflected in all the 14 editions of this cultural event, that strangely is held in the edge of our geo-culture. Maybe this is another indicator that, where there is a clash of diversities, this communication form supports the detachment 'of the vicious circle of provincialism and cultural isolation', reimburses the decennial losses in this concern and as well, represents the form of our global consciousness to communicate, preserving and affirming the cultural and social identity.

Except the dialogue through literary readings, discussions, the International Poetry Festival 'Ditët e Naimit' communicates through the translation of Albanian literature in other languages and vice versa. These translations come in special publications as well as in anthologies of participant poets. The electronic publications are another way of communication for poets and also the different book presentations during the festival's days.

Under the light of a new global formatting of these intercommunicative models we need a reevaluation, a code representing the new demands that this unifying epoch suggests.

As for the willingness, what is the awareness and at what level can we accept the need for modification of these intercommunicative models in a time when we all are witness that in all 'these literary festivals poetry is an intercommunication and inter-cultural mean that could be utilized rationally and practically in these modern conditions as well, globally speaking'.

KOMUNIKIMET NDËRKULTURORE – SI KALEIDOSKOP I NDËRHAPËSIRËS

Dragana EVTIMOVA

Ndërkomunikimet kulturore kanë të bëjnë me aktivitetin njerëzorë, ndërsa interpretimet e ndryshme të vetë termit është pasqyrim i teorive dhe kriterëve të ndryshme të kuptimit dhe vlerësimit të aktivitetit njerëzorë në botë. Kultura është termi më i vjetër në kuptimin tradicional, dhe si e tillë ka të bëjë si me njeriun, ashtu edhe me të gjitha sferat e veprimit në epokën e njerëzimit. Në këtë mënyrë, kultura pasqyron mbi-jetesën e civilizimit. Me këtë mund të konkludojmë se kultura, si dhe ndërkomunikimet kulturore paraqesin përmbledhje të vlerave materiale dhe shpirtërore, të cilat janë nën ndikimin e kornizave tradicionale, por në të njëjtën kohë edhe të ndryshimeve bashkëkohore, të cilat formojnë sjelljen e anëtarëve në një sistem të organizuar shoqëror.

Kultura është element i pandarë i jetës. Ne të janë të strehuara të gjitha elementet individuale dhe kolektive të qëndrueshme nëpër viteve, me te cilat ajo ka mbijetuar të jetë aktuale deri sot.

Interkomunikimet kulturore, si pjese e artit, gjithmonë ride-

finohen kur është ne pyetje përshkrimi. Si fenomen thelbësor, pranimi kolektiv i interkomunikimeve kulturore është paraqitje eminente socio-kulturore. Njeriu, si qenie artistike nxjerr temat e tij nga thellësitë e burimeve kolektive dhe zëshëm i riprodhues ato. Fuqinë e konkretizimit e gjejmë tek poezia, si dhe në të gjitha format tjera të interpretimit në sferën e fjalës së shkruar. Ekzistojnë pafund çështje të pa definuar për formësimin e formës së koncentruar të poezisë.

Në suazat e festivalit „Ditet e Naimit“ janë mysafir poetë nga vende të ndryshme të botës. Në vetë festivalin, si veti karakteristike, poetët shkëmbejnë mendime dhe përvoja, ku diskutohet për shkurtësinë e vargut, në të cilin bën pjesë i gjithë thelbi në dimension metafizik. E gjithë lirika shërben si mjet për arritjen e efekteve të caktuara dhe përbërjen artistike, që përmbajnë karakter universal. Para krijimi krijon formë të veçantë e të pazakonshme të shpirtit, që ka ngjyrë të caktuar emocionale. Nuk bëhet fjalë për fenomene shoqërore dhe karakteristikat e tyre sociale, por për perfeksionin e pastër të fuqisë, e cila qetëson pa qenë dramatike.

Poezia si formë specifike e komunikimit me secilin lexues, me sukses e transformon idenë dhe parafytyrimin primarë, kështu që domethënia mbetet e pafundëshme dhe paarritur, kurse në të fillon të mbizotëroj paqartësia e kuptimit. Ideja thelbësore e poezisë është në principin që ajo i kontrollon gjerat nga brenda. Ky fenomen ndriçues nuk është vetëm akt intelektual, i ngritur mbi përditshmërinë, por mbi të gjitha ai paraqet përvojë që e përfshinë personalitetin në tërësi. Për këtë arsye, qëllimi është dituria mbi realitetin shpirtëror dhe material. Kjo etimologji dydimensionale funksionon si objekt material (imazh, ton, volum, gjest apo fjali), ndërsa në kuptimin jo material sugjeron në diçka të dhënë në hapësirë dhe kohë dhe implikon objekte të padukshme. Kësaj radhe pranë zemrës ka edhe domethënie shpirtërore dhe vetë realizim edhe në

vetë termin poezi. Nevoja për paqe shprehet në një gjendje tillë në të cilën ende nuk ekziston termin i caktuar.

Poetët shpesh u ikin mënyrës së drejtpërdrejt të tregimit dhe interpretimit të temave kryesore, që të mos ndryshoj mesazhi dhe melodija e tyre. Mu për këtë, fjalët janë konsistente dhe të privuar nga çfarëdo palogjikshmërie. Ajo që është jashtë neve është tepër subtile dhe e komplikuar që të mund të përçohet nëpërmjet komunikimit të varfër ditor. Poetët kanë sy te mprehtë, poetët janë piktorë të cilët shohin vijën me precizitetit, me paramendim dhe saktë, dhe ashtu edhe e përshkruajnë në mënyrë deskriptive. Në këtë mënyrë, natyra e pikturave poetike fiton domethënie të re koherente. Në pikturën poetike është e ngjyrosur gjeneza emotivo-intelektuale e një pozite të privilegjuar të pikturave të sapoformuara, me idenë që rrëndon çdo vetëdije të secilit poet, që aktivisht merr pjesë në festivalin „Ditet E Naimit“. Lartësimi faktorizohet në formë konfesionale të shprehjes artistike. Një disponim i butë dhe i përulur përjetohet nga brenda, duke sugjeruar një dinamikë të fortë në një mënyrë të qetë dhe të vendosur. Ky kontrast mahnit me kureshtjen e natyrshme dhe tërheqjen lirike lapidare. Nëpërmjet bilancit të jetës rrotullohet mesazh intelektual me përmasa më të gjera metafizike.

Si art, poezia ka rregullat e veta, te lidhura me perspektivën natyrore në të cilën meditimet ofrojnë pavarësi. Tendenca kryesore artistike është muzikaliteti konkret dhe i qartë, në të cilin nuk ka mbingarkim. Për këtë arsye, vlera poezisë mbete mirë e organizuar, pa dialogë, ne shikim të parë statike, por përsëri preokupimet dhe përjetimet shpirtërore në lidhjen e saj kozmike e bëjnë atë tërësisht të mirë. Momenti psikik ndodh natyrshëm dhe lexuesi është i kyçur aktivisht në të. Vetë poezia (si dhe poezia, si pjesë e veçantë) nuk lejon bredhje nëpër mistifikime të panevojshme. Përkundrazi, gjithçka e ka vendin e vet, ku mistikja ka kuptim dhe tërësi. Mundësia e kërkimit

deri në thellësi dhe nga çdo bashkim i ri të ndërtohet porosia e vetme e referencës për lidhshmëri gjithëpërfshirëse të botës dhe poetit në vet vargun, ndaras, por edhe si tërësi.

Sa i përket stilit poetik imagjnativ, kam vërejtur se shumica e poetëve e ndajmë mendimin e njëjtë: ai sikur është konkret dhe i përcaktuar saktësisht vetëm për vargjet që i lexojmë, sikur nuk mundet të dalë jashtë tyre; vargje të shkurta sikur nuk janë të motivuara mjaftueshëm dhe krejtësisht të zbrastuara; nuk kanë krahasim dhe lënë përshtypje si objekte të mjegulluara, tërësisht nominale dhe të pashpirta. Por, sidoqoftë, asnjë lexues nuk mund të ngel aq indiferent sa duket në të vërtetë në shikim të parë. Transformimi ndodhë kur zbulohen asocionet e pafundme të lidhura në mënyrë simbolike me kuptimin e thellë artistik. Pa imponim, zbulohen formësime nga brendësia, eksitim në dëgjimin tonë, orientim dhe meditime, cak, impresione dhe imazhe. E gjithë kjo është përmbushje kah atmosfera e brendshme dhe zbulim i caqeve më të larta dhe vetë-analizës. Ky zhvillim i formave në formësi konkrete është vetëm një freskim që ngitet përmbi ne. Mu në poetikë riformulohet ai dallim për kuptimin e thellë dhe të vetëdijshëm të njeriut nga njëra anë dhe sistemit (material) rutinor nga ana tjetër. E gjithë dija e përbërë është një mënyrë autentike për njohje të vërtetë të vetvetes dhe botës përreth nesh; një moto, një spërkatje e shkurtër për bashkim të vetes. Kjo domethënie e përbërë është përpjekje për shprehjen dhe zhvillimin e Unë-it të vetvetes.

Dykuptimësia e gjuhës e bën për vete lexuesin në mënyrë indirekte. Në këtë mënyrë sigurohen qartësime dhe nuk ekziston kufizim; gjithçka lëviz nga vendi në vend, abstraksioni përmbushet e aktualizohet. Gjuha, si simbol i shenjave, përmban në vete fleksibilitet dhe jo precizitet. E gjithë kjo krijon fundosje në formë të veçantë të shpirtit kah hapësira jashtëkohore të implikimit të pafund. Prezantuar gjallërisht, sferat e njeriut janë

të pakufizuara dhe pafundme, të renditura në harta dhe me efekt inovativ metafizik. Tipari dominues është përtej shqisave të njeriut, atje ku ndjehet koha kozmike, metafora e pafundme dhe aftësia jone për të menduar në imazhe.

Ndjenja se mendimet tona janë të lira, të pakufizuara, fleksibile, të adaptueshme dhe elastike në formën e tyre, nuk duket se tregojnë ndonjë gjë tjetër. Me thellimin brenda vetes, na ndihmojnë dukuritë dhe objektet për vëzhgimin dhe mishërimin, që kurrë nuk ndalet, e që është e vazhdueshme. Në lidhje me këtë fenomen, D.T. Suzuki thotë se “Dija është e pamundur pa shikuar; e gjithë dija prejardhjen e ka nga të shikuarit.”

Përsëritja e secilës poezi vjen nga meditimet. Ato janë vetëm mënyra për të shprehur veten dhe rruga drejt shpirtit të paqes. Poezia është meditim i thellë., burim i rehatisë dhe qetësisë përkrah çështjeve ekzistenciale-ditore të botës. Metoda e pushimit është me mesazh universal, me paqe dhe ngushëllim të skajshëm edhe me gjykimet më të përgjithësuara të vlerave, se gjithçka është e lejuar në poezi. Vërtetë, vargjet janë më pak të kapshme për t’u kuptuar tek disa lexues, më pak komunikative (për dallim nga tekstet prozaike) dhe përmbajnë mesazh të llojit më të përbërë. Përkundër interpretimeve të thjeshta, fjala poetike është më precize, ndërsa poeti i ndërton me kujdes fjalët.

Mu për këtë, poezia meriton vëmendje shumë më të madhe. Nëpërmjet saj, si dhe pamjeve poetike që i përçon çdo poet i mirëfilltë, theksohen bindshëm qëndrimet e nënvetëdijshme deri në finesë.

Këtë shkrim do ta përfundoja me një rrumbullakim, lëvizjen rrethore të fjalës dhe rrugëtimin e saj nëpër të gjitha imazhet poetike të një poeti të madh maqedonas, i cili pas vetes ka shumë shpërblime, sepse është preciz dhe thellësisht i saktë në analizën e cilitdo lloj arti, e ai është Venko Andonovski, që thotë se: “Flutura është gjeja e vetme në mbretërinë e kaf-

shëve, tek e cila nuk jemi të fascinuar nga trupi, por nga krahët e saj. Ndërsa krahët janë simbol i shpirtit”. Njësoj si në poezinë, bukuria e vargut nuk është në vetë leximin, por në përjetimin emocional dhe shpirtërorë të saj që dinë ta shkaktojë te ne të gjithë!

Përktheu nga maqedonishtja Remzi SALIHU

КУЛТУРНИТЕ ИНТЕРКОМУНИКАЦИИ – КАКО КАЛЕИДОСКОП НА МЕЃУПРОСТОРОТ

Драгана ЕВТИМОВА

Културните интеркомуникации се однесуваат на човечката активност, а различните толкувања на самиот термин е одраз на различните теории и критериуми на разбирање и оценување на човечката активност во светот. Културата е најстариот термин во традиционална смисла и како таква се однесува како на човекот, така и на сите сфери на дејствување во епохата на човештвото. На тој начин, културата го отсликува опстанокот на цивилизацијата. Со тоа може да се заклучи дека културата, како и културните интеркомуникации претставува збир од материјални и духовни вредности, кои се под влијание на традиционалните рамки, но истовремено и на современите промени, кои го формираат однесувањето на членовите во еден општествено организиран систем.

Културата е неделив елемент од животот. Во неа се вгнездени сите колективни и индивидуални флукуирачки елементи на годините низ кои таа успеала да остане

актуелна до денес.

Културните интеркомуникации, како дел од уметноста, секогаш се редефинираат кога е во прашање дескриптивноста. Како суштински феномен, колективното прифаќање на културните интеркомуникации е еминентна социо-културна појава. Човекот, како уметничко битие ги црпи своите теми од длабоките колективни извори и гласно ги репродуцира. Моќта на конкретизација ја има и во поезијата, како и во сите останати облици на интерпретирање низ сферата на пишаниот збор. Постојат безброј недефинирани прашања за обликувањето на збиената форма на поезијата.

Во рамки на фестивалот „Ditet E Naimit“ гостуваат поети од различни земји, од различни краеве на светот. На самиот фестивал, како карактеристична особина, поетите разменуваат мислења и искуства, каде што се дискутира за краткоста на стихот, во кој е содржана целосната суштина во метафизичка димензија. Сета лиричност служи како средство за постигнување на одредени сложени, уметнички ефекти коишто содржат универзален карактер. Пресоздавањето создава невообичаена, посебна форма на духот која има одредена емоционална боја. Не се работи за општествени појави и нивните социјални карактеристики, туку за чистата перфекција на силата која смирува без драматичност.

Поезијата како специфична форма на комуникација со секој читател, успешно ја трансформира првобитната идеја и слика, така што значењето станува бесконечно и недостижно, а во него почнува да владее неизвесноста на смислата. Фундаменталната идеја на поезијата е во принципот што ги контролира нештата одвнатре. Оваа појава на просветлување не е само интелектуален чин, издигнат над секојдневието, туку пред се искуство што ја

опфаќа целата личност. Затоа, целта е сознание на духовната и материјалната стварност. Оваа дводимензионална етимологија функционира како материјален објект (слика, тон, волумен, гест или реченица), додека пак во иматеријална смисла сугерира на нешто што е дадево во просторот и времето и имплицира невидливи објекти. Овој пат до срцето има духовно значење и автореализација и во самиот концепт на терминот поезија. Потребата за мир се изразува во една состојба за која сè уште не постои одреден поим.

Најчесто поетите го одбегнуваат директниот начин на искажување и интерпретирање на главните теми, за да не се промени пораката и мелодиката. Токму поради тоа, зборовите се конзистентни и лишени од секаква нелогичност. Она што е надвор од нас е премногу суптилно и сложено, за да може да се искаже со секојдневната сиромашна комуникација. Поетите имаат остро око, поетите се сликари кои прецизно, смислено и точно ја гледаат линијата и така и ја опишуваат на дескриптивен начин. На тој начин, природата на поетските слики добиваат ново, кохерентно значење. Во поетската слика е обоен емотивно-интелектуалниот праизвор на една привилегирана положба на новоформираните слики, смислата кон која се тежнее во свеста на секој поет кој активно учествува на фестивалот „Ditet E Naimit“. Возвошеноста се наметнува во исповедна форма на уметничко кажување. Некоје благо и смирено расположение се доживува одвнатре, во кое се сугерира силна динамика на смирен и ситуиран начин. Овој контраст восхитува со своето природно љубопитство и лапидарна лирска привлечност. Преку билансот на животот се ротира интелектуална порака со пошироки метафизички зафати.

Како уметност, поезијата има свои рамки, врзани со природната перспектива во која медитациите нудат

независност. Главната уметничка тенденција е конкретна и јасна музикалност, во којашто нема пренатрупување. Затоа, вредноста на песната не се менува, таа останува добро организирана, без дијалози, на прв поглед статично, а сепак духовните преокупации и доживувања со космичката поврзаност ја прават песната целосно добра. Психичкиот момент се случува природно и читателот е активно вклучен во тој момент. Самата поезија (како и песната, како самостоен дел) не дозволува лутања во непотребни мистификации. Напротив, се си има свое место, каде што мистичноста има смисленост и целина. Можноста да се истражува до длабочината и од секое ново соединување да се гради порака, е само репер за сеопфатна поврзаност на светот и поетот во самиот стих, одделно, но и како целина.

Што се однесува до имагинативниот писателски стил, имам забележано дека многуми од поетите го делиме истото мислење: тој како да е конкретен и точно определен само во стиховите што ги читаме, како да не може да се излезе надвор од нив; кратките стихови како да се недоволно мотивирани и сосема празни; нема компарација и оставаат впечаток на замаглени предмети, сосема номинални и без душа. Но, сепак, ниеден читател не може да остане толку рамнодушен како што навистина делува на прв поглед. Трансформацијата се случува кога се откриваат безброј асоцијации поврзани на симболичен начин со длабока уметничка смисла. Без наметнување, се откриваат обликувања одвнатре, возбуда во нашиот слух, ориентираност и медитации, цел, импресии и слики. Сето тоа е надополнување кон внатрешната атмосфера и откривање на повисоки цели и самоанализа. Ова развивање на формите во конкретен облик е само едно освежување кое се издига над нас. Токму во поетичноста се преформулира онаа разлика за длабоко и свесно разбирање на човекот

од една страна и рутинскиот (материјален) систем од друга страна. Сето сложено значење е еден автентичен начин за стварно сознание на себеси и светот околу нас; едно мото, една куса одморка за сопствено соединување. Ова сложено значење е настојување за изразување и развој на сопственото Јас.

Двосмисленоста во јазикот го придобива читателот на индиректен начин. Така се обезбедуваат недвосмислености и не постои ограничување; сè се движи од место во место, се надополнува и се осознава апстракцијата. Јазикот, како симбол од знаци, содржи своја флексибилност и непрецизност. Сета непрецизност и двосмисленост формира тонење во посебна форма на духот кон вонвременската просторност на бесконечната импликација. Сликвито претставено, сферите на човекот се неограничени и бескрајни, подредени на мапи и со иновативен метафизички ефект. Доминантното обележје е надвор од сетилните забележувања на човекот, во кое се чувствува космичкото време, бесконечната метафора и нашата способност да размислуваме во слики.

Чувството дека нашите мисли се слободни, неограничени, флексибилни, приспособливи и еластични во сопствената форма, се чини дека ништо не кажува повторно. Со задлабочувањето во себеси, нè помагаат појавите и предметите за набљудувањето и отелотворувањето кое никогаш не престанува, кое е континуирано. Во однос на тоа Д. Т. Сузуки вели дека „Знаењето е невозможно без гледање; сето знаење потекнува од гледање.“

Повторливоста на секоја песна е во медитациите. Тие се само начини за сопствено изразување и пат до мирен дух. Поезијата е длабока медитација, извор на спокојство и смиреност со егзистенцијално-секојдневните прашања во светот. Методот на мирување е со универзална порака, со

огромен мир и безгранична утеха и со најопшти вредносни судови дека сè е дозволено во поезијата. Навистина, стиховите се помалку достапни за разбирање кај одредени читатели, помалку комуникативни (за разлика од прозните текстови) и носат посложен вид на порака. Наспроти просните интерпретации, поетскиот збор е попрецизен, а поетот грижливо ги конструира зборовите.

Затоа, поезијата заслужува многу поголемо внимание. Преку поезијата, како и поетските слики што ги пренесува секој добар поет, убедливо се нагласуваат потсвесните ставови до префинетост.

Овој текст би го завршила со една заокруженост, кружно движење на зборот и патување низ сите поетски слики на еден голем македонски писател, кој зад себе има многу награди, бидејќи е прецизен и суштински точен во анализирањето на секој вид уметност, а тоа е Венко Андоновски, кој вели дека: „Пеперутката е единственото нешто од животинското царство кај кое сме фасцинирани не од телото, туку од крилјата. А крилјата се симбол на духот.“ Исто како и во поезијата, убавината на стихот не е во самото читање, туку во самото емоционално и духовно доживување што умее да го предизвика во нас самите!

POEZI, MAGJI DHE DETYRAT E REJA

Niels HAV

Përshëndetje të gjithë shokëve nga Shqipëria, Kosova, Maqedonia dhe gjithë bota, që u bashkuan për ta kremtuar 20 vjetorin e Festivalit Ndërkombëtar të Poezisë “Ditët e Naimit” të organizuar nga Shaip Emërlahu.

Jemi bashkuar përrreth temave të rëndësishme. Shqipëria ka një traditë të pasur poezie dhe folklori. Sivjet është ditëlindja e 170-të e poetit kombëtar shqiptar, Naim Frashëri. Ai ishte njëri nga figurat më të shquara të Rilindjes Kombëtare. Ta nderojmë - dhe të nderojmë historinë ku ishte pjesë përbërëse - na kujton që ne të gjithë vijmë nga një vend unik dhe i përkasim një kulture të veçantë.

Globalizimi është trendi i ri, por nuk duhet të harrojmë që secili prej nesh i përket një vendlindjeje me një kulturë dhe histori unike. Jemi të lidhur me një pejsazh dhe një gjuhë. Shpirti e do gjeografinë në të cilën është i rrënjëzuar. Zemra e do tingullin e gjuhës amtare. E duam kulturën tonë të lindjes dhe kemi një krenari vendase. Të gjitha këto janë të mira dhe të shëndetshme kur i kujtojmë. Sepse kur kemi një bazë të fortë

lokale, mund t'u hapemi përshtypjeve nga kultura të tjera me autenticitet të mirëfilltë.

Ka ndodhur shumë gjatë këtyre 20 viteve të fundit. Nëpërmjet procesit të fuqizimit të identitetit vendas me poezi dhe kulturë, "Ditët e Naimit" gjithmonë kanë ngulur këmbë që të zhvillojnë dhe vendosin marrëdhënie ndërkombëtare. Pjesëmarrja në "Ditët e Naimit" është frymëzuese. Njohja e poezisë së Naim Frashërit përhapet nëpër globin nga mikpritja legjendare e Tetovës.

Shumë prej nesh kanë gjetur miq të rinj këtu dhe kanë krijuar lidhje të forta midis poetëve nga shumë rajone. Ka aq shumë gjuhë, kultura dhe fe në planetin tonë, kjo është e vërtetë - por ne të gjithë, të gjithë popujt, të gjitha kombet, jemi anëtarë të një qytetërimi botëror. Prandaj ndërkommunikimet letrare dhe kulturore janë më të rëndësishme se kurrë. Jemi më të urtë dhe më të fortë së bashku.

Kurrë më parë në historinë e botës, kaq shumë njerëz s'kanë jetuar si refugjatë ose në mërgim. Duket një paradoks që në të njëjtën kohë lulëzon nacionalizmi. Jemi poetë dhe banojmë në një komb, por edhe ne Republikën e letërsisë. Fizikisht gjendemi në Tiranë, Kajro ose Kopenhagë, por poezia është baza dhe vendlindja jonë e përbashkët shpirtërore. Ky lloj vëllazërie është i rëndësishëm.

Poezia i afrohet muzikës, dhe kur një poezi është e suksesshme, fjalët kanë një jehonë të thellë në mendje dhe shpirt. Naim Frashëri e dinte që poezia e mirë është magjike. Poezia duhet të angazhohet për bukurinë dhe madhështinë e jetës - dhe për problemet e jetës së përditshme të njerëzve të rëndomtë. Këto vite shënohet një transformim i madh. Europa ballafaqohet me sfida serioze, ashtu si gjithë bota. Të shpresojmë për një lulëzim të ri të kulturës dhe artit në paqe dhe harmoni. Festivali i poezisë "Ditët e Naimit" është një kontribut i rëndësishëm për ta realizuar këtë shpresë.

Përktheu Silke Liria BLUMBACH

POETRY, MAGIC AND NEW TASKS

Niels HAV

Greetings to all friends from Albania, Kosovo, Macedonia and rest of the world, gathered to celebrate the 20th anniversary of the International Poetry Festival “Ditët e Naimit” organized by Shaip Emerllahu.

We are gathered on important themes. Albania has a rich tradition in poetry and folklore. This year is the 170th birthday of the Albanian national poet Naim Frashëri. He was one of the most prominent figures of the Albanian national awakening (Rilindja Kombëtare). To honour him - and to remember the history he was part of - reminds us that we all come from a unique place and belong to a particular culture.

Globalization is the new trend, but we should not forget that each of us belongs to a homeland with a unique culture and history. We are linked to a landscape and a language. The soul loves the geography it's rooted in. The heart loves the sound of the mother tongue. We love our native culture and have a local pride. All this is good and healthy to remember. Because when we have a strong local foothold, we can with genuine authenticity open ourselves to impressions from other cultures.

Much has happened in these last 20 years. Through the process of strengthening the local identity with poetry and culture “Ditët e Naimit” allways insisted to develop and establish international relations. Taking part in “Ditët e Naimit” is inspiring. The knowledge of Naim Frashëri’s poetry spread across the globe by the legendary hospitality of Tetova.

Many of us have met new friends here and attached strong ties between poets from many regions. There are so many languages, cultures and religions on our planet, that is true - but we are all, all people, all nations, members of one global civilization. Therefore literary and cultural inter communications is more important than ever. We are wiser and stronger together.

Never before in the world history so many people have been living as refugees or in exile. It seems a paradox that nationalism flourishes at the same time. We are poets and reside in a nation, but also in the literary republic. Physically we are in Tirana, Cairo or Copenhagen, but poetry is our common spiritual homeground. This kind of brotherhood is important.

Poetry adjacent to music, and when a poem is successful the words have a deep resonance in the mind and soul. Naim Frashëri knew this, good poetry is magical. Poetry must be committed to life’s beauty and grandeur – and to problems in ordinary peoples daily life. Things are undergoing a major transformation these years. Europe face serious challenges, like rest of the world. Let us hope for a new flowering of culture and art in peace and harmony. The poetry festival “Ditët e Naimit” is an important contribution to realizing this hope.

NAIM FRASHËRI: POET LIBERAL DHE LUFTËTAR KOMBËTAR

Dinos S. KUBATIS

Në të gjithë botën, edhe sot, historianët dhe skolastikët flasin për Naim Frashërin, një personalitet i madh shqiptar, i cili, i kushtoi jetën e tij luftës kundër turqve, pushtues të vendit të tij, të quajtur Shqipëri, dhe krijoi poezi të frymëzuara për të lavdëruar historinë dhe jetën e atdheut të tij, që fillon në qytetërimin e hershëm njerëzor, nga paraardhësit e lashtë me emrin pellazg.

Naim Frashëri u lind më 25 maj 1846, në fshatin Frashër të Përmetit, një qytet i rëndësishëm i Shqipërisë, ku në atë kohë, epoka e vonshme osmane, popullata ishte e përzier (shqiptarët dhe vlllehët), dhe vlllehët ishin krenarë me pohimin se familja e Naim Frashërit ishin me origjinë vllehe. Emri i babait të tij ishte Halit Beu, i cili zbriste nga mbajtësit e tempullit, që rrjedhin nga rajoni i Beratit përpara se të vinin në fshatin Frashër, nga ku mori mbiemrin Naimi dhe dy vëllezërit të tjerë të tij, Abdylit dhe Samiu.

Nga nëna e tyre (Ermin Hamin) vëllezërit Frashëri ishin nipërit e Imrahor Iljaz Beut, një komandant i shquar shqiptar osman nga zona e Korçës.

Nga fëmijëria e tij, Naimi e kalonte kohën e tij duke mësuar dhe studiuar gjuhën turke dhe persiane, dhe në anën tjetër duke e frekuentuar teqen bektashiane, për të vazhduar besimin tradicional të familjes.

Më vonë, duke qenë një udhëheqës kombëtar, ai kuptoi se njerëzit mund të jenë të lirë të besojnë në fe të ndryshme dhe, më në fund, se më e rëndësishmja ishte që të kishte një besim të madh dhe të jashtëzakonshëm ndaj atdheut të vet.

Të tre vëllezërit Frashëri, morën rrugët e tyre të veçanta në moshë të rritur. Pra, Abdylë, pas vdekjes së babait u bë më i madhi, kreu i familjes dhe tregtar, ndërsa Naimi me Samiun, pas vitit 1865, kur familja u zhvendos në Janinë, mori pjesë në shkollën Zosimaia. Pas studimeve atje, Samiu udhëtoi në Amerikë, ku themeloi Kishën e Parë Ortodokse Shqiptare, pasi Shqipëria ishte ende nën pushtimin turk.

Për sa i përket Naimit, ai ishte nga një familje fisnike dhe besnike ndaj familjes së Rendit Bektashian, ai u bë një oficer otoman në Sarandë, Berat dhe Janinë, përpara se të shkonte në Stamboll për t'u bërë punonjës shtetëror në Ministrinë e Kulturës Otomane. Duke qenë aty, ai ishte i detyruar të nënshkruante shkrimet e tij në fillim (N.F.), sepse censura osmane nuk lejonte shkrimet e tij kundër pushtimit turk në Shqipëri.

Zgjimi Kombëtar Shqiptar, Rilindja Kombëtare ose Rilindja Kombëtare i referohet periudhës 1870 deri në Deklaratën e Pavarësisë së Shqipërisë, në vitin 1912. Aktivistët e saj quhen "Rilindas".

Nëse duam të kujtojmë, Perandoria Osmane u përpoq të parandalonte ngritjen e bejlerëve lokalist, të cilët paraqitnin një kërcënim për pushtetin e centralizuar nga periudha e epokës së hershme të viteve 1800-ta. Pra, pas rënies së Pashasë së Janinës, fuqia dhe ndikimi i bejlerëve shqiptarë ishte zbehur. Një asamble u mbajt në Berat në vitin 1828. Në Konventën e parë të formuar, udhëheqësit ishin Ismail Bej Qemali, Zylyf-

tar Poda dhe Shahin bej Delvina. Në vitin 1830, Porta e Lartë dërgoi një forcë ekspeditive nën komandën e Reid Mehmed Pashës për të shtypur bejlerët lokal shqiptarë, por udhëheqësit më të fuqishëm lokalë, Zylyftar Poda, Veli Beu dhe Arslam Beu vendosën të përgatisnin forcat e tyre për t' i rezistuar. I frikësuar nga kjo ngjarje, Reid Muhamed Pasha i ftoi bejlerët shqiptarë në një takim me pretekstin se ata do të shpërbleheshin për besnikërinë ndaj Portës dhe i vranë të gjithë.

Vite më vonë, poeti kombëtar i Shqipërisë, Naim Frashëri, mbështeti idenë e madhe të revolucionit, zgjimin e vendit të tij, dhe si një udhëheqës shpirtëror, ngre emblemën e lirisë dhe shkruan ndër të tjera:

*Ti Shqipëri, më ep nder, me ep emrin shqipëtar,
Zëmrrën ti ma gatove plot me dëshirë e me zjarr!*

*Shqipëri, o mëma ime, ndonëse jam i mërguar,
Dashurinë tënde kurrë zemra s' e ka harruar.*

Dhe kështu me radhë, për të deklaruar besimin e tij në vendin e tij dhe pasionin e tij për çlirimin e popullit të tij. Ndërkohë, gjatë sulmit të turqve në 1881, Naim Frashëri u burgos deri në 1885 dhe u internua deri në vdekjen e tij shtatë vjet më vonë. Poema e tij e madhe dhe madhështore “Bagëti e Bujqësi”, nga e cila kemi pasur një pjesë më lart, nuk është i vetmi krijim poetik kundër osmanëve dhe për t' u bërë thirrje bashkatdhetarëve të tij për të luftuar për liri. Naim Frashëri, si poet, ai duhet të na jepet në mbarë botën, një varg të ajeteve dhe poezive, veçmas nga epikat e tij. Në poezinë e tij, ai donte të përdorte një gjuhë të thjeshtë, në mënyrë që njerëzit të kuptonin qëllimet e tij. Sepse, romantizmi- nëse ka epike, në stil, mund të frymëzojë jo vetëm lexuesit, por çdo popull që mund të dëgjonte poezitë e tij, si në vijim:

*Në mes tuaj kam qëndruar
E jam duke përvëluar,
Që t'u ap pakëzë dritë,
Natënë t'ua bënj ditë.*

*Do të tretem, të kullohem,
Të digjem, të përvëlohem,
Që t'u ndrinj mir' e të shihni,
Njëri-tjatërin të njihni.*

*Për ju do të rri të tretem,
Asnjë çikë të mos mbetem,
Të digjem e të qanj me lot,
Se dëshirën s'e duronj dot.*

*Unë zjarrit nuk i druhem
Dhe kurrë s'dua të shuhem,
Po të digjem me dëshirë,
Sa të munt t'u ndrinj më mirë.*

*Kur më shihni se jam tretur,
Mos pandehni se kam vdekur;
jam i gjall' e jam ndë jetë
jam në dritët të vërtetë,*

*Unë jam në shpirtin tuaj,
Mos më kini për të huaj,
M'është falurë durimi,
Andaj po digjem si trimi,*

*Se ma k'ënda t'u bënj mirë,
Të mos mbeti n'errësirë.
Jakëni rreth meje rrini,*

Flisni, qeshni, hani, pini,

*Në shpirt kam dashurinë,
Pa digjem për njerëzinë,
Lemëni të përvëllohem,
nukë dua më të ftohem,*

I ndjekur nga censura osmane (turqit zakonisht i dogjën librat dhe letrat e tij) shpesh shkruante në gjuhë të ndryshme si persisht (një vepër), greke (dy vepra), turke (katër vepra) dhe shqip (pesëmbëdhjetë vepra) , dhe pas të gjithë për të fshehur shkrimet e tij në çanta dhe thasë të grurit.

Në poezitë e tij mund të takojmë edhe ndjeshmërinë, si ndjenjën e bamirësisë për të mirën e popullit dhe nga bazat e tij bektashiane, ai qëndronte pranë qenies njerëzore. Pra, mund ta dallojmë interesin e tij për të mirën e përbashkët dhe qasjet shoqërore ndaj fesë, nën një perspektivë të bollshme të konfrontimit të përbashkët. Së paku ai beson se, çdo fe përfundon të njohë një Zot të vetëm, nën emra dhe aspekte të ndryshme. Ai shkruan:

Besojmë Zotnë q' është' i vërtetë,
Se gjithë ç' shohëm është' ay vetë,
Dhe falëtores kemi njerinë,
Atje e gjejmë dhe Perëndinë.
Ëngjëllë thuhetë vetij' e mirë,
Dhe djalli ështëë pun' e pështirë.
Njeriu s' vdes' po vetëm ndërrohet,
Dhe shpirt i ndyrë kurrë s' gëzohet.
Njerin' e bëri Zoti të lirë,
Po duhet kurdo të bënjë mirë,
Dhe i dha mëndjen që të peshonjë,
Dhe të paudhat t' i largësojnë.

Të mos përflasë, të mos qërtonjë,
Të jet' i urtë, me nder të rronjë,
Shpirti na thotë të bëjmë mirë,

Së fundmi, ai i këshillon shqiptarët që të mos bëjnë dallim mes të krishterëve dhe myslimanëve, por të lejojnë njëri-tjetrin të besojë ashtu siç dëshirojnë, sepse ata kanë të njëjtën origjinë dhe flasin të njëjtën gjuhë. Prandaj:

*Për Shqipërinë
Ditët e mira
Paskëtaj vinë
Shkoj errësira,
Lum kush të rronjë,
T'a shohë zonjë!*

*Se Shqipëtar
E gjuh' e tija
Venë së mbari
Dhe Shqipëria,
Lum kush t'a shohë
Për pakë kohë.*

*Pa dituritë
Dhe mbrothësija
E mirësitë
Dhe njerëzija
Do të burojnë
Nukë mënojnë.*

Naim Frashëri duhej të luftonte kundër turqve, për vendin e tij dhe gjuhën shqipe. Ai pyeti veten: “Shikoni, çfarë gjuhe! / Ashtu si gjuha e Perëndisë”, dhe luftoi fort për të zgjidhur problemin e gjuhës shqipe në mënyrë që të gjendet një shkrim

modern për të shprehur gjuhën e denjë.

Kush ishte saktësisht Naim Frasheri? Pavarësisht nga kërkimi dhe gjetja. Naimi, njeri i vetëdijshëm, na thotë vetë:

*në shpirt kam dashurinë,
pa digjem për njerëzinë...
në më doni si u dua,
njëri-tjetërin në doni...
pa jam bërë shumë herë
zjar e uj' e balt' e erë.
jam një shkëndijë pej qielli
dhe një drudhëzë pej dielli.
Dhe është plotësisht e vërtetë ! ...*

Por, a është Naim Frashëri edhe një poet metafizik? Kështu mendoj. Te leximi i poezisë së tij të shkëlqyer “Fjalët e Qiriut” ne mund t’a gjejmë atë. Ai u flet njerëzve, duke u thënë atyre një perspektivë për njëri-tjetrin, për të fituar përjetësinë, me veprime të gëzuara, ndërsa ai vetë deklaroi origjinën e tij qiellore. Le të shohim së bashku disa vargje të fuqishme të kësaj poeme, si:

*Në mes tuaj kam qëndruar
e jam duke përvëlur,
që t’u ap pakëzë dritë,
natënë t’ua bënj ditë.*

*kur më shihni se jam tretur,
mos pandehni se kam vdekur;
jam i gjall’ e jam ndë jetë
jam në dritët të vërtetë,*

*unë jam në shpirtin tuaj,
mos më kini për të huaj,*

*pa jam bërë shumë herë
zjar e uj' e balt' e erë.
jam një shkëndijë pej qielli
dhe një drudhëzë pej dielli.*

*edhe ndër qiej fluturonj,
edhe brënda në det qëndronj,*

Me fjalët e tij të mrekullueshme, dëshiroj të përfundoj këtë studim të vogël, për një personalitet të madh siç ishte Naim Frashëri, i cili, nga qiejt mund të shikojë tokën, Shqipërinë e tij të dashur dhe njerëzimin, për të cilin ai luftonte gjallë.

Salamis-Greece
17 October 2016

Përktheu: Edita Kuçi Ukaj

NAIM FRASHERI: LIBERAL POET AND NATIONALIST FIGHTER

DINOS S. KOUBATIS

All over the world, still nowadays, the historians and scholastics speak about Naim Frasheri, a great Albanian personality, who devoted his life to fight against the Turks, occupants of his country named Albania, and used to create inspired poems to glorify the history and the life of his motherland which begins in early human civilization, by the first albanian people named Pellasgians.

Naim Frasheri was born on 25 May 1846 in the village of Frasher in Permeti, an important city of Albania, where at the time, late ottoman era, the population were mixed (Albanians and Vlachs) and the Vlachs were proud saying that the Naim Frasheri's family were of Vlach origins. His father's name was Halit Bey, who descended of timar holders they hailed from the Berat region before coming to live in Frasheri village, from where Naim and two other brothers of him, Abdyl and Sami, took their surname.

By their mother (Ermin Hamin) the Frasheri brothers were grandsons of Imrahor Ilyas Bey one distinguished Ottoman Al-

banian commander from the Korca area.

By his childhood, Naim used to spend his time to learning and studying the Turk and Persian languages, and on the other hand frequenting the Bektashi tekke, in order to continue the family's traditional faith.

Being a national leader, later, he understood that people may be free to believe to different religions and that after all, that the more important was to have a great and enormous faith to his own homeland.

The three Frasheri brothers took their separate roads being adults. So, Abdyl, after the father's death became as eldest the head of the family and merchant, while Naim with Sami after 1865 when the family moved to Ioannina, attended the Zosi-maia School. After their studies there, Sami traveled to America where he established the First Orthodox Albanian Church, as Albania was still under Turk occupation.

Concerning Naim, as he hailed from a noble and faithful to Bektashi Order family, he became an Ottoman officer in Sarande, Berat and Ioannina before he moves to Istanbul in order to become a State employee in Ottoman Culture Ministry. Being there in, he was obliged to sign his writings in initial (N.F.) because the ottoman censorship didn't permit his writings against the Turk occupation in Albania.

The Albanian National Awakening or the National Renaissance or the National Revival and in albanian language "Rilindja Kombëtare" refers to the period from 1870 until the Albanian Declaration of Independence in 1912. Its activists are called "Revivalists" and in albanian "Rilindas".

If we want to remember, the Ottoman Empire tried to prevent the rise of local beys, which presented a menace to centralized power by the period of early 1800 era. So, after the fall of the Yanina Pashalik, the power and influence of the Albanian beys had faded. An assembly was only held in Berat in

1828. In the formed first Convention, the leaders were Ismail Bey Qemali, Zylyftar Poda and Shahin bej Delvina. In 1830, the Sublime Porte sent an expeditionary force under the command of Reşid Mehmed Pasha to suppress the local Albanian beys, but the most powerful local chiefs, Zylyftar Poda, Veli Bey, and Arslan Bey, decided to prepare their forces to resist. Afraid by this event, Reşid Mehmed Pasha invited the Albanian beys to a meeting on the pretext that they would be rewarded for their loyalty to the Porte, and killed all of them.

Flag used during the *Albanian National Awakening*.

Years later, the national poet of Albania, Naim Frasheri, endorse the great idea of the revolution and awakens of his country and as a spiritual leader, rise the emblem of the liberty and writes among other ones:

*You, Albania, give me honor, give me the name Albanian,
my heart you kneaded with desire and fire.
Albania, oh mother of mine, though I am émigré,
your love, my heart can never forget .*

and so on, to declare his faith to his country and his passion for its people liberation. Meanwhile, during the Turks attack in 1881, Naim Frasheri was imprisoned until 1885 and exiled until his death seven years later.

His big and great poem “Bageeti e Bujqesi” (“Herds and Pastures”), from which we had a part above, isn’t the only poetic creation about the Albanian Renaissance. He wrote many verses in order to glorify the albanian fight against Ottomans and urge his compatriots to fight for liberty.

Naim Frasheri, as poet, he has to give us and all over the world, a great deal of verses and poems, separately of his epics

ones. In his poetry, he loved to use simple language in order that people could understand the meanings. Romantic –if no epic-, in style, could inspire not only the readers but every people he might heard his poems as following:

*Amongst you I stand
and I am broiling
to hand out a little light,
turn your night into daylight
I'll be exhausted, drained out
burned, scalded
so I can enlighten your sight
each other to recognize
For you I will exhaust myself.
Let nothing of me remain,
burning and shedding tears
because this desire I can't bear
Fire I do not fear.
Never want my flames to slake.
Rather burn with desire
lighten you up to my best
When you see me exhausted
do not think that I am dead.
I am alive, I am living
I am in the true light.
I am inside your soul.
Do not take me for extraneous.
I was blessed with patience.
Therefore, I burn bravely.
Much I like to do well
for you not to dwell in obscurity.
Come, around me sit
talk, laugh, eat, drink*

*I have love in my soul
hence I burn for humanity.
Allow me to be scalded,
I don't want to cool down.*

Chased from the ottoman censorship, (the Turks usually burned his books and papers), he used to often write in different languages as Persian (one work), Greek (two works), Turkish (for works), and Albanian (fifteen works), and after all to hide his writings into bags and sacks of grain.

In his poems we can meet, too, the sensibility, as the sense of charity for the good of the people and by his Bektashi foundations, he stood near the human being. So, we may distinguish his interest for the common good, and social approaches to religion, under an ample perspective of common confrontation. At least he believes that any religion conclude to recognize one only God, under different names and aspects. He writes:

*We believe in the true God
who is the universe itself.
Without him there is no place.
He is the beginning and the end.
Wherever we look,
we see his face.
He is everything in this life,
he is the true God!
The blossoming flowers
betray his beauty.
He is the rose.
He is himself the nightingale,
and when the true God
wanted to reveal himself to the world,
he then created man.*

Finally, he advises the Albanians not to make a distinction between Christians and Moslems, but to let each other believe as he wants for they have the same origin and they speak the same language. Therefore:

*For Albania,
joyous days
are at hand.
The darkness is receding.
Happy is he who will live
to see her reign!*

*For the Albanian
and his language
are at one.
With Albania
happy is he who will
behold her soon!
Knowledge
and progress
Goodness.
And humanity
will arise
never to stray.*

Naim Frasheri had to fight against the Turks, for his country and the Albanian language. He wondered: "Look, what a language! / Like God's language!", and strongly fought to resolve the "albanian language problem" in order to be found a modern writing to express the worthy language.

Who exactly was Naim Frasheri? No matter to search and find. Naim, conscious man, he says to us by himself:

*I love the humanity
the kindness and the wisdom.
If you become my friends
If you love me as I do...
Many times I have become
fire and water and mud and wind.
I am a spark from the sky
and a ray of sunshine.
And it's complete true!...*

But, is Naim Frasheri a metaphysical poet too? I think so. Reading his superb poem "The Words of The Candle" we can find that. He speaks to the men, saying them about one another perspective in order to gain the eternity, by merry actions, while he, himself declares his celestial origin. Let's see together some powerful verses of this poem, as:

*Here among you have I risen,
and aflame am I now blazing,
just a bit of light to give you,
that I change your night to daytime,
.....*

*When you see that I have vanished,
do not think that I have perished,
I'm alive, among the living
In the rays of truth I'm standing,
in your souls do I take refuge.
Do not think I'm stranger to you.
.....*

*Many times have I turned into
Earth and wind and fire and water.*

*I'm a spark come from the heavens,
from the sun I'm glowing embers,
through the skies I fly, a-soaring,
and live deep within the ocean*

.....

By his wonderful words, I should like to finish this little study about a great personality as Naim Frasherj, who from the heavens may look to the earth, to his beloved Albania and the mankind he had fight alive for.

Salamis-Greece
17 October 2016

NAIM FRASHËRI DHE POEZIA TAJVANEZE

Kuei-shien LEE

Sinqerisht, për shkak të ndarjes historike dhe gjeografike, nuk kam shumë njohuri për letërsinë shqipe, sidomos poezi në shqipe. Derisa mora ftesën për të marrë pjesë në Festivalin Ndërkombëtar të Poezisë “Ditët e Naimit”, kur përfitova nga rasti për të kërkuar në internet poezitë nga Naim Frashëri në anglisht për t’i lexuar. Sakaq u preka nga poezia e tij përfaqësuese “Fjalët e Qiririt” dhe e përktheva menjëherë në kinëzisht mandarin për ta botuar në rubrikën time speciale “Kanali i poezisë ndërkombëtare” në revistën “Li Poetry” për ta ndarë me lexuesit tajvanezë.

Në fillimin e poezisë së tij “Fjalët e Qiririt”, Naim Frashëri shkroi:

*Në mes tuaj kam qëndruar
E jam duke përvëlur
Që t’u ap pakëzë dritë
Natënë t’ua bënj ditë.*

Kjo strofë shpreh mjaft mirë vullnetin e vetvetes në rrethana

të vështira për të përkushtuar energjinë e vet të vogël në favor të shpresës dhe të vendimmarrjes së masës sociale. Kjo është një këmbëngulje dhe vullneti në një shpirt të vockël për ta ballafaquar pushtetin e madh. Unë kam një shprehje të ngjashme në poezinë time “Zëri i xixëllonjës”, edhe pse objekti për të cilin shkrova është një xixëllonjë:

*Në errësirën e botës
drita ime e imtë
vjen në vëmendjen e njerëzve
.....
për t'i dhënë muzgut gjallëri
dhe jetës sime kalimtarë, gjerësi
për t'i dhënë popullit tim një kujtim të vogël.*

Ka një përshkrim dhe shprehje më të afërt në poezinë “Qiriri 1” nga poetja tajvaneze Chen Hsiu-chen, që po ashtu ka qiririn si objekt:

*Digjesh vetë në vetmi
përballë errësirës së universit

Duke mbajtur mend një avokat shkëlqimi
ti e djeg veten
për ta djegur natën.*

Gjithsesi, në strofën vijuese të poezisë “Fjalët e Qiririt” nga Naim Frashëri tregohet synimi më i fortë për ta flijuar veten për t’u munduar për shkëlqimin që i përket popullit:

*Do të tretem, të kullohem,
Të digjem, të përvëlohem,
Që t’u ndrinj’ mir e të shihni*

Njëri-tjatërin të njihni.

Si poet i madh shqiptar, duke marrë përsipër përgjegjësinë për ta ruajtur dinjitetin e kombit shqiptar dhe duke nisur më tej vendosjen e personalitetit të pavarur ndërkombëtar të popullit shqiptar, Naim Frashëri në poezinë e tij shprehu plotësisht këmbënguljen, vullnetin dhe guximin e skajshëm për të nxitur njerëzit:

*Në shpirt kam dashurinë,
Pa digjem për njerëzinë,
Lermëni të përvëlohem,
nukë dua më të ftohem.*

Këto fjali tregojnë mjaft qart një ndjenjë madhështore për ta përqaftuar botën, nga perceptoj edhe shpirtin e popullit shqiptar. Shumë nga procesi i mundimshëm i Shqipërisë ka vlerë si mesim për tajvanezët. Sot, ne tajvanezët jemi në procesin ta ringjallim gjuhën tonë dhe konfrontohemi me fazën e vështirë të rindërtimit të shpirtit tanë të letërsisë. Në poezinë “Qiri-ri dhe hija 1” nga Chen Hsiu-chen, shpresa për përkushtimin shprehet kështu:

*Në errësirë
ti më kërkon
të kesh trupin tim si altar
të djegur në një feniks shkrepës.*

Procesi i mundimshëm i popullit shqiptar, sidomos guximi dhe apeli energjetik që zbulohet në poezinë e Naim Frashërit, është modeli më i mirë i mësimit për popullin tajvanez dhe poetët tajvanezë. Për më tepër, eposët e mëdhenj të krijuar nga Naim Frashëri lidhur me përkushtimin dhe vetëdijësimin e ar-

rjtjeve

të shpirtit të madh kombëtar shqiptar janë shumë përtej aftësisë së poetëve tajvaneze, që duhet t'u përkushtojnë më shumë vëmendje dhe mundim për të arritur po ashtu atë nivel.

Përktheu Silke Liria BLUMBACH

NAIM FRASHËRI AND TAIWANESE POETRY

Lee Kuei-shien

Frankly, due to the historical and geological separation, I have no much idea about Albanian literature, especially Albanian poetry. Until I received the invitation to participate the international poetry festival Ditët e Naimit, I took the opportunity to search from website the poems by Naim Frashëri in English version to read. At once, I was moved by his representative poem “Words of Candle” and immediately translated it into Mandarin to publish on my special column “the Channel of International Poetry” in Li Poetry magazine for sharing with Taiwanese readers.

At the beginning of this poem “Words of Candle”, Naim Frashëri wrote:

*Amongst you I stand
And I am broiling
To hand out a little light
Turn your night into daylight*

This stanza sufficiently expressed the willing of oneself in the hard circumstance to dedicate his small energy in favor of the hope and decision of social mass. This is an insistence and the will in a puny soul to face the great power. I have similar expectation in my poem “The Voice of Firefly”, though the object I wrote is a firefly:

*In darkness of the world
my faint light
comes into people’s notice.*

.....
*to give a vitality to the dusk
and expense my transitory life
to give a little memory for my people.*

There is more close description and expression in the poem “The Candle 1” by Taiwanese poetess Chen Hsiu-chen, aiming to same candle as its object:

*You ignite yourself in solitude
confronting with the darkness of universe*

*Keeping in the mind an advocate of bright
you burns yourself
to burn away the night.*

However, in the following stanza of the poem “Words of Candle” by Naim Frashëri, it shows more strong intention to sacrifice oneself for striving brightness belonging to people:

*I'll be exhausted, drained out
Burned, scalded
So I can enlighten your sight
Each other to recognize*

As an Albanian great poet, in taking the responsibility upon himself, for guarding the dignity of Albanian nation and further initiating the establishment of international independent personality of Albanian people, Naim Frashëri in his poem fully expressed the perseverance will and utmost courage to promote the people:

*I have love in my soul
Hence I burn for humanity
Allow me to be scalded
I don't want to cool down*

These sentences sufficiently display great sentiment in embracing the world, from which I perceive the spirit of Albania. Much of the struggling process of the Albania is worthwhile for Taiwanese to learn. Nowadays, Taiwanese is under procession to revive our language and confronts the hard stage to reconstruct our own literature souls. In the poem "Candle and Shadow 1" by Chen Hsiu-chen, the expectation to dedication is so expressed:

*In the darkness
you are looking for me
to have my body as an altar
burnt into a firing phoenix.*

The struggling process of Albanian people, especially the courage and appeal energy revealed from the poetry of Naim Frashëri, is the best model for learning by Taiwan people and Taiwanese poets. Moreover, the great epics created by Naim Frashëri in description and recognition of the achievement by great Albanian national spirit are far beyond the Taiwanese poets ability for paying more efforts to catch up.

FËSHFËRIMA E NDËRKOMUNIKIMIT

Ilir LEVONJA

Përschendetje miq të fjalës poetike!

Sonte na ka mbledhur një traditë tashmë e përvitshme. Manifestimi letrar i Tetovës, Ditët e Naimit. Plot 20 vjet shkëmbime poezish nga të katër anët e globit. Një magji e artë kulturash që ndryshe nga politika i ofron njerëzimit metaforën. Afshin plot ngjyrë muzgu të fjalës.

Ky 20-të vjetor përkon edhe me 170 vjetorin e një emri që është edhe kumbara i Festivalit tonë. Një nga korifejtë e rëndësishëm në poetikën shqiptare. Atë të Naim Frashërit.

Ne vimë nga kultura të ndryshme, por që në thelb priremi plot dilema njerëzore. Kjo na afron dhe më shumë. Kjo na bën të mendojmë se jemi njëfarësoj të barabartë pikërisht përmes këtyre dilemave.

Pak muaj më parë, botova këtu, në Tetovë, një libër me titull "Hiret e Letërsisë Moderne Shqipe". Pavarsisht kontekstit, lënda i kthehet herë më herë, qarkullimit apo ndërkomunikimeve kulturore midis nesh. Dhe unë sonte ndihem dyfish mirë që po jetojmë një natë ndërkomunikimi. Dhe po flasim pikërisht për qarkullimin e vlerave letrare.

Po sjell diçka nga teksti në fjalë. (Dhe të mendosh që është shkruar vite e vite më parë. Atëhere kur unë sapo e kisha pjekur besimin tim profetik. Se arti i fjalës është paraqitja e zogut në qiell. Me territor, por me kufij të caktuar sysh.)

Pyetjes përse shkruan, ku qindra e mijëra shkrimtarë i janë përgjigjur në mënyra të ndryshme, midis, aty..., ti gjen edhe përgjigjen tënde. Mua përshembull më ka mbetur në mendje Gabriel Garsia Markez (Gabriel Garcia Marquez) kur thotë se, shkruaj që të më duan më shumë miqtë e mi. Kjo për mua ishte një analogji e kohës sime, të më donin miqtë dhe princesha ime. Në një farë mënyre, idhujt apo idhulli im.

Tërësia e recensioneve, komenteve dhe eseve etj., i kushtohet pikërisht këtyre ... idhujve të mi. Qofshin këta edhe nga më të padëgjuarit, prapë ka diku..., një dyvargësh, një frazë, e cila është pjesë edhe e jotja.

Mendoj se të shkruash që të duan miqtë e tu (idhujt) është një përfundim ky që i shkon shumë për shtat edhe identitetit tim prej shqiptari.

Sedra përballë mikut është veçori dalluese për ne. Pasi vetëm për të mbajtur fjalën e dhënë ngrihemi edhe nga varri.

Në një farë mënyre recensionet dhe esetë apo komentet në këtë libër janë në këtë hulli, priren nga një fakt i evidentueshëm prej autorit, atë që jam përpjekur të shkruaj me dashuri.

Duke kapur detajin, i cili më ka udhëhequr deri në interpretime kritike me karakter informues, kam gjetur paralele midis fabulave dhe subjekteve në universin letrar. Kjo nuk është gjë e re sepse unë nuk jam i pari, në fund të fundit letërsia e krahasuar ka bërë hapa në këtë drejtim. Por fakti që interpretimet letrare, qoftë edhe kur do të flasim për një personazh romani, i mëshojnë një universi miqësor. Si rrjedhojë nga vetvetja ngrihen me rrethkrahërim nën vështrimin tënd, me qindra univers të tjera. Këto paralele që ne zbulojmë përkundër natyrës së gjeometrisë, na afrojnë me njeri-tjetrin për shkak të krahas-

ueshmërisë. Paralelizmi gjeometrik nuk është krahasimi letrar, sepse ky i dyti është njerëzor, që domethënë, i prekshmën, i ndijshëm dhe emotiv.

Pavarsisht terrorit dhe dasimeve shoqërore, izolimit, letërsia i dha njerëzve mundësinë, madje ajo reformoi mendësinë globale. I vendosi ata krah njeri-tjetrit në përballimin e sfidave të mëdha, si luftrat botërore apo diktaturat e proletariatit.

Ne jemi të gjithë në një front, - thotë Kamyja, - poeti, mjeku, dokeri, njeriu i zotit, ushtari, etj.

Ishte pikërisht ky vitalitet shoqëror që do të zhdukte luftën e klasave, do të hapte shoqëritë e mbyllura.

Vetëm pas viteve 90-të, njerëzit do ta kuptonin se sa shumë i ishin larguar qytetërimit, se sa absurde ishin diktaturat. Forca e qarkullimit të vlerave ishte e papërballueshme për ideologjitë, sepse konceptet shpirtërore priren kah liria, aty ku merr ekzistencë personaliteti i njeriut.

Shumë nga vendet ish diktatoriale, i kanë të pashlyeshme nga kujtesa vërshimin e masave në sheshet publike, rrëzimin me kollajllëk të miteve paradoksale, duke dëshmuar ndarjen nga një e kaluar e errët.

Era e qarkullimit i shërben etjes për tu njohur. Por edhe të drejtës universale për tu dashuruar, sepse frymëzimet janë si era, nuk njohin kufijtë e telave me gjemba.

Ngadonjëherë ne gjëndemi në beft, për arsye të thjeshtë se zbulojmë të përbashkëta, ngajshmëri, pikëpjekje të habitshme.

Vetëm përmes letërsisë arrijmë të kuptojmë se qëllimi i masave është kultivimi dhe ruajtja e paqes shpirtërore.

Le të shikojmë disa shembuj nga ky univers shpirtëror. Ja si shkruan një poet rumun, Nikita Stënesku:

Unë jam A

Petalja e britmës.

*Ti je U
Lulja e ftohtë.*

Nëse do të bëjmë një ndërkëmbim, nëse do t'i zëvendësojmë gërmat me ngjyrat, do të përftonim Sonetin e ngjyrave të francezit Artur Rembo (Arthur Rimbaud).

Sidoqoftë vini re një tjetër krahasim, Ana Blandiana po nga Rumania.

*Sa do të doja
Të ishte gjithçka e përkryer.
Si një bimë.*

Jo shumë larg prej saj në Kosovë, poetja shqiptare Flora Brovina shkruan:

*Në heshtjen time je shpresë,
Bimë - për tokën e tharë.*

Konvencionalisht bima për poetët ballkanikë paraqet përkryerjen, ajo është model i harmonisë natyrore, shpresë e përtëritjes, simboli i mbijetesës. Në tekstin e Blandianës, idioma Sa do të doja/ të ishte gjithçka e përkryer, mbyllet me krahasimin, Si një bimë. Pra, me modelin e harmonisë natyrore, shpresën e përtëritjes, mbijetesën. Kurse në vargjet e Brovinës, pavarsisht zhvedosjes, vini re se si bima lidh shpresën për tokën e tharë. Përftimi, njeri e tokë njejtëzuar, bimë e shpresë po ashtu. Nëse e para, (Blandiana) e përfytyron, e dyta (Brovina) e ka dëshmuar.

Poezia e ka ndjekur qëmoti njeriun dhe është përsosur me 'të, duke ia motivuar edhe jetën. Pra ato kanë ecur dorë për dorë dhe gjithmonë janë prirur të kenë fat të përbashkët, pa-

varsisht mos përputhjeve kohore. Njësoj kanë provuar lavdinë dhe persekutimin duke dëshmuar një potencial univarsal me taban abstraksionist dhe tepër real.

Baza e letërsisë është folklori e po të vërejmë me kujdes nuk është e vështirë për të kuptuar qënësinë e fantastikes tek ajo. Sado që me kalimin e kohëve kemi përftesa të reja letrare, fryma e folkut është e ngjizur në 'të, sepse gjenetikisht ne jemi bimë. Me pjesën e padukshme të rrënjëve, (folkut) me pjesën e dukshme (trupi) dhe pjesën e pritshme (frutin).

Rasti më i përkryer në letërsinë bashkohore shqiptare është Dritëro Agolli. Shihni disa vargje prej tij për ta patur më qartë gjëndjen:

*Kjo këngë kalon në heshtje për njerëz të tjerë
Ashtu siç kalojnë akrepat e orës,
Po mua shpirtin ma josh përherë
Manushaqe e prillit në mes të dëborës.*

Jo vetëm përngjeshja me këngën popullore, por edhe metrikisht kadenca ka ritmin e vargut popullor. Po le ti kthehemi çështjes tonë marrëdhënies duale, poezi e krijues. Në këtë dualitet ajo (poezia) nuk e ka për gjë ndonjëherë dhe ta braktisë poetin. Sepse ajo është hyjnore, eterike. Pikërisht këtë tekë të sajën shfrytëzuan diktaturat. Ndërsa ajo e braktis për të ndjekur fatin e vet, lind ngërçi ku poeti kthehet në beft, ai përdhoset, vuan, vritet. Brënda kësaj teke ajo jeton hyjninë, në një abstraksion çudibërës të lirisë së saj absolute, kurse poeti mbetet rob i saj.

Shembujt nuk mungojnë ato u shpeshatuan në kohën e diktaturave duke u kthyer në makthe sociale prej alogjizmës së proletariatit në kohërat e çudisë kolektive. Ti Shën Mari dhe

prostitutë, do e cilësojë poeti Visar Zhiti, pikërisht sepse ajo të magjeps dhe të braktis.

Po nga ana tjetër ne theksuam më lart fatin e përbashkët e gati të pashmangshëm që domethënë se në një farë mënyre vjen edhe çasti kur rendi i takon asaj (poezisë). Lehtësia me të cilën ajo jepet për tu keqpërdorur, duke u kthyer në mjet të propagandës dhe eksperimentit, me një naivitet unik që i përket vetëm sojit të saj. Kjo është tragjike dhe sado si e tillë, është absolutisht e pashmangshme për faktin e masës së pamatë që ajo gëzon. Për rrjedhojë e shohim atë t'i prijë propagandës dhe patriotizmit, herë nën një diktature dhe herë nën një rilindje kombëtare.

Ne afërmendësh që nuk merremi me frot siç edhe thamë më sipër, masa e saj është kaq e madhe sa absolutisht mund ta konceptojmë me universin. Në çdo krahasim që mund të sjellim do vërejmë se prirjet duale poetike janë të mbarsura me një lloj atmosfere gazmente të një fytyre në përfytyrim.

Të shohim edhe një shembull. Është një vjershë e Xh. Ungaretit, (Giuseppe Ungaretti) me titull Ushtarët.

*Si në vjeshtë,
majave të pemëve,
si gjethet.*

Ky krahasim është gjithë poezia.

E tillë, e ankthshme është gjëndja e ushtarit në luftë. Si gjethja e pemës në vjeshtë. Bie sot, bie nesër.

Gjithnjë në funksion të gjëndjes poeti shqiptar Visar Zhiti shkruan:

Gruaja e të burgosurit

*është pemë
buzë humnerash.*

Vini re edhe një poet tjetër shqiptar, Xhevahir Spahiu:

*Në dorën time
një gjuhëzë lisi diçka pëshpërit.
Jeta
si fleta?
Si fleta do ti iki dhe unë
një ditë.*

Në të tri rastet njeriu jeton i varur nga ankthi. Një gjëndje e nderë, e cila të krijon një lloj vakumi shpirtëror. Gjëra të jetës që finesa poetike i thotë me një buzagaz konstatues e paralajmërues. Dhe vjen një ditë kur këto motive artistikisht të krahasueshëm nën një ritëm elokuent, përbëjnë strofa e paragrafë që plotësojnë njera-tjetrën. Ty të duket sikur po lexon një poezi me fillim të thellë dhe fund tmerrësisht të largët.

Këto paralele poetike mund t'i hasësh edhe në prozë.

Kësaj here poezia qëndron tek fabula, duke e ushqyer atë brenda një ritmi a kadence pa të cilin subjekti nuk mund të jetë argëtues. Një paralele mund ta bëjmë për dy shkrimtarët e mëdhenj të letërsisë botërore, Nagip Mafuz, (Nagip Mahfouz) me E bekuar qoftë mbrëmja jote dhe Gabriel Garsia Markes (Gabriel Garcia Marquez) me Dashuri në kohërat e kolerës. Në të dy versionet fabula është një dashuri e penguar në rini e cila kurorëzohet në një moshë të vonë si pleqëria.

Gjithsesi krahas këtyre konstatimeve e theksoj se recensionet apo komentet, portret reportazh nga jeta si një idomë e gjallë, esetë, apo vështrimet eseistike, janë thjesht përpjekje për të përcjellë krijimtarinë e miqve. Ata të botës së artit.

Apo idhujt e mi. Idhujt tanë.

Gjë të cilën në një apo tjetër mënyrë bën edhe Manifestimi Letrar Ditët e Naimit këtu në Tetovë.

Më kujtohet se kohë më parë njoha këtu një poete nga Martinika. Një vend i vogël në mes të Karaibeve. Si ajo edhe unë nuk kishim njohuri reciproke mbi kulturat tona. Jo më larg se dy vite më parë, rasti e solli të prek disa nga këto vende në detin e karaibeve. Edhe Martinikën. Po tashmë ky ishull, ky vend i vogël sa një kokërr gruri nuk qe më i panjohur për mua. Kjo fal poezisë. Fal këtij ndërkomunikimi të gjallë.

Por edhe për ato vende apo kultura që i njihnim. Përshembull nga Danimarka, India, Irlanda, dy Amerikat etj. Prapë emocioni i Ditëve të Naimit na i bën realë nga prekja e librave. Deri tek shtrëngimi i duarve. Duke dëgjuar në të njëjtën kohë fëshfërimën e gjuhëve nga ato të përditshmes, deri tek më të rrallat për veshin tonë.

Një transformin magjik që sidomos për ne ish të burgosurit e telave me gjemba, duket si një punë prej Zotit vetë.

Ndaj një falenderim i ndjerë i shkon këtij Institucioni, grupit promotor. Të gjithë këtyre frymëmve Naimjane këtu. Përpjekjes njëzetvjeçare për të mbajtur peshë vlerën e ndërkomunikimit poetik.

Kështu me radhë me shumë e shumë kultura të tjera.

Ky është misioni i këtij Manifestimi. Njohja e njëri-tjetrit.

Megjithatë ka vend për përmisime dhe ndoshta për disa sugjerime. Ndofta me dëshirën që ky Manifestim të kap edhe dyqindvjetorin. Pra e kam fjalën për të ardhmen.

Manifestimi kohët e fundit i ka hapur dritë jeshile botimeve. Kjo është një gjë e mirë në drejtim të zgjerimit dhe rritjes së ngrehinës së një Institucioni.

Pa u zgjatur do sugjeroja që në ndarjen e çmimeve të përvitshme. Ku çmimi më i madh pas mendjes sime është ky grumbilim, ky qarkullim, ky ndërkomunikim letrar. Kjo njohje reciproke kulturash me flutura metaforash. Të projektohej edhe prurja

nga zërat e rinj. Një botim suportues në drejtim të të rinjve. Një zë që kërkon mbështetje. Kjo jo për të bërë poetë. Jo për të shpikur. Por për t'i dhënë mundësinë prirjes poetike.

Sot bota e internetit krahas armatosjes së pafundme, po na tregon se larmia e zërave është po kaq e pafundme. Ka shumë e shumë të tillë që për një apo dy arsye i shmangen prirjes. Ose e lënë pas dore. Megjithatë aty gjen plot bukuri që janë një humbje e madhe për artin poetik. Ndofta nga mungesa e mundësisë. Ndofta nga temitja brenda zhguallit të ndrojes. Ndofta sepse ajo bima poetike kërkon pak diell mundësie. Që shpesh milituesit e fjalës ia nështrojnë faktit të hidhur që sot nuk ushqehesh dot me libra etj.

Le ta quajmë pra prurjen e vitin prej këtij Institucioni që tashmë ka shtruar trashenë e shinave në kombe dhe kultura botërore.

Ju faleminderit.

10 tetor 2016
Deerfield Beach
Florida

FESTIVALI NDËRKOMBËTAR I POEZISË “DITËT E NAIMIT”- SHEMBULL I NDËRKOMUNIKIMIT KULTUROR E LETRAR

Xhuzepe NAPOLITANO

Poezia është një gjuhë, e ndryshme nga ajo që ne përdorim për të komunikuar në jetën e përditshme, është shumë më e pasur, më e kompletuar, në plotni njerëzore; një gjuhë njëkohësisht e paramenduar me kujdes dhe thellësisht e pavyllnetshme, sepse ajo ngjizet brenda nesh, edhe në qoftë se nuk duam, por i përgjigjet rregullave specifike, prandaj është e aftë të lidh me njëra-tjetrën gjërat që shihen dhe ato që nuk shihen, të vendos marrëdhënie mes asaj që dimë dhe asaj që nuk e dimë. Por, Sokrati na përkujton se, të dish na shërben vetëm në momentet kur e dimë se, nuk dimë (dhe për këtë përkujton edhe Montale, për të cilin ndër të tjera “poezia është më shumë një mjet i njohjes sesa i përfaqësimit “; përmes gjuhës poetike, e cila ndërton brenda nesh një model komunikimi, provojmë të njohim më mirë vetveten dhe të njohim bashkëbiseduesin tonë, lexuesin ideal të poezisë sonë). Është thënë se, “Poezia e shpëton jetën”: me siguri jetën e shkrimtarit, por shpresojmë edhe të lexuesit. A mund të pajto-

hemi me këtë reflektim, duke thënë se, poezia është shpirti i botës? Do të ishte mirë, nëqoftëse, shpëtuesit e jetës të ishin të rinjtë, ata që pretendojnë në shkollë se iu intereson letërsia e në fakt mendjen e kanë gjetkë? Të dhënë vetëm pas asaj që flet për ta, dhe nuk duket se kuptojnë gjuhët e tjera, përveç mishmashit bajat të slloganeve të reklamave. Ata duhet të kuptojnë se, poezia është përherë një zë i ri, pasi secili mund t'a përvetësoj e t'a përdorë për kënaqësinë e tij; poezia ndihmon për të thyer siguritë e besimet, derisa të zbulojë vet krimbin e dyshimit, e te dyshimet duhet marrë një qëndrim (cogito, ergo sum ...), për të njohur dhe poseduar atë.

Kjo është arsyeja pse ju duhet të besoni se poezia ende është e dobishme, në këto kohë, kur qenia njerëzore është e rrethuar me imazhet e pafund në të cilat tretet ose rrezikon të shkatërrojë aftësinë për të kuptuar, për të pranuar, për të reflektuar, për të rishikuar, e përfundimisht për të menduar që të prodhojë kategoritë e gjykimit të pavarur.

Para së gjithash do të ishte mirë të besojmë se, njeriu nuk është vetëm ai i paraqitur nga televizioni, dhe ai ka aftësi për të dalluar të mirën nga e keqja, sidomos në marrëdhëniet njerëzore - të cilat janë në thelb marrëdhëniet e kulturës, të thella si shkëmbim human.

Një festival ndërkombëtar i poezisë, si festivali prej njëzet vjetësh "Ditët e Naimit", në Tetovë, ka pikërisht detyrën për të rritur shkëmbimet e të jap rezultate të reja në fushën e gjuhës, sidomos gjuhës poetike, në njohjen e përvoja të tjera, kulturave të tjera, duke na bërë të kuptojmë sa i nevojshëm është bashkëpunimi për njerëzimin të lidhur në respektimin e lirisë së fjalës dhe të shprehjes.

Njeriu është në fjalët që ai i njeh, por a ka ende nga ata që janë të gatshëm të mësojnë fjalë dhe të jetojnë për këto njohuri? Bota e sotme, për fat të keq, e mohon këtë.

Do të na duhej fanari legjendar i Diogjenit ... sot, me të

vërtetë nevojitet një kandil i ndezur për të ndriçuar humbjen e errët të kuptimit që shkatërron gjuhën e përbashkët dhe letërsinë, duke i hutuar ata që do të duhej të përfitojnë prej saj dhe të ndjehen të gjallëruar.

Homo sapiens është zëvendësuar tashmë nga homo videns: a ka ende kuptim letërsia, poezia?

Po, ne duhet të insistojnë të besojmë në të e t'a shkruajmë, ta përhapim, të shkëmbejmë frytet e punës sonë. Prandaj, të rinjtë në rend të parë, kanë për detyrë të rriten, duke edukuar veten e tyre përmes leximit, të njohin kulturat e tjera të ndryshme nga ajo e tyre. Në poezi do të ndeshin zëra të tjerë që mund të bëhen zëri i tyre - e të takosh shumë zëra së bashku e bën zërin e tyre gjithnjë e më të fortë, më të gjallë, më të fuqishëm, në një kor të shpresës dhe besimit.

IL FESTIVAL INTERNAZIONALE DI POESIA “DITËT E NAIMIT”: ESEMPIO DI INTERCONNESSIONE CULTURALE

Giuseppe NAPOLITANO

Possiamo semplicemente definire la poesia un linguaggio, diverso da quello che usiamo per comunicare nella vita quotidiana e molto più ricco, più completo, più compiutamente umano; un linguaggio che è al tempo stesso premeditato e involontario, poiché si forma dentro di noi anche se non vogliamo, ma risponde a regole precise, ed è pertanto capace di connettere fra loro le cose che si vedono e quelle che non si vedono, di mettere in relazione ciò che sappiamo con ciò che non sappiamo. Ma ci vorrebbe il filosofo Socrate a ricordare che sapere serve solo nel momento in cui si sa di non sapere (e di questo si è ricordato anche il nostro grande poeta Montale, per il quale inoltre “la poesia è più un mezzo di conoscenza che di rappresentazione”): attraverso il linguaggio poetico, che costruisce dentro di noi un modello di comunicazione, cerchiamo infatti di conoscere meglio noi stessi e conoscere il nostro interlocutore, il lettore ideale della nostra poesia.

“La poesia salva la vita”, è stato detto: certamente la vita di chi scrive, ma si spera anche quella di chi legge. Se condividi-

amo questa riflessione, e accettiamo al tempo stesso la definizione della poesia come linguaggio umano per eccellenza, allora possiamo dire che la poesia è l'anima del mondo. E non sarebbe bello se, imparando un linguaggio così particolare, fossero prima di tutto i ragazzi a salvarsi la vita? Quelli che a scuola fingono di interessarsi alla letteratura e pensano a ben altro (presi soltanto da quello che parla di loro), e non sembrano comprendere altri linguaggi se non il loro insulso provvisorio miscuglio di slogan pubblicitari. Dovrebbero invece comprendere subito che la poesia è una voce sempre giovane, proprio perché chiunque può farla propria e servirsene a suo piacere; la poesia aiuta a scomporre certezze e convinzioni, finché arriva a scoprire il tarlo del dubbio, e nel dubbio bisogna prendere posizione (Cogito, ergo sum), ci si riconosce e si riprende possesso di sé.

Ecco perché si deve credere, in questi tempi, che la poesia abbia ancora una utilità, per il genere umano insidiato dalle infinite immagini nelle quali si perde o si rischia di vanificare la capacità di percepire, di cogliere, riflettere, rielaborare, in definitiva di pensare, producendo categorie di giudizio autonome. Sarebbe quindi molto bello poter credere che l'uomo non sia soltanto quello auspicato dalla televisione nella società di massa, e abbia invece ancora integra la sua capacità di distinguere il buono da quel che buono non è, specialmente nei rapporti umani - che sono essenzialmente rapporti di cultura, intesa come scambio di umanità.

Un Festival internazionale di poesia, come da vent'anni fa a Tetovë il Festival "Ditët e Naimit", curato con amore e competenza da Shaip Emërllahu, ha proprio il compito di far crescere gli scambi e far nascere nuovi frutti nel campo del linguaggio, in particolare del linguaggio poetico, affinché la conoscenza di altre esperienze, di altre culture, faccia comprendere quanto sia necessario collaborare per l'affermarsi di una umanità che si

senta legata nel rispetto della libertà di parola e di espressione. L'uomo è nelle parole che conosce, ma c'è ancora chi è disposto a conoscere parole e vivere per questa conoscenza? Il mondo d'oggi purtroppo sembra negarlo.

La mia personale esperienza umana e letteraria ha trovato senza dubbio a Tetovë e nel Festival "Ditët e Naimit" un fertile terreno di lavoro: frequentare così a lungo un gruppo di poeti provenienti da tutto il mondo ha arricchito incredibilmente la mia formazione, ha stimolato la mia curiosità intellettuale, facendo crescere le mie conoscenze e permettendomi anche altre esperienze, altri viaggi, altre prove poetiche. La mia prima presenza al Festival risale al 2008 e già in quell'occasione ho scritto una raccolta di poesie ispirata al viaggio, alle persone incontrate, all'ambiente. Quella raccolta è poi diventata un libro, ha vinto un premio importante in Italia ed è stata tradotta in albanese da Elvana Zaimi e presentata a Tetovë nell'edizione 2009 del Festival "Ditët e Naimit". Quell'anno, ho scritto un altro libro: Tetovë 2009, pubblicato nelle edizioni "la stanza del poeta".

Avevo conosciuto Elvana Zaimi insieme a suo marito, il poeta Agron Tufa, a Lodève, in Francia, durante il Festival "Voix de la Méditerranée". La poesia di Agron Tufa mi aveva molto interessato e pubblicai un suo piccolo libro tradotto in italiano da Blerina Suta nella mia collana "la stanza del poeta", dove erano comparsi già poeti francesi, spagnoli e nordafricani. È come una catena, un anello lega un altro anello, e così diventiamo amici e cerchiamo nuovi amici. Infatti, a Tetovë ho conosciuto il poeta kosovaro Jeton Kelmendi, grazie al quale ho avuto un invito a Peja in Kosovo, dove ho scritto un altro piccolo libro: Falemin-derit Peje. Ma a Peje ho pure incontrato la poetessa Ilire Zajmi e Anton Berisha, poeta e professore di lingua albanese a Cosenza (in Italia), i quali poi hanno tradotto e pubblicato a Pristina il mio poema Dialogo alla luna. A Tetovë ho conosciuto anche il

poeta bosniaco Sabahudin Hadzialic che mi ha invitato a Sarajevo. A Sarajevo ho conosciuto il poeta estone Juri Talvet che mi ha tradotto alcune poesie nella sua lingua, e ho conosciuto il poeta albanese Bardyl Maliqi che mi ha invitato a Sarandë. A Sarandë ho visto l'ultima volta il poeta Ali Podrimja che poi è morto proprio a Lodève. A Sarandë ho conosciuto Agim Mato che ha da poco curato una Antologia di poeti pugliesi tradotta in albanese. La vita è una giostra. La poesia certamente rende questa giostra più bella e più ricca.

La mia collezione di piccoli libri "la stanza del poeta" ha ospitato decine di scrittori di tutta l'Europa. Lo scopo principale della mia operazione culturale era proprio quello di far circolare la poesia, di far conoscere ad un pubblico scelto e attento voci che altrimenti non sarebbero state conosciute, se non nel loro Paese, nella loro lingua di origine. Perciò ho tradotto dall'inglese Shaip Emërllahu, Sabahudin Hadzialic e Richard Berengarten (anche lui conosciuto a Tetovë), ho tradotto dallo spagnolo Gustavo Vega (conosciuto a Lodève e incontrato poi a Sarajevo), e dal francese ho tradotto Athanase Vantchev de Thracy (che ha vinto il Premio "Naim Frashëri" nell'edizione 2013 del Festival a Tetovë) e Daniel Leuwers (che ha ottenuto il Premio Menada nell'edizione del 2015). Nelle varie edizioni del Festival "Ditët e Naimit" alle quali ho partecipato ho incontrato molti altri poeti importanti: da tutti loro ho imparato qualcosa, a ciascuno di loro ho lasciato qualcosa. Per alcuni di loro è nata una vera amicizia, e il nome di Tetovë è anche il nome di questa amicizia.

Il fiore all'occhiello del Festival "Ditët e Naimit", e perciò Shaip Emërllahu lo cura con particolare attenzione, è il libro che raccoglie in lingua albanese tutte le poesie dei poeti che partecipano al Festival. Questo libro è il segno concreto della possibilità di integrazione che la poesia può favorire: decine di voci diverse diventano una sola voce in una lingua che le ac-

comuna. Sono convinto che tante voci poetiche messe a confronto possano dare un contributo davvero molto significativo all'integrazione culturale (e quindi anche umana, sociale) di cui oggi si avverte un estremo bisogno. Mi sono sempre ritenuto un erede della Grecia classica, di quella filosofia che è la madre di tutta la storia del Mediterraneo: essendo un figlio dell'Italia meridionale, avverto profondamente in me le radici di una cultura comune a tutti i popoli che sulle rive di quel mare hanno costruito per secoli e millenni un'armonia di rapporti umani, che in questi ultimi anni sta invece rischiando di essere corrotta e compromessa. Anche l'Europa è nata sul Mediterraneo, dove però si affacciano da sempre altre civiltà e bisogna tener conto di questo: lingue e costumi diversi non devono in ogni caso dividere i popoli, ma spingerli alla reciproca collaborazione. La prima volta che partecipai al Festival "Ditët e Naimit", nel 2008, rimasi colpito dalla cordiale simpatia che univa la poetessa israeliana Diti Ronen e il poeta palestinese Khaled Darwish.

Ci vorrebbe la mitica lanterna di Diogene... oggi davvero ci vorrebbe un faro per far luce nell'oscura perdita di senso che guasta il linguaggio comune e anche la letteratura, mettendo in confusione le menti di coloro che dovrebbero fruirne e sentirsene vivificati. E infine dovrebbero anche sentirsi spinti a collaborare. Forse la poesia non ferma le bombe intelligenti e non distoglie i fanatici dalla violenza. Ma può illuminare la mente di chi non vuole farsi mettere il guinzaglio o i paraocchi. L'homo sapiens è sostituito ormai dall'homo videns: ha ancora un senso la letteratura, la poesia? Sì, dobbiamo insistere a crederci e a scriverla, a diffonderla, a scambiarsi i frutti del nostro lavoro. Perciò i giovani, in primo luogo, hanno il compito di crescere educando loro stessi alla lettura, alla conoscenza di culture diverse dalla propria. Nella poesia incontrano altre voci che possono diventare la loro voce - e condividere tante voci insieme fa diventare la loro sempre più forte, viva, potente, in un coro di speranza e fiducia.

FESTIVALET INTERKOMUNIKIM ME VLERA NDËRKOMBËTARE

Remzi SALIHU

Festivalet poetike janë mozaikë grupesh e fjalësh kulturore të përzgjedhura dhe të rralla artistike, kryesisht, të skalitura e të ngjeshura me finesa kreative, atraktive nga njerëz të veçantë; nga ata njerëz që janë të përkushtuar me devotshmëri dhe që dinë t'i ndriçojnë gjërat rreth vetes realisht e figurativisht. Ata në mënyrë më tipike manovrojnë në këtë mikrokozmos misterioz kreativ, për të ndërtuar ura afrie, drejt perspektivave me vlera kombëtare e ndërkombëtare midis popujsh. Këtë prurje dhe mirëseardhje kulturore të zhdërvjelltë e të shenjtë, e shkëmbejnë midis vetes festivalet poetike, duke stërvitur e imponuar në gjirin e tyre artin e vet poetik kozmopolit. Këto festivale dalin në skenë me shkathtësi të veçantë, duke ngjeshur nuanca atraktive e mesazhesh në opinion nga rruzulli mendor kreativ. Këtë mesazh të mirëpritur e bartë në vete edhe Festivali Ndërkombëtar të Poezisë "Ditë e Naimit", i cili për nga forma shërbyese e hapur e komunikimit, në arenën poetike shumë vjeçare, tubon për çdo vit autorë të ndryshëm nga të gjitha vendet e botës. Dhe përmes këtyre takimeve të rëndësishme tradicionale, që ua mundëson ky eveniment, artistëve

të veçantë, të shpalojnë ndjenja rrezatimesh inteligjente, me rryma përçuese e mesazhesh reflektuese njerëzore, në kooperim të artit dhe kulturës së ndërsjellë me autorë botërorë.

Vendi ynë, tanimë, është përfshirë nëpër shumë manifestime e takime poetike mbresëlënëse. Ndaj kjo ndërmarrje e zgjuar dhe hapur e interesit të ndërsjellë kulturor, me ide dhe risi dobiprurëse për shoqërinë, brenda këtyre normave të caktuara shkëmbyese, si kërkesë atipike e kohës misterioze, me ndryshimeve të mëdha politike e shkencore, ngjizet në kureshtje atraktive nevoja afatgjate e shkëmbimeve profesionale për të shpalluar artin dhe kulturën e tyre interesante. Përvoja e zhdërvjelltë në artin e mirëfilltë dhe kyçja permanente e krijuesve në punëtorinë letrare të këtij asociacioni, na mundëson neve të gjithëve artdashësve të sistemojmë refleksione meditimesh e idesh shumë dimensionale, që nga lidhja formës individuale e qasjes e deri te ajo globalja artistike e standardizuar. Nga kjo mundësi e dhënë e përpjekjes kreative, na shfaqen neve në kujtesë përmasa kërkimi vlerësues, se festivali "Ditët e Naimit" me jetëgjatësinë e vet, prej subjekti jo qeveritar, është identifikuar mjaft mirë me ngjarje e manifestime të shumta, të cilat ngjarje dhe risi na trokasin për çdo vit në kujtesën tonë, se diçka po bëhet për kulturën dhe letërsinë e kësaj ane. Si ndërkomunikim veprues 20 vjeçar, "Ditët e Naimit" gjithnjë kanë ngjizur një transparencë informimi optimal në opinion, kryesisht vëmendja e kësaj strategjie kulturore është përqendruar në afrimin e vlerave të mirëfillta që ka bota. Me këtë ndërmarrje përkushtimi fisnik, të drejtë, të këtij asociacioni me nevojë kombëtare integruese, e që ka vepruar me strategji të vëmendshme, si një marrëdhënie shoqërore koozopolite e hapur dhe permanente në kohë dhe hapësirë, me pikësynim bashkëpunimi të drejtë dhe afirmativ, manifestimi ka luajtur një rol të rëndësishëm shoqëror, për informim dhe komunikim të ndërsjellë midis kulturave të shumta. Kështu, prania e këtij asociacioni është determinuar në atë

formë veprimi me pretendim afatgjatë dhe me rregulla të qatra e aspirimi shoqëror të dukshëm, për një dritare të hapur kulturore, që të shëmbëllej, me çdo kusht, në autoktoninë e vet organizative, të marrjes dhe dhënies së vlerave të shumta, duke vënë detyrimisht kriter përgjegjësie, në krye të mbarëvajtjes sistemore artistike formë dhe përmbajte civilizuese. Programi është koordinuar mirë, për të mbijetuar asociacioni, sadopak, si komunikim kulturor e adekuat nëpër vite. Me këtë veprim të përkushtuar, manifestimi i është nënshtruar rregullave disiplinore të sakrificës njerëzore për të përfaqësuar sa më shumë autorë në rrjedhat e kohës, dhe me këtë vendosmëri përgjegjësie disa vjeçare, ka vënë renditje të zbatueshme ligjore e profesionale. Gjithashtu, ka vënë edhe rregulla statusore të qëndrueshmërisë dhe të rrjedhës së komunikimit standardizues të shoqërisë sonë bashkëkohore. Ky kodim strategjik i vazhdimësisë së festivalit, ka funksionuar falë vizionit dhe vullnetit të mirë të drejtorit të festivalit, Shaip Emërllahut, si dhe të sponsorizuesve të kuptueshëm dhe të ndërgjegjshëm, të cilët kanë kontribuar në jetëgjatësinë e këtij asociacioni me vlera kombëtare e ndërkombëtare. Pa ndihmën dhe vullnetin e mirë të këtyre faktorëve eminent dhe njerëzve artdashës, Tetova, nuk do ta kishte këtë reputacion kulturor që ka sot, posaçërisht, në afirmimin dhe prestigjin madhështor ndërkombëtar. Është për t'u mbajtur mend ky koordinim adekuat, i sistemuar në funksion të lëndinës hapësinore letrare këtu te ne, gjegjësisht, me llojllojshmërinë racionale të autorëve që kanë marrë pjesë aktive në këtë manifestim 20 vjeçar, duke vënë në shërbim të popullatës një prodhim të dobishëm poetik dhe një proces të pa lodhshëm edukimi njerëzor, dhe në veçanti të reproduktimit të letërsisë si sistem vlerash të rëndësishme kulturore. Kështu nga kjo ndërmarrje kreative e sofistikuar, del në pah komunikimi letrar në mënyrë efektive, e që tani krijon formë e përvojë marrëdhëniesh kulturore e shoqërore, ku strukturohet filozofia

integruese brenda dallueshmërive të shumta kreative, gjegjësisht për të forcuar ekzistencën artistike e stimuluese të jetëgjatësisë së vet.

Metoda sistemore organizative që ka përdorur kjo Drejtori, ka mundësuar perspektivë të gjatë jetësore e shoqërore afirmative të shumanshme, që letërsia dhe në veçanti lirika, si mjet arti komunikues të bëhet metaforë e kapshme e afirmimit të përgjithshëm kulturor. Nga kjo përvojë e gjatë letrare marrëdhëniet e ndërsjella komunikatave na janë shndërruar në sistem ndikim funksional. Qëllimi dhe veprimi kulturor, posaçërisht në këtë rast letërsia, ka luajtur funksionin permanent për të treguar operativitetin e vet ndikues, si segment i rëndësishëm shoqëror, në vendin ku vepron dhe perfomon. Kështu në këtë udhëkryq shumë dimenzional të komunikimit të hapur letrar, mua më udhëheq një parantezë mendimi gjykues dhe nuk është diçka bombastike të them tani se, “Ditët e Naimit” janë ndeshur me vështirësi të mëdha, në këtë rrugëtim të ashpër 20 vjeçar, duke u përballur me shumë ndërkëmbëza e sabotimesh keqbërëse, që kryesisht e kanë e inskenuar individë apo sabotues të pa ndërgjegjshëm, nga njerëz të artit jo serioz dhe tendencioz, të frustruar gabimisht në mënyrë naive, që nuk e shohin veten të kyçur në rrjedhën kulturore të kohës dhe vendit. Ata, të cilët mendojnë se, vetëm puna e tyre është e vlefshme, që interesin personal e vënë para interesit shoqëror të përgjithshëm. Të gjithë ata që i bëjnë keq kulturës së një populli, i bëjnë keq edhe politikës, nga cila anë apo shigjetim që vijnë ato, si tendencë injorimi primitiv, me dije apo pa vetëdije, do të mbeten nga historia e vlerësimit të drejtë shoqëror, në periferinë e vlerave të mirëfillta artistike kombëtare.

Të bësh sot prurjen e një kriteri artistik të lartë, në rrethin tonë kreativ, do të thotë të jesh koherent dhe në koeficient me të arriturat dhe me kohën e favorshme të risive të shumta, posaçërisht të atyre risive gjuhësore, novatore në kapjen e

trendëve të reja që krijon bota e informuar e artit letrar. Pra, manifestimi ka bërë të pamundshmen të mundshme që në imazhin figurativ gjuhësor të qarkullojnë talente e talent të ndryshëm, të cilët kanë kultivuar forma arti dhe metoda motivuese të shumta. Kështu nëpër vite janë performuar stile zërash të afirmuar, sidomos me lirikat e tyre të arrira artistikisht. Dhe në festival nuk ka munguar as shkathtësia kreative eksperimentale e artit avangardist, si gjuhë dhe teknikë e veçantë figurative të të shprehurit artistik bashkëkohorë.

Në qasjen dhe shijen time “Ditët e Naimit” kanë zënë një vend të merituar gjatë këtyre viteve që i kam përcjellë me vëmendje ngjarjet, sepse ky manifestim serioz, me interes kombëtar, ka sjellë poetë të njohur nga të gjitha meridianët e botës, pa dallim ngjyre gjuhe e feje, dhe në këtë pretendim të madh të emancipimit artistik ndërkulturor, Festivali është më i veçantë, nga të gjitha evenimentet tjera poetike që dëshmojnë në trojet shqiptare. Ky Festival, ia ka përmbushur një zbrazëtim afirmative kombit dhe qytetit tonë. Pos plotësimit të shijes sime estetike kreative, në këto rrjedha letrare janë, vënë në skenë debate e qasjesh edhe shumë probleme teorike letrare që na shoqërojnë nga dita në ditë, dhe sidomos në këtë preokupim shkrimor, një hapësirë të mirë të qasjes, kanë marrë hise edhe shumë promovime librash dhe autorë, të cilët kanë të bëjnë me lirikën dhe me botën e ngarkuar letrare, kryesisht duke u angazhuar krijuesit e kohës sonë, të huaj dhe të vendit, gjithandej kuluareve dhe bisedave përzgjedhura për artin letrar, të kurdisur shkencërisht me efekt afirmimi të gjithanshëm shkencor.

Arti jonë, sidomos poezia për mes këtyre autorëve që marrin pjesë nëpër këtë eveniment dhe posaçërisht ata emra që kanë vendin e merituar në atdheun e tyre, bëjnë këmbim të ndërsjellë dijesh dhe urash afrie artistike të mirëpritur në opinion. Ky bashkëpunim i gjatë poetik e ndërgjuhësor, inkurajon

edhe më shumë gjeneratat e reja që vijnë pas nesh, kryesisht ata që e duan poezinë, për një standard e nivel kulture më të përsosur në letërsi. Kështu, në këtë drejtim të profesionalizmit të mundshëm këmbehen përvoja dhe zhdërvjelltësi kreative të kuptueshme, sidomos këtu ngjallet një interes i madh i njohjes së të huajës, me anë të përkthimeve të shumta që bëhen nga përkthyesit profesional, të cilët bëjnë të pamundshmen e tyre në bartjen e fjalës së rrallë, ose të them më mirë, në prurjen autoktone të shumë gjuhëve të botës në gjuhën tonë. Ne të gjithë duhet të jemi mirënjohëse e koshient Festivalit, sepse ai na afron në botën kreative të autorëve të ndryshëm, të cilët dallohen bindshëm me veçantitë e tyre artistike njëri prej tjetrit. Thënë shkurt bëhemi më të ditur dhe më të plotësuar me këtë shumësi motivesh, vargjesh e tekstesh, sidomos me ato performansa artistike të betonuara në arkitekturën kulturore të kësaj ane, e cila tanimë na detyron e na përcjellë neve me sakrificë nëpër këtë rrugë të ashpër të kreativitetit artistik të nevojshëm.

Emblematike mbetet për çdo vit në kujtesën tonë manifestimi, që brenda aktiviteteve të shumta që na dhuron, në gjirin e vet ka veçuar të arriturat e shumta të artit letrarë. Brenda këtij festivali janë vënë mekanizma adekuate shpërblyese në zhanrin e poezisë. Kështu janë shpërblyer shumë autor të vendit dhe botës. Për çdo vit, Festivali ka vënë në skenë çmime dhe laureat të njohur. Në mesin e tyre kanë shkëlqyer edhe emra autorësh me famë botërore. Për këto 20 vite ekzistence të Festivalit, numri i autorëve që kanë marrë çmime është bërë i madh, sa për ilustrim, po veçoj disa prej tyre që u laureuan në këtë Festival, siç janë; Ismail Kadare(Shqipëri, 2002), Desmond Egan (Irlandë, 2014), Manilo Argueta (Salvador, 2008), Abdelatif Labi (Maroko/Francë, 2009), Lionel Ray (Francë, 2009), Tua Forsstrom (Finlandë, 2012), Craig Czury, (SHBA), Ewa Lipska (Poloni), Sebastiano Grasso (Itali), Fatos Arapi (Shqipëri),

Ali Podrimja (Kosovë), Peter Poulsen (Danimarkë), Thomas Tidholm (Suedi), Lee Kuei-shien (Taivan, 2016), etj. Këta autorë të latuar meritueshëm, me shpërblime të vlefshme kombëtare e ndërkombëtare, kanë bartur dhe këmbyer me përkushtim në kujtesën e tyre të arriturat tona në art dhe kulturë. Kanë folur e përfolur, kanë shkruar e vargëzuar shkrime të shumta për veçantinë dhe nivelin tonë kulturor si popull mikpritës. Disa prej tyre kanë thënë edhe fjalë miradije për Festivalin. Janë të çmueshme fjalët e shkrimtarit tonë të madh, Ismail Kadare, për Festivalin: “Ky manifestim është dinjitoz që nderon kulturën shqiptare”. Ose fjalët e bukura të Erik Stinusit, i cili thotë se, ky festival ‘na ka familjarizuar pak më shumë me popullin (shqiptar) që na mirëpriti, me letërsinë e tyre, me këngët e tyre, kulturën dhe historinë e tyre”. Poeti Visar Zhiti, duke prononcuar veten në një rast ka thënë se, Festivali është një arritje e madhe për këtë pjesë të popullatës përvuajtur dhe nuk mbetet pa thënë edhe mendimin e tij të sinqertë se, “Ky manifestim me seriozitetin e tij të lartë rrënoi injorancën 50 vjeçare të komunizmit ndaj shqiptarëve”, pastaj autorja Maria Lenti nga Italia thotë: “ unë jam mrekulluar me atë që pashë në Tetovë”, poeti nga Maqedonia Hristo Petreski për seriozitetin e manifestimit thotë, se “ ju tanimë Mbrëmjet poetike Strugane i keni në Tetovë”, ndërkaq, poeti Agron Tufa përcjellë fjalë miradije se, “vet pjesëmarrja e poetëve nga të gjitha hapësirat shqiptare, dhe nga vende të ndryshme të botës, tejkalon të gjitha përpjekjet kulturore letrare shqiptare, duke i dhënë një dimension më të gjerë ndërkombëtarë. Ndërsa, solisti tashmë i ndjerë, Flamur Vela, i cili e çmoi shumë lartë Festivalin, dhe sidomos simetrinë e organizatorëve, pasi këtu në Tetovë erdhën dy figurat më të mëdha të kombit, shtatorja e poetit tonë kombëtar, Naim Frashërit dhe shkrimtari më i madh shqiptar, Ismail Kadare etj.

Para 20 vitesh u themelua ky asociacion vlefshëm kultu-

ror, dhe tamam kaq gjatë me përkushtim ka vepruar artistikisht ky eveniment i nevojshëm. Ky forum kulturor kreativ, nuk është themeluar rastësisht në Tetovë. Por ka historikun e vet ekzistues intelektual dhe artdashës, që i ka mbrojtur vlerat e përgjithshme kombëtare me fisnikëri e devotshmëri nëpër vite. Nga ky rrafsh humusor poetik kanë lindur mjaftë figura të njohura të opusit kreativ letrar e që kanë ushqyer me art të mrekullueshëm shoqërinë tonë. Numri i poetëve është i madh dhe një pjesë e tyre tanimë nuk janë midis nesh. Forca dhe ndikimi artistik i poetëve të kësaj ane ka shërbyer pozitivisht në konsolidimin e Festivalit.

Me kombinimet artistike të vlerave të qëndrueshme dhe me anë të teknikës kreative bashkëkohore kultura e kësaj ane mban forcën ndikuese për të gjitha gjeneratat që vijnë pas. Veprimet dhe niansat subtile që na shpalohen gjatë këtyre viteve të ekzistimit të festivalit, kryesisht me vargjet poetike të latuara me finesa stilistikore, dhe bashkë me shqisat sugjestive njerëzore të rralla dhe me atmosferën befasuese të krijimeve autoktone, të plotësuara me shije e gjallëri gjuhësore, para publikut artdashës dhe posaçërisht dalja artistike e kombinuar me shumësi motivesh të kapshme në skenë, kanë mbajtur gjallë atmosferën poetike të Festivalit. Prania e shumë poetëve ka kontribuar pozitivisht në imazhin dhe ngritjen e standardit të rrethit kulturor. Me praninë e poetëve në Festival, atmosfera dhe shtimungu kreativ ka marrë impulse befasuese të këndshme. Vet prania e veprave të shumta të dala në këtë kuadër sistemor, forcon tregun kulturor konkurrencës artistike. Prandaj funksionimi poetik adekuat në Festival, tanimë, mban formën e vet mjeshtërore, duke u zhvilluar artistikisht edhe më tepër nga viti në vit.

Tani duke u bazuar në këto fakte e merita konkrete të organizimit të suksesshëm, mund të themi lirshëm se gjithnjë në qendër të vëmendjes së këtij festivali tradicional, ka qenë emancipimi dhe kultivimi i njerëzve të kësaj ane me art e kul-

turë të mirëfilltë, për t'i dhënë diçka të mirë këtij populli liri-dashës dhe të urtë. Dhe shoqërisë sonë i është dashur një segment i tillë motivues e angazhues, pasi ky popull gjatë historisë së vet ka kaluar nëpër etapa të rënda dramatike të konfliktit, injorimit e kufizimit emancipues shoqëror. Por, në këto rrethana vështirësie edhe Festivali Ndërkombëtar i Poezisë "Ditët e Naimit" ka qenë shumë herë i përballur me këto erëra të forta intolerante e frenuese të rënda, të frymëmarrjes dhe zhvillimit jo të lirshëm njerëzor. Ai kaloi me vështirësi të acartë nëpër këtë rrugë të gjatë të shtegtimit kreativ, u përballë burrërisht nëpër shumë udhëkryqe e peripeci ekzistenciale, por gjallëroi e frekuentoi me sukses dhe pa përkulje në historinë disa vjeçare të pranisë së tij. Për fat të mirë të njerëzve artdashës dhe të vet drejtorit të Shaip Emërllahu, Festivali e ka vazhdimësinë e vet. Falë vullnetit pozitiv të individëve, Festivali u mbijetoi rrethanave penguese, duke ecur me ngulm dhe me bindje të vendosur drejt sukseseve afirmative, sidomos duke sfiduar veten nëpër situata poetike sureale të papritura. Vetëm konsekuenca e përqendruar në ideal dashamirësie ka mundur të ndikojë në kontinuitetin e rrjedhës së kohës që ta mbajë gjallë këtë eveniment kulturor ndërkombëtar.

Po them me përkushtim edhe këtë urtësi time modeste se poezia, në këtë rast të fërkimeve të mëdha politike e integruese, është mjeti më i përsosur shpirtëror që i afron midis vete njerëzit dhe dallueshmëritë e shumta kulturore. Secili nga pjesëmarrësit e Festivalit, sjell në arenë performancat e veta stilistike e eseistike, duke shpaluar bindshëm në imazhin e kohës art dhe stil të veçantë, të gdhendur me kujdes, nga punëtoritë dhe laboratorët e tyre kreativ, për të stimuluar dhe ndërtuar interesa elegante të shumta komunikimi e bashkëpunimi midis autorëve dhe popujve, kryesisht për t'i dhënë gjallëri dhe motivim energjik Festivalit. Ata poetë të pranishëm që vijnë me nuancat dhe brenditë shpirtërore, sensacionale e atraktive, për

të na afruar diçka të bukur, diçka të kapshme nga arti letrar tyre dhe kohës. Por, gjithsesi se, ky udhëtim kreativ i përkushtuar, bëhet te të gjithë të pranishmit fanar ndriçimi, ku ndërtohen e betonohen me fjalë të veçanta ura afrie individësh e popujsh, sidomos për t'u njohur më për së afërmi njëri me tjetrin dhe kryesisht për t'i këmbyer dallueshmëritë dhe diverzitetet e shumëllojshme artistike, që shfaqen e që zhvillon bota letrare sot në këtë rruzull të madh tokësor.

“Ditët e Naimit” në këto 20 vite shndritjeje kanë luajtur një rol të veçantë në këmbimin e vlerave të mirëfillta. Kjo godinë artistike, me të gjitha peripecitë e saja njëzet vjeçare, ka ftuar në gjirin e vet shumë autorë dhe studiues, të cilët kanë ndriçuar me veprat e tyre në artin poetik me vite të tëra. Manifestimi “Ditët e Naimit” nëpër vite ka qenë asociacioni shumë i rëndësishëm ndërkombëtar, prandaj gjatë këtyre viteve të kthesave demokratike ka ndikuar pozitivisht, t’i afirmoj gjërat, t’i çliroj komplekset e dallueshmërisë, duke na afruar vërtet vlera të mirëfillta. Shumë autorë vendas dhe të huaj janë laureuar me çmime të ndryshme. Në këtë rreth kulturor poetik kanë përfaqësuar veten e tyre edhe shumë zëra të njohur që ka lindur bota poetike e madhe, e globit. Për çdo vit Festivali ndërkombëtar poetik “Ditët e Naimit”, po e përsërisim mendimin se në sofrën e vet fton poetë nga gjitha meridianët e globit. Përveç vargjeve që na afron ky manifestim, zhvillon strategji me pasion komunikimi afirmativ mbi urën e gjatë të artit, nëpër të cilën tanimë, me vite të tëra, kalojnë lumenj idesh të shumta midis artistëve, që derdhin me seriozitet profesional performancat e tyre të akumuluar si art i latuar me mjeshtëri e filozofi komunikuese midis njerëzish kulturash të dallueshme. Në këtë festival të dalluar, gërshetohen shumëllojshmëritë para publikut tetovar dhe më gjërë, dhe sidomos mishërohen të gjitha artet dhe zhanret artistike, siç janë muzika, piktura, vallëzimi etj. Këtu takohen dhe ndërrohen mendime për të arriturat e shumta në

kulturë dhe art. Këmbehen mendime, duke sjellë shumësi estetike e teorike letrare, të cilat besoj bindshëm se tanimë kanë ndikim imanent në kultivimin e shoqërisë në të gjitha aspektet e jetës. Me këtë afri dhe investim madhështor kulturor që bën Festivali Ndërkombëtar i Poezisë "Ditët e Naimit", mund të themi se, akoma është duke na ngrohur një kohë e mirë për poezinë dhe artin në përgjithësi, gjegjësisht nuk mbetemi të zhgënjyer me të arritura e kohës. Me këtë festival, vendi ynë shëmbëllen shpirtërisht në të gjitha aspektet jetësore. Autorët e huaj në këtë rast kanë mundësi ta njohin kulturën dhe mikpritjen tonë dhe mandej ata nga mbresat dhe përshtypjet e akumuluar në vete, na shërbejnë neve si ambasador të qenies sonë nëpër vendet e tyre. Afria dhe mikpritja jonë u jep shkas motivi për të na veçuar e ndritur nëpër vendet e tyre si popull me traditë kulturore të lashtë.

Ka ndodhur gjatë këtyre viteve të funksionimit të këtij Festivali, të dëgjojmë fjalë të mira për popullin tonë si etni mikpritëse, me karakteristika të veçanta dhe të lashta që kemi kultivuar si popull. Disa prej poetëve pjesëmarrës nuk kanë mbetur pa e bërë kërkesën dhe dëshirën e tyre për tu kthyer sërish në gjirin e këtij festivali mikpritës. Ndonjëri prej tyre ka shkruar edhe vepra për Tetovën dhe njerëzit e saj, sidomos këtë veprime kanë bërë ata poet që kanë qenë mirëseardhur në këtë sofër poetike tetovare. Duket se, vargjet e tyre sot shëmbëllejnë, si ditar koherent të ngjarjeve dhe të ndryshimeve të shumta, për një dashuri të çiltër ndaj Festivalit dhe popullit tonë të veçantë, që di t'i afrojë njerëzit midis vetes, pa dallim etnie, religjioni e gjinie e ngjyre. Me qindra poetë gjatë këtyre njëzet vjetëve kanë marrë pjesë në këtë manifestim. Dhe artdashësit nëpër këtë rrugë të gjatë letrare kanë mundur të përjetojnë teknikën organizative kulturore të shoqërisë sonë. Në të shumtën e rasteve pos performancave dhe deklamimeve poetike, janë bërë edhe shumë aktivitete tjera të rëndësishme, kryesisht nëpër in-

stitucione e vende të rëndësishme historike për kulturën tonë. Tetova ka qenë përherë oda apo shtëpia e ngrohtë që ka tubuar autorë dhe stile kreative të llojllojshme. Këtë vit festivali mbush 20 vjetorin tij, bashkë me kondicionin entuziast, si kreativitet kulturor i veçantë, që kap një përmasë afirmimi madhështor gjithëshqiptar, si më i veçanti i kësaj etnike të shpërndarë nëpër shumë shtete. Ky është festivali ndërkombëtar më i madh i trojeve tona dhe duhet pranuar si i të tillë. Duke falënderuar edhe drejtorin e këtij institucioni kulturor jo qeveritar, zotëri Shaip Emërllahun, për sakrificën, durimin dhe investimin e pa përkulshëm energjik, nga rrethanat dhe atakët ekonomike, që i është imponuar Festivalit nëpër rrethana e vite të çuditshme, akoma qëndron i pa përkulur në muskujt e tij të fortë, për të vazhduar e gjallëruar, që “Ditët e Naimit” të kalojë pa luhatje e përkulje nëpër blanën e kërkimit të gjatë komunikativ, në kozmosin poetik ndërkombëtar. Janë shfaqur vështirësi të mëdha financiare, por duke falënderuar edhe sponsor të devotshëm, ka mundur ky operator kulturor e letrar të shkojë e gjallëroj me këmbë të shëndosha, e të kalojë matej pengesave dhe grilave frenuese, duke prezantuar para botës qytetërimin tonë, si popull i lashtë që ka vlera dhe veti njerëzore emancipuese.

FNP “Ditë e Naimit” po e them me përvojën time të sinqertë, se gjatë këtyre viteve të ekzistimit të vet, me standardin artistik të tij ka luajtur një rol akademik adekuat në afirmimin e kulturës shqiptare në këtë pjesë të Ballkanit. Festivali pos këmbimit të poezisë, ai ka afirmuar edhe dy Universitetet ekzistuese, me pjesëmarrjen dhe vizitën e poetëve në mesin e studentëve dhe profesorëve. Këtyre qendrave të dijes u ka afruar orë letrare dhe promovime vlerash të mirëfillta të autorëve që vijnë nga të gjitha viset e botës. Ky festival, po ashtu ka bërë punë të jashtëzakonshme në afirmimin e vlerave poetike nga të gjitha viset etnike shqiptare dhe ka luajtur rol të dyfishtë në integrimin e kulturës shqiptare në gjirin artistik botëror. Sikur ky

eveniment kulturor të ndërroj datën e manifestimit do të ishte edhe më i mirëpritur nga të pranishmit dhe artdashësit. Disa herë kam kërkuar nëpër biseda dhe kuluare, po kërkoj e propozoj edhe tani, që data e manifestimit të bëhej në datën e lindjes së Naim Frashërit dhe jo të vdekjes së poetit të madh. Sepse, rëndësi ka për mendimin tim lindja e këtij kolosi të madh dhe jo vdekja. Se po të mos kishte lindur ky atdhetar dhe poet i madh i Rilindjes kombëtare, nuk e di a do të ekzistonte edhe ky Festival. Ndaj, Pranvera është stina e lule, ngrohtësisë dhe gjelbërimit, besoj se kjo idilë stinore mund të ndikoj pozitivisht edhe më mirë për mysafirët që marrin pjesë në këtë festival. Ata në këtë kohë kanë mundësi më të mirë t'i shijojnë vlerat historike kulturore këtu te ne. Por kjo është e drejta e Drejtorisë së Festivalit dhe e bashkëpunëtorëve të tij që të vendosin për këtë ndërmarrje me interes kombëtar e shtetëror të përgjithshëm në të ardhmen.

Faleminderit për vëmendjen!

NAIM FRASHËRI, FANARI I KULTURËS SHQIPTARE

Ndue UKAJ

Krijimtarie letrare dhe poetike e Naim Frashëri pati një rol të rëndësishëm dhe frymëzues në kulturën shqiptare. Është e ditur se letërsia shqiptare, me tipare të veçanta dhe specifika ligjërimore e tematike, ka kaluar nëpër disa periudha, dhe secila nga to ka karakteristikat e veta, me disa autorë që e tipologjizojnë dhe karakterizojnë.

Në periudhën e humanizmit dhe e mesjetës së vonshme, kemi autorët përfaqësues, që janë Marin Barleti, Gjon Buzuku, Pjetër Budi e Pjetër Bogdani, ndërkaq letërsia e Rilindjes Kombëtare, ka një protagonist të rëndësishëm, Naim Frashërin, autori ky i cili erdhi në letërsinë shqipe, në një kohë kur ajo rrekej të trajtonte tema politike dhe komëbtare, duke rikthyer të kaluarën, simbolin e rezistencës, Gjergj Kastriotin, dhe sidomos duke kërkuar që shqiptarët të kultivonin kujtesën si domosdoshmëri kundruall pushtimit të kohës. Në këtë aspekt, mund të themi se Naim Frashëri qe njëri prej frymëzuesve të rëndësishëm të Rilindjes Kombëtare, dhe një misionar që predikoi mirësinë dhe dashurinë, në një formë origjinare. Ai, i edukuar në gjimnazin Zosimea në Janinë, mori bazat e formimit klasik

sipas sistemit perëndimor dhe pastaj jetoi në Stambolli, por asnjëherë s’u shkëputë nga toka shqiptare, nga bukuritë madhështore të fshatarëve dhe maleve të saj, nga lavdia dhe krenaria për të kaluarën, tema dhe motive këto që bëhen lajtmotive të krijimtarisë artistike, dhe të cilat i hasim në poezinë e tij në përkim me konceptet letrare romantike të kohës.

Naimi i edukuar kështu që një fanar shprese dhe një frymëzues i madh i lirisë. Ai këshillonte vazhdimisht shqiptarët se për ta dielli lind atje ka perëndon. Në fakt, kjo referencë do të bëhet udhërrëfyese, një paradigmë për një lëvizje të madhe politike, që kulmoi me çlirimin e shqiptarëve nga Perandoria Osmane, me 1912.

Naim Frashëri është autor i shumë veprave në shqip, turqisht, persisht dhe greqisht, të cilat dëshmojnë profilin e një shkrimtari të rëndësishëm, të edukuar dhe me ndikim.

Në të vërtetë, në mendimin kulturor dhe letrar shqiptar, ekziston një mendim se letërsia shqiptare, ishte shtylla themelore e formimit të kombit shqiptar, dhe pavarësia kombëtare e shqiptarëve është rezultat i shkrimtarëve, në të cilën fushë Naim Frashëri ka luajtur një rol të pazëvendësueshëm.

Në vitin 1886, ai botoi poemën “Bagëti e Bujqësi”, një poemë ku himnizoi bukuritë e Shqipërisë, me një ligjërim madhështor dhe të paparë deri atëherë. Naimi këtu u këndon bukuri natyrore të Shqipërisë, me një gjuhë pasionante dhe një figuracion poetik romantik, duke e madhëruar dhe idealizuar Shqipërinë, dhe duke ngjallë kështu ndjesitë nacionaliste të shqiptarët e kohës.

Ndërkaq libri tjetër me poezi, “Lulet e Verës” botohet në Bukuresht me 1890, dhe shquhet për poezi më të avancuara artistike, ku ndeshim frymën panteistike bektashiane, si filozofi shkrimi dhe botëkuptime, që ishte edhe mision i jetës së tij. Por libri tjetër me ndikim mbetet “Isotri e Skënderbeut”, e hartuar me 22 këngë, në vargje tetërrokësh të bashkuar në katër-

vargësh dhe me rimë të kryqëzuar. Ky libër botohet po ashtu në Bukuresht, me 1998. Për vlerën e kësaj vepre, dëfton edhe Zef Skoro, i cili shkroi se ky libër është më i lexuar mes shqiptarëve.

Është thënë shpeshherë se paralel me gjendjen kombëtare të shqiptarëve eci edhe letërsia, e cila identitetin artistik e ka konsoliduar relativisht vonë, ashtu sikur që edhe vetë fati i kombit shqiptar. Në këtë kontekst, dijetar i mirënjohur, profesori i letërsisë dhe shkrimtari Ernest Koliqi, në shkrimin “Tre poetët më të mëdhenj shqiptarë”, mbronte idenë se tre shkrimtarët, Jeronim de Rada (1814-1903), Naim Frashëri (1846-1900) dhe Gjergj Fishta (1871-1940) mund të konsiderohen me plot arsye ndërtuesit e Shqipërisë së sotme.” Koliqi këtu artikuloi një ide filozofike, përtej letrare e estetike, një dimension kulturor e identifikues të letërsisë shqiptare, e cila, në historinë shqiptare, ka pasur funksione të shumëfishta- funksione këto që nuk kanë qenë vetëm estetike. Kjo e përligj atributin, që studiues të ndryshëm ia vënë letërsisë, një model të funksionit, të cilin Northrop Frye e përkufizon si funksion që nuk ka qenë në rend të parë estetik.

Letërsia shqipe, në këtë aspekt, mbetet një rast tipik dhe një shembëllim i fuqishëm i letërsisë në funksione të shumëfishta- funksione etike, kombëtare, politike dhe kulturore e artistike, paralelisht. Në rrjedh të këtij mendimi, mund të përmendim autorët shqiptarë, që nga libri i parë shqip, “Meshari” (1555) i Gjon Buzukut, përgjatë shekujve të mëvonshëm, me autorët Pjetër Bogdanin, e me vonë Naim Frashërin, Fan Nolin, At Gjergj Fishtën, Faik Konicën, etj., të cilët shkruan një letërsi shumë-funksionale dhe me intenca jo parësore estetike.

Përderisa letërsitë e tjera të mëdha europiane kishin si qëllim parësor funksionin estetik të letërsisë dhe trajtonin tema të individit dhe shqetësimeve të tij, letërsia shqipe, u dashtë të trajtonte tema kolektive, sidomos ato politike, dhe kështu të vihet në shërbim kombëtar; pra të vihet në shërbim të një mi-

sion nacional: krijimit të vetëdijes për përkatësinë europaine të shqiptarëve dhe ruajtjes së identitetit komëbtar Rrjedhimisht, asaj iu deshtë të jetë një letërsi në shërbim të plotë ndaj kauzës kombëtare, në të cilin roli i Vëllezërve Frashëri ishte i madh, ndërkaq i Naimit, përcaktues.

Duhet theksuar se pjesa themelore e letërsia shqipe, u zhvilluar në rrethana robërie, me mungesë të përhershme të lirisë, që vinte nga faktorët e jashtëm apo të brendshëm. Pikërisht si rezultat i kësaj, shkrimtarët shqiptarë u bënë shpeshherë edhe etërit e kombit, prandaj edhe letërsia u shndërrua në një platformë kombëtare, me tema dominante, që sillshin rreth patriotizmit. Në këtë aspekt, veçohet lëvizja për mobilizimin e vetëdijes kombëtare, me një referencë te portreti i Gjergj Kastriotin-Skënderbeut, i cili u bë hero edhe i letërsisë shqipe dhe një paradigmë udhërrëfyese për konsolidimin e identitetit shqiptar. Në këtë aspekt, roli i Naimit qe i madh, me poemën e tij, në të cilën trajtohet figura heroit kombëtar si simbol i qëndresës kundër sundimit osman.

Shkrimtari dhe profesori i letërsisë, Arshi Pipa, shkruante se “arti asht kulturë e si i tillë rolin edukativ e ka me vehte.” Në fakt, kjo frazë, më shumë se çdo letërsi perëndimore, i shkon për shtati kulturës letrare shqiptare, ngase letërsia shqipe, përgjatë gjitha kohërave, ishte vënë në shërbim të edukimit, kulturës dhe sforcimit të etikës kombëtare.

Letërsia shqipe pati qëllim përtej letrar, një misioni që për synim kishte herë forcimin e kujtesës nacionale e herë nevojën për mobilizimin dhe mbijetesë. Në të vërtetë, këto tipare e dominojnë dhe determinojnë letërsinë shqipe të krijuar gjatë periudhës së njohur si Rilindje, me autorët e mëdhenj shqiptarë, Jeronim de Rada, Zef Skiroi, Naim Frashëri, Pashko Vasa, Andon Zako-Cajupi, dhe të pasuar nga modernistët shqiptarë, Fan S. Noli, At Gjergj Fishta, Mitrush Kuteli, Faik Konica, etj.

Pra, shkrimtari Naim Frashëri, autor disa përmbledhjeve me poezi, i një poeme historike për Skënderbeun, është edhe një ideator i krijimit të një feje të re në Shqipëri, që njihet si bektashizmin, si tendencë për të ofruar dallimet mes krishterimit dhe islamit. Ky besim, i cili i ka rrënjët edhe në Kuranin e Bibël, sipas pikëpamjeve të autorit mund t'i shërbente unitetit kombëtar. Shikuar nga ky aspekt, kontributi i Naimit në historinë shqiptare duhet kuptuar si i madh.

Ky shkrimtar i cili ka pasur një ndikim të madh në rrjedhat politike dhe kulturore ndër shqiptar, është influencuar përveç tjerash edhe nga tekstet dhe kultura biblike, e cila, në letërsinë e tij është e motivuar për të promovuar idetë dhe idealet e tij. Diskursit biblik, si model krijimi e hasim te Naim, edhe pse ai ishte i rritur në një shoqëri me dominancë orientale, por shkruante se dielli i shqiptarëve lind në Perëndim, ashtu siç mendonin gjithë rilindësit e tjerë, prandaj letërsia e tij, me gjithë ndikimin e letërsive orientale, e ruan një ndërlidhje intertekstuale dhe interkulturore me shkrimin biblik, me këtë kulturë letrare, e cila atëbotë kishte bërë bujë te shqiptarët, duke u shtrësuar si model i veçantë i ligjërimit letrar dhe filozofi estetike. Naimi synoi ta ndërtojë kështu misionin nacional dhe mesazhet e qarta për një shkrim kombëtar, përbrenda shkrimit perëndimor, ku ai e shihte letërsinë dhe kulturën shqiptare. Madje, Naimi, në këtë segment i shkruan vjershë për Jezu Krishtin, një vjershë himnizuese. Kjo figurë, sipas Sabri Hamitit, e kënduar në këtë mënyrë hyn në sistemin naimian të mirësisë, dashurisë e të flijimit, elemente këto, të cilat janë postulate fundamentale të kulturës dhe filozofisë biblike. Naim Frashëri në poezinë "Përpara Krishtit", në formë të himnit, rikonfirmon edhe një herë praninë e diskursit biblik si një model shkrimi, nëpërmes diskursit eksplisit biblik, madje duke krijuar këtë figurë letrare, me epitet e larta, si dhe duke theksuar mirësinë, bukurinë, mëshirën, faljen, sikundër del në vargjet e mëposhtme:

“Djalth njeri i Perëndisë / Fytyra jote mua më tregon / Ah !Të
kqijat e njerzisë / Që ka punuar dhe punon, Se kjo fytyrë / Është
pasqyrë / Dhe na rrëfen / E s’na gënjen”

Kjo poezi, është e krijuar nga ideja dhe figuracioni i drejt-
përdrejtë biblik, mirëpo në letërsinë e tij, hasim edhe poezi
tjera ku ndeshet fryma religjioz edhe misioni i mirësisë kris-
tiane, filozofi kjo të cilën ai e promovonte ndër shqiptarë, në
funksion të harmonizimit të dallimeve dhe ideve për të ardh-
men.

Për fund, mund të themi se shkrimtarët si Naim i bëjnë nder
kulturës shqiptare. Ndaj, ai duhet lexuar dhe studiuar edhe më
tej, që të mësojnë nga këshillat e mëdha të tij:

Në mes tuaj kam qendruar

E jam duke përvëlur

Që t`u jap pakëz dritë,

Natën t`ua bëj ditë. (Naim Frashër.)

Ky është testament poetik, një klithmë dashurie për sh-
qiptarët, të cilën Naimi e përjetësoi me vargje të bukura dhe
shpirt të etur për ta parë Shqipërinë të lulëzuar. Sot, ne duhet
ta shpalojmë edhe më tutje autorin, duke e lexuar dhe njohur
sa më shumë, sepse, siç shkruante Eqrem Çabej “Poeti e ndjen
veten të dërguar që me anë të fjalës së tij të zgjojë kombin nga
gjumi i gjatë i shekujve. Rendësia e tij qendron kryesisht këtu,
që ai në kohë të sundimit të huaj ndezi pishtarin e lirisë, që e
hodhi këtë në literaturë dhe e mbajti ndezur ne dorë. Ai për-
mbushi detyrën që i pat caktuar vetes... ai i derdhi të gjitha fuqitë
e tij mendore e fizike dhe në këtë punë shkriu veten në kupti-
min e vërtetë të fjalës. Qiriri që ai këndon në një nga vjershat e
tij, i cili digjet vetë për t`u ndritur të tjerëve, është një simbol i
poetit vetë dhe i veprës së tij.. ”

NAIM FRASHËRI, THE LIGHT OF ALBANIAN CULTURE

Ndue UKAJ

Naim Frasheri's literary and poetic creations had an important and inspirational role in Albanian culture. It is well known that Albanian literature, with its specific features of theological and thematic specifications, has gone through several periods, each of which has its own characteristics, with some authors who typologies' and characterize it.

In the humanism and late medieval epoch, we have the literature representatives such as; Marin Barleti, Gjon Buzuku, Pjetër Budi and Pjetër Bogdani, while the literature of the national renaissance has an important protagonist, Naim Frashëri. The author came to Albanian literature, at a time when it tried to tackle political and national issues, restoring the past, the symbol of resistance, Gjergj Kastrioti, and especially demanding that Albanians cultivate memory as a necessity against the invasion of time. In this aspect, we can say that Naim Frasheri was one of the most important inspirers of the national renaissance, and a missionary who preached goodness and love in an original form. He was educated at the Zosimea high school in Ioannina, received the basics of classical formation under the Western system and then lived in Istanbul. But he never disas-

sociated from the Albanian land, the magnificent beauties of its peasants and mountains, of its glory and pride of the past, themes and motifs that become the ultimate in artistic creativity, and which we encounter in his poetry in conjunction with the romantic literary concepts of the time.

With its education, Naim was a haven of hope and a great inspiration for freedom. He constantly advised the Albanians, that, for them the sun raises in the West. In fact, this reference will become a guide, a paradigm for a major political movement that culminated in the liberation of Albanians from the Ottoman Empire in 1912.

Naim Frashëri is the author of many literary works in Albanian, Turkish, Persian and Greek language, which testify the profile of an important, educated and influential writer.

Indeed, in the Albanian cultural and literary opinion, there is an opinion that Albanian literature was the fundamental pillar of formation of the Albanian nation, and the national independence of Albanians is the result of the writers, in which Naim Frashëri has played an irreplaceable role.

In 1886, he published the poem “Herds and Pastures”, a poem where he hymned the beauties of Albania with an impressive and unprecedented discourse until then. Naim sings here the natural beauties of Albania, with a passionate language and a romantic poetry figuration, magnifying and idealizing Albania, and thus generating nationalist feelings to the Albanians of the time.

Meanwhile, another poetry book, “The flowers of spring”, was published in Bucharest in 1890, and is famous for the most advanced art poetry, where we encounter the Bektashi pantheistic spirit, philosophy of writing and worldview, which was also the mission of his life. But the next influential book remains the “History of Scanderbeg”, compiled with 22 songs, in four-stringed, cross-linked strings. This book was also published in

Bucharest in 1898. For the value of this work, Zef Skoroi wrote that this book is most read among Albanians.

It is often said that in parallel with the national situation of Albanians, literature has also developed, whose artistic identity has consolidated relatively late, as well as the very fate of the Albanian nation. In this context, the well-known scholar, literary professor and writer Ernest Koliqi, in the article "The three greatest Albanian poets", advocated that the three writers, Jeronim de Rada (1814-1903), Naim Frasheri (1846-1900) and Gjergj Fishta (1871-1940) can be reasonably considered as the builders of today's Albania. "Koliqi articulated here a philosophical idea, beyond literary and aesthetic, a cultural dimension and identifier of Albanian literature, which, in Albanian history had multiple functions - these functions were not just aesthetic. This justifies the attribute that various scholars put to literature, a function model that Northrop Frye describes as a feature that has not been in the first aesthetic order.

Albanian literature, at this regard, remains a typical case and a powerful image of literature in multiple functions - ethical, national, political, cultural and artistic functions, in parallel. In the course of this thought, we can mention the Albanian authors, from the first Albanian book, "Meshari" (1555) by Gjon Buzuku, through the centuries, with the authors Pjeter Bogdani, and later Naim Frashëri, Fan Noli, Gjergj Fishta, Faik Konica, etc., who wrote a multifaceted literature and with no aesthetic intentions.

While other major European literature was primarily aimed at the aesthetic function of literature and dealing with topics of the individual and its concerns, Albanian literature had to deal with collective, especially political, issues and thus be put to national service; To serve a national mission: to raise awareness of the European affiliation of the Albanians and to preserve the common identity. Consequently, it needed to be a full-service

literature on the national cause, in which the Frashëri Brothers role was great, while Naim's was determinant.

It should be noted that the fundamental part of Albanian literature was developed in the conditions of captivity, with a permanent lack of freedom, coming from external or internal factors. As a result, Albanian writers often became the nation's fathers, and so literature became a national platform with dominant themes about patriotism. In this consideration, the movement for the mobilization of national awareness was highlighted, with a reference to the iconography of Gjergj Kastrioti-Skanderbeg, who became the hero of Albanian literature and a guiding paradigm for the consolidation of Albanian identity. In this aspect, Naim's role was great, with his poem, in which the figure of the national hero is treated as a symbol of resistance against Ottoman rule.

The writer and professor of literature, Arshi Pipa, wrote that "art is culture and as such the educational role is with itself." In fact, this phrase, more than any Western literature, goes to the Albanian literary culture, because Albanian literature, throughout all time, was put to the service of education, culture and the strengthening of national ethics.

Albanian literature had an over-literary purpose, a mission aimed at strengthening national memory and the need for mobilization and survival. Indeed, these features dominate and determine the Albanian literature created during the period known as the Renaissance, with the great Albanian authors; Jeronim de Rada, Zef Skiroi, Naim Frasheri, Pashko Vasa, Andon Zako-Cajupi and followed by Albanians modernists; Fan S. Noli, Father Gjergj Fishta, Mitrush Kuteli, Faik Konica, etc.

So the writer Naim Frasheri, author of some poetry collections, of a historical poem for Skanderbeg, had also an idea of creating a new religion in Albania, known as Bektashism, as a tendency to offer the differences between Christianity and

Islam. This belief, rooted in the Quran and the Bible, could, according to the author's views, serve national unity. Viewed from this aspect, Naim's contribution to Albanian history must be understood as great.

This writer who has had a great influence on Albanian political and cultural flows has been influenced, among other things, by Bible texts and culture, which in his literature is motivated to promote his ideas and ideals. Biblical discourse as a model of creation we encounter to Naim, though he was grown up in a society of oriental dominance, but wrote that the sun for Albanians is born in the West, as all the other Renaissance men felt. His literature, with all the influence of Oriental literature maintains an inter-textual and intercultural connection with the Bible scripture, with this literary culture, which at that time had made the headlines to Albanians, striking as a special model of literary discourse and aesthetic philosophy. Naim aimed to build a national mission and clear messages about a national writing, within Western script, where he saw Albanian literature and culture. Even Naim in this segment writes poems about Jesus Christ, a hymnal poem. This figure, according to Sabri Hamiti, singing in this way enters the martial system of kindness, love and sacrifice; these elements, which are the fundamental postulates of Bible culture and philosophy. At Naim Frasherí's poem "Before Christ", in the form of a hymn reconfirms once again the presence of biblical discourse as a scripture model, through explicit Bible discourse, even by creating this literary figure with high epithets and emphasizing goodness, beauty, mercy, forgiveness, as it follows in the following verses: "God's human son / Your face tells me / Ah! The evil of mankind/ Who has worked and works, That this face / Is a mirror / And he confesses / And do not lie"

This poetry is created by the direct biblical idea and image, but in his literature, we encounter other poems in which the

religious spirit faces, and the mission of Christian goodness, a philosophy which he promoted among the Albanians, in order to harmonize the differences and ideas for the future.

Finally, we can say that writers like Naim honor the Albanian culture. Hence, he should read and study further, to learn from his great advice:

Here among you have I risen,
And aflame am I now blazing,
Just a bit of light to give you,
That I change your night to daytime, (Naim Frashëri)

This is a poetic testament, a cry of love to Albanians, which Naim perpetuated with beautiful strings and soul eager to see thriving Albania. Today, we must further expose the author, reading it and recognizing it as much as, as Eqrem Çabej wrote, "The poet feels himself as a messenger who through his word awakens the nation from the long sleep of centuries. His dominance lies mainly here, that he at the time of the foreign rule sparked the torch of freedom, which he threw it into the literature and held it in his hand. He fulfilled the task assigned to himself ... he poured out all his mental and physical powers and melted himself in the true meaning of the word, in his work. The candle he sings in one of his poems, which burns itself to shine on others, is a symbol of the poet himself and his work.

Translated from Albanian by Edita Kuçi-Ukaj

METAFIZIKA E VERBËRISË NË LETËRSI. NIELS HAV DHE TEK- STI POETIK PALIMSEST.

Alisa VELAJ

Alegoria e verbërisë është nga procedimet letrare më të parapëlqyera për poetët dhe shkrimtarët e të gjithë kohërave. Kështu, në këngën VIII të “Odiseas” së Homerit rrëfëhet se si, me anë të dredhisë, heroi arrin të verbojë syrin e ciklopit Polifem. Në vargjet 480-481, Odiseu indentifikohet me emrin Askush (Askushi m’thonë. Askush m’thërrasin t’gjithë,/nëna, babai, e miq, e dashmirë”). Pas verbimit, mes tij dhe ciklopëve të tjerë që i vijnë për ndihmë zhvillohet ky dialog në vargjet 533-537: “Më vrau, more burra, ah Askushi/ tradhëtisht, jo me forcë!” Ata gjegjeshin/ “Mbasi askush s’të ngaka dhe je vetëm,/ duket se e ke të keqen nga vetë Zeusi/ Pra, sillju e lutju atit Poseidon”.

Akti i dredhisë merr në këtë rast konotocion pozitiv, pasi është mundur e keqja. Syri i verbuar shndërrohet në simbol jete për heroin, duke i siguruar atij ekzistencën, dhe në simbol vdekje për atë që është burim i së keqes. Para verbimit fizik, Ciklopit i ka ndodhur më parë verbimi mendor, kur ka besuar verbërisht se Odiseu është Askushi. Pra, më shumë se Odiseu, Ciklopin e ka verbuar besimi i tij i verbër tek identiteti i remë

i kundërshtarit. Është ky besim i verbër që e shndërron atë në një të verbër të vetmuar. Thënë ndryshe, e dënon më një vetmi të dyfishtë. Braktisja e miqve e shndërron atë në një askush; mungesa e besimit të miqve e kthen Ciklopin një hero tragjik për vetveten. Prej një gjithëkushi e kthen në një Askush. Ai është tani i mohuar jo vetëm prej dritës, por edhe prej racës së vet. Mallkimi i parë është pesim që i vjen nga të qënit makabër me racën njerëzore; i dyti, se i ka besuar verbërisht dikujt nga kjo racë.

Në verbimin mitik shuhet e keqja, por mund të ndodhë që përmes aktit të verbimit të mundet e mira, në rastin kur e keqja vesh petkun e së mirës dhe heroji, po për shkak të pakthjelltësisë humbet; paçka se në këtë rast vlerat janë të përkundërta, shkaqet e verbimit mbeten të njëjta. Alegorinë e dytë do ta rimerrete disa shekuj më vonë përralltari danez Anderseni, përmes tregimit-përrallë “Hija”. Gjithë sekreti alegorik i tekstit qëndron në dy pika kyçe të tregimit:

Së pari, kur dijetari i dëshpëruari i rrëfen Hijes se: “Shkruaj për të vërtetën, të bukurën dhe të mirën, po asnjëri nuk ma var. Jam i dëshpëruar për këtë”. Drama zë fill pikërisht me lodhjen e dijetarit në rrugën e së vërtetës dhe pranimit që ai i bën ftesës për udhëtimin e propozuar nga Hija. E vërteta nis kështu alegorikisht të mundet nga mashtrimi.

Së dyti, në njohjen e Hijes me princeshën, e cila në çastet e njohjes me mbretin a ardhshëm vuante nga sëmundja e të parit qartë, tej masës. Më pas princesha do të verbohet nga dashuria dhe e vërteta e rreme. Drama që qëndron pas këtij verbimi është dramë shumëpërmasore. Hija (Mashtruesi) do të udhëheqë popullin dhe e vërteta do të jetë larg turmës së verbuar; simbolikisht e shprehur me vrasjen e dijetarit.

Shohim se njësoj si në rrëfimin mitik, ku e vërteta fshihet, mungesa e kthjelltësisë për ta dalluar jo të vërtetën apo mashtrimin e çon heroin drejt vdekjes. Pavarësisht faktit se heroji mi-

tik e meritonte humbjen, ndërsa dijetari i Andërsenit kurrsesi, mesazhi nbetet i njëjtë; verbohemi ngase besojmë plotësisht, verbohemi ngase jemi të pakthjellët, verbohemi ngase dimë të shohim, por jo të vështrojmë në thellësi të fenomeneve. Ciklopi arrin të kuptojë të vërtetën vetëm pasi është verbuar. Arrin të shohë në verbëri. Si verbimi mitik, si verbimi që na vjen tek tregimi i përralltarit danez, arrin të na drejtojë në mënyrë të përkryer drejt çorientimeve që pëson njeriu modern. Me sa duket, ne vdekatarrët jemi të njëjtë përmes kohëve të ndryshme, ose nocioni kohë e ndryshme është gjithashtu një paqartësi e jona, pasi është shfaqja e ndryshme e thelbit tonë përgjatë kohërave që na krijojnë iluzionin se kohët e qënies njerëzore janë të ndryshme nga njëra-tjetra.

Poeti danez Niels Hav duket se na shpie pikërisht drejt këtij përfundimi, ndërsa pranë në alegorinë e tij të verbërisë bashkëkohësinë, të kaluarën, dijetarin, të verbërin e vërtetë dhe qënien që pashmangshmërisht bëhet e verbër duke ditur të shohë, por jo të vështrojë. Ajo që Hav sjell të re në topikët e tij të verbërisë është këndvështrimi në të cilin trajtohet figura e gjenit. Gjeniu apo dijetari i Havit nuk mashtrohet pasi ai preferon më mirë të shkojë drejt vetes, sesa drejt fenomenit apo drejt tjetrit. Hav risjell në formë poetike, atë ç'ka filozofi Sorren Kierkegaard e predikonte si një udhëtim drejt unit vetjak, ngase duke shkuar drejt vetes gjeniu zbulon lirinë. Poezia "On His Blindness" ("mbi verbërinë e tij") i kushtohet poetit argjentinas Jorge Luis Borges. Ndërkohë që vetë Borges do të shkruante një poezi me të njëjtin titull si kushtim ndaj Xhon Miltonit. Ky i fundit ka shkruar gjithashtu një poezi me titullin "On His Blindness" (ndoshta kushtuar vetes), e cila përmbillet me vargun emblematic: "Zotit) njësoj i shërbejnë edhe ata që veç rrinë e presin" ("They also serve who only stand and wait"). Durimi gjykohet kështu si shenjë besimi në Zot. Po t'u referohemi Shkrimeve të Shenjta lexojmë vargje referuar durimit të

Zotit ndaj nesh, si edhe durimit tonë ndaj planeve të Zotit për jetën e gjithsecilit prej nesh.

“Dhe kini parasysh se durimi i Zotit tonë është në shërbim të shpëtimit, sikurse ju ka shkruar edhe vëllai ynë i dashur Pal, sipas daturisë që iu dha;” (2 Pjetrit 3:15)

“Tani, pra, vëllezër, jini të durueshëm deri në ardhjen e Zotit; shikoni si e pret me durim bujku frytin e lëmuar të tokës, deri sa të marrë shiun e parë dhe të fundit”. (Jakobi 5:7)

Pra, durimi i Zotit është në shërbim të shpëtimit dhe ne si qenie udhëtare, po qe se dëshirojmë t’i shijojmë frytet e Zotit në jetët tona, si edhe të meritojmë shpëtimin, duhet të jemi të duruar. Hav frymëzohet nga ky lloj durimi biblik i John Miltonit në poezinë kushtuar Jorge Luis Borges, si edhe në poezi të tjera si: Përndritje”, “Kur bëhem i verbër”, “Blofi i të verbërit” dhe “Instituti për të verbërit” Po le të mbetemi tek poezia “Kur bëhem i verbër” (When I Go Blind”). Hav u referohet njëkohshëm me nderim Borgesit dhe Miltonit nëpërmjet vargjeve: “Vetëm pasi u verbua/ai arriti të kishte kontakte me sy me Xhon Miltonin/në Parajsën e Humbur të tij”. Për poetin danez, dashuritë tokësore nuk janë asnjëherë aq të denja sa të verbohesh për shkak të tyre. Verbimi për një qenie tjetër tokësore është ai lloj verbimi që të lë tuhaf, duke të larguar nga thelbi i ekzistencës së vërtetë. Në mënyrë ironike ai i referohet figurës së okulistit. A nuk ishin okulistët që ishin krejt të pazotë për t’i kthyer Borgesit dritën e syve, ndërkohë që ai arriti të shihte me kthjelltësi të plotë, edhe pse i verbuar fizikisht? A nuk është po okulisti që mbyll klinikën e tij në poezinë “When I Go Blind”.

“Borgesit u bë i verbër...i verbër siç u bë Bethoveni i shurdhër./[...] Vetëm kështu ai do të shikonte njëlloj/si Homeri, vetëm kështu ai do të ishte në gjendje/të shihte thellë në errësirë, në botën e gjerë/dhe në çastin marramendës që është përjetësia’

Hav, njëjtë sikur Miltoni, simbolizon me anë të errësirës

botën tonë dhe verbimin tokësor (alegorikisht) e quan krejt të kotë, përpara vështrimit në çastin marramendës që është përjetësia. Të fitosh dritën hyjnore, ky është misioni i vërtetë i udhëtimit tonë tokësor. Të dish të rendësh drejt dritës hyjnore, e vetmja që na bën të shohim edhe kur jemi të verbër fizikisht, siç panë në errësirën e thellë Borges, Miltoni dhe Homeri. Pra, verbëria fizike e poetëve të sapopërmendur vjen si alegori për dritën e vërtetë hyjnore. Drita hyjnore të bën të shohësh edhe në shkallën më supreme të verbërisë fizike, mentale apo në çastet më të skajshme të pakthjelltësisë. Ja, pikërisht atje, në errësirën e thellë, keta tre gjeni (që përfaqësojnë edhe tri periudha historike, antikitetin, rilindjen dhe bashkëkohësinë), arritën të shohin të vërtetat supreme. Arritën të shkonin drejt vetes dhe të zbulonin lirinë. Hav kur shkruan për çastin marramendës duket se nënkupton po këtë lloj çasti për të cilin shkruan Kierkegaardi . Ai lloj çasti kur brenda qenies futet shpirti. Homeri, Miltoni dhe Borges kanë arritur të shohin në errësirën e thellë falë pranisë së shpirtit në qeniet e tyre. Kur tek ta është vendosur shpirti, ka qenë i pranishëm edhe çasti kur poetët kanë mundur të vështrojnë në errësirën e thellë botën tonë tokësore. Duke parë aty të vërtetat supreme dhe duke zbuluar hapësirat e vërteta të Lirisë.

Sipas Niels Hav, detyra e parë e poezisë është të jetë një bisedë intime me çdo lexues rreth mistereve më të thella të ekzistencës. . Hav rreket të shpjegojë misteret më të thella në një dialogi mjaft intim me lexuesin e tij model. Një nga misteret që ai përpiqet të zbulojë është edhe metafizika e vërtetë e verbërisë. Në poezinë “Përndritje” (“Illumination”) poeti rimerr figurën e poetit. Qyteti shfaqet i vezulluar para syve të tij, por ai nuk është në gjendje t’u gëzohet pishtarëve dhe përndritjes për shkak të dhimbjeve të tij fizike. Dhimbja e dhëmbit , si një ndër dhimbjet më sflitëse, lind me dhjetra pyetje për natyrën e pikëllimës së qenies poet dhe shkaqet e kësaj pikëllime. A

parasheh poeti-profet një botë tjetër, më pak të përndritur, pas një vezullimi dhe hareje të përkohshme? Në këtë kontekst lumturia e qytetit është për të një gjendje negative, pasi i përkujton flakën e një vezullimi kalimtar, me njerëz të verbuar nga lumturia e një çasti. Pa qenë në gjendje të kuptojnë apo bëjnë një katharsis për iluminimin e shpirtave të tyre, në mënyrë që gëzimi dhe përndritja të zgjasë në pafundësi dhe jo për aq çaste sa të digjen pishtarët. Poeti vuan pra këtë lloj dhimbje, përkohshmërinë e gëzimit dhe moskthjelltësinë e qenieve të ngjashme me të. A mund të jenë turmat të alivanosura pas shkëlqimeve të rreme dhe nuk arrijnë dot të kuptojnë dramën e sivëllait të tyre? Sivëllai është mes tyre dhe ata kur nuk kuptojnë dot dramën e njëri-tjetrit, si mund ta ndërtojnë lumturinë kolektive? Kjo të ndërmend dy qenie të së njëjtës turmë, të ngjajshëm si pikat e lotëve dhe njëri vuan verbimin e tjetrit, pa e kuptuar se është edhe vetë duke u verbuar.

Po, ndoshta, ndoshta, poeti është simbol i të vërtetave supreme, dhe si një Mesia vuan duke mbartur në shpirt mëkatet e gjithë njerëzimit, ndërsa turmat, jo vetëm nuk e pranojnë, por e lënë diku të vetmuar, ndërsa vetë hedhin vallen euforike, nën dritën e pishtarëve që papritmas do të shuhën dhe do t'i lënë sërish në errësirë. Poeti-profet duket gjithashtu si një qenie e lodhur në misionin e tij të pakuptuar. Katër vargjet e fundit, të cilat janë edhe monologu më therrës i qënies poet, janë shkëputur prej ditarit të Andersentit.

“Në vend që të shijoj tamam lumturinë/e këtyre minutave që ikin e s’kthehen kurrë më,/kqyr partiturën që të shoh edhe sa vargje/më mbeten para se të shpëtojnë nga tortura/që thëllimi më bën ta lëngoj nëpërdhëmbshëm”.

Këto rradhë të sjellin ndërmend po atë atmosferë që krijonjë fjalët e dijetarit në tregimin-përrallë “Hija”: Shkruaj për të vërtetën, të bukurën dhe të mirën, po asnjëri nuk ma var. Jam i dëshpëruar për këtë”. Verbëria kolektive e lodh gjenin, e bën

të vetmuarin e madh dhe të përлотурin tragjik. Duhet shumë durim në përmbushjen e misionit dhe nëse nuk arrin të kuptohet dot deri në fund nga turma, poeti apo gjeniu nuk ka pse e humb durimin, pasi padashur do të përfundojë një njeri si gjithkush. Një poet-profet i përhumbur është baras me një humbje të tërë kolektive. Drama e moskuptimit kolektiv shpallet edhe në poezinë “Murrizi” (“The Hawthorn”), ku bukuria e përjetshme dhe e vërteta hyjnore (simboli i bredhit që njeh si stinë veç gjelbërimit), lihet mënjane nga mahnitja e qenieve njerëzore pas murrizit, simbol i ikanakes, lulëzimit të beftë dhe vyshkjes shpirtërore. Bredhat në gjelbërimit e tyre të përjetshëm mund të merren edhe si simbol i Parajsës që përshkruan Libri i Shenjtë i muslimanëve Kurani. Kështu del se ne, si qenie moderne, në çoroditjen tonë nuk bëjmë gjë tjetër veçse braktisim pandërprerë parajsën tonë. Lulja simbolizon në këtë rast lulëzimet e përkohshme, apo parajsat e humbura.

Në tregimin “Hija” princesha që vuan nga sëmundja e të parit qartë, tej masës verbohët nga dashuria dhe turma e verbuar i bie të qeveriset tashmë po nga prijësit të verbuar. Rruga e së vërtetës është gjithnjë plot gjemba, paralajmëron Hav, ndaj duhet të dimë edhe si të sillemi me dritën. Dashuria që të mbyll sytë, ose që e shndërron qenien në busull të çorientuar nuk është dashuri, është tradhëti. Kufiri mes të parit (si princesha) dhe dalja e papritur nga loja tunduese e errësirës është tepër delikat. Poezia “Bllofi i të verbrit” mbyllet me vargjet: “Ai qëndroi i shushatur/gati i përлотur, i shokuar nga drita/që për një cast e verboi atë plotësisht” Për dritën e vërtetë, për zgjimin nga letargjia e errësirës, duhen sy shqiponje. Dielli i të vërtetave kërkon kthjelltësi të lartë veshtrimi. Poezia “The Institute for the Blind” shfaqet si një antipod i poezisë “Illumination”. Këtu janë të verbërit realë, të verbuarit fizikë që dinë të vështrojnë në errësirën e thellë, në çastin marramëndës, dhe kërcejnë një tango po marramëndëse, për të sfiduar fatin e tyre tokësor. Nje

tango simbolike, ku duket se ngërthehen bashkë gjithë kohërat, ku në mesin e të verbërve mund të jenë shumë homerë, mil-tonë apo borgesë. Qyteti i perndritur nga përkohshmëria e pishtarëveve, ose qyteti tjetër, ku njerëzit e verbuar nga dashuria nuk janë në gjendje të shohin ëngjëjt e Zotit tek ngjiten e zbresin, apo besimtarin evangjelist (Poezia “When I Go Blind”) zëvendësohet këtu me një shtëpi të zotëruar nga metafizika.

Niels Hav, poetit që shprehet se poetry - poezia nuk është për qullacët dhe që për ta krijuar atë, ju duhet të përballeni dhe ta shikoni realitetin, Zotin ose çfarëdo qoftë tjetër drejt në sy , duket se i pëlqen së tepërmi kjo shtëpi e ndriçuar nga të vërtetat supreme, ku kumbojnë tingujt dhe vallëzimi, njëjtë si në mbretërinë qiellore, ku ëngjëjt i këndojnë këngë adhurimi Zotit tonë. Vetëm në këtë strehë, Hav mundet ta kërcejë targon e tij brilante, të nisur më parë nga etërit e tij shpirtërorë Kierkegaard dhe Andersen.

THE METAPHYSICS OF BLINDNESS IN LITERATURE - NIELS HAV AND HIS PALIMPSESTIC POETIC MESSAGES.

Alisa VELAJ

The allegory of blindness is one of the most preferred literary expedients used by poets and writers of all times. In the 9th song of “The Odyssey”, for instance, Homer narrates how, by way of trickery, the hero manages to rid Polyphemus, the Cyclops, blind of eyesight. In verses 410-411, Odysseus identifies under the name of Nobody [Nobody – that’s my name./ So my mother and father call me, all my friends]. After Polyphemus’ eye is mutilated, verses 454-460 follow with the dialogue between him and his fellow cyclopes who worriedly inquire about his roaring rage: “Nobody, friends, / Nobody’s killing me now by fraud and not by force!”/ His friends boomed back at once: “If you are alone,/ and nobody is trying to overpower you now – look,/ it must be a plague sent here by mighty Zeus/ and there is no escape from that./ You’d better pray to your father, Lord Poseidon.”

In this case, the cunning feat gains a positive connotation in that it brings triumph over evil. The blinded eye turns into a symbol of life for the hero, by ensuring his survival, and into a symbol of death for the source of evil. Prior to getting physi-

cally blind, the Cyclops proved his mental blindness as the dimwit who believed Odysseus to be Nobody. Rather than by Odysseus, therefore, the Cyclops was blinded by his own mis/perception of his adversary's fake identity. It is precisely this myopic incapacity that transposes him into a lonely blind individual or, put otherwise, that condemns him to a two-fold sort of loneliness. His friends' abandonment downgrades Polyphemus' social status from all-powerful to that of a nobody, while their distrust reduces him to a tragic protagonist onto himself. He is now ostracized not only by the light of wisdom, but also by his own kin. The first curse befalls him as a punishment for being an inhospitable barbarian and a cruel cannibal to the human race; the second one, for having been blindly fooled by somebody coming from this race.

While the above-mentioned mythical blindness is deliberately inflicted to incapacitate evil, it may occur that goodness, too, be rendered blind, when evil disguises under the garb of goodness and the hero is on the losing end due to his lack of clear vision. In this case, regardless of values being opposites, the cause of blindness remains the same. The latter allegory would be retaken by H. C. Andersen, the Danish fairytale master, in his story-tale "The Shadow". The whole allegorical secret of the message consists in two key points of the story: First, when the learned man tells the Shadow that "I write about the true, and the good, and the beautiful, but no one cares to hear such things; I am quite desperate...". The drama begins precisely with the learned man's weariness on his course towards truth and with his acceptance of the proposal extended by the Shadow. Truth is thus right from the start, allegorically, overpowered by deceit. Second, in the relation of the Shadow to the princess who, when first striking an acquaintance with the future king, "was troubled with seeing too well." Later on, the princess will be blinded by fake love and untruths. The drama

behind such blindness is multi-dimensional. The Shadow [the impostor] eventually forges his way to becoming a national leader, whereas the blind crowds are deprived of truth – symbolically expressed through the learned man’s execution.

It may be easily perceived that, same as in the mythical narrative where truth is disguised, lack of clear vision to detect untruth or fraud leads the hero towards his demise. In spite of the fact that, unlike the mythical protagonist, Andersen’s hero did by no means deserve his defeat, the message is nonetheless one and the same: blindness results because of excessive trust; blindness results because of mental confusion; blindness results even when one can look and, yet, fails to see deep into the phenomena. The Cyclops realizes truth only after losing his eyesight. When blind, he is able to see. The blindness coming from both mythology and the Danish tale master convincingly takes us to the diversions and disorientations which modern humans have to live through. Apparently, we mortals tend to remain the same through different times. Or, maybe, the notion of different times is also another human ambiguity, for it is the myriad manifestations of human essence through the times that beget the illusion of humans’ times being radically different one from the other.

Niels Hav, the Danish poet, appears to lead his readers towards this conclusion by juxtaposing in his allegory of blindness – as the occasion calls – the present, the past, the learned man, the actual blind person as well as the one who inadvertently is driven to blindness for being able to look, but unable to see. Hav’s novelty in his theme of blindness consists in his angle of approaching the genius individual, or learned man, who is not to be deceived because he prefers to focus on self-discovery rather than on the phenomena or outsiders surrounding him. In poetic form, Hav retakes what S. Kierkegaard, the philosopher, used to define as a journey toward personal

oneness, for it is on his quest for self-awareness that the genius discovers freedom. The poem "On His Blindness" is dedicated to the Argentine poet Jorge Luis Borges. It is noteworthy that, under an identical title, Borges himself would dedicate a poem to John Milton. The latter also wrote his own "On His Blindness" (perhaps dedicated to himself) – a poem closing with the emblematic verse "They also serve who only stand and wait". Patience is thus deemed to signify one's faith in God. A consultancy of the Holy Scriptures would reveal verses referring alike to the God's patience with humans and the human patience with God's plans regarding every individual's life:

"But sanctify Christ as Lord in your hearts always being ready to make a defense to everyone who asks you to give an account for the hope that is in you, yet with gentleness and reverence". (1; Peter 3:15)

"Therefore be patient, brothers, until the coming of the Lord. The farmer waits for the precious produce of the soul, being patient about it until it gets the early and late rains". (James 5:7)

God's patience serves salvation, which means that humans, as transitory beings, should likewise be patient, if they would want their lives to benefit from God's services and deserve salvation. There is sufficient ground to affirm that in his poem dedicated to J. L. Borges, as well as in other ones such as "Illumination", "When I Go Blind", "Blind Man's Bluff", and "The Institute for the Blind", Niels Hav is inspired by this sort of John Milton's biblical patience. However, let's single out "When I Go Blind". Hav simultaneously reveres Borges and Milton in his verses: "Only after going / blind did he make eye-contact with John Milton / in his Paradise Lost". It appears that, in Hav's consideration, earthly loves are hardly ever profound enough to cause blindness. Blindness on account of another earthly being could be the kind of bedazzlement which only leaves one

dumbstruck and largely distanced from the true essence of existence. In an ironically pointed address, he refers to the persona of an eye-doctor. Wasn't it the eye-doctors who failed to restore Borges's eyesight while he managed to see with perfect clarity, regardless of his physical blindness? Isn't it yet another eye-doctor who closes up his clinic in this poem?

"[] Borges go blind -/ as blind as Beethoven was deaf! [] Only now did he come eye-level /with Homer, and only now was he able to see deep /into the dark, wide world and into the dizzying /moment that is eternity".

Hav's darkness, same as Milton's, symbolizes the human world in its condition of imperfect intellect and spirituality; hence his [allegorical] consideration that commonplace human blindness is quite insubstantial in view of the dizzying moment that is eternity. Attaining divine enlightenment – this should be humankind's real mission on their earthly journey. The awareness and ability to head towards such enlightenment is the only empowering source to beat physical blindness and see through darkness, just as Homer, Milton, and Borges did. Right there, in the deepest abyssal obscurity, the aforementioned geniuses [who also represent three historical literary/cultural eras: Antiquity, Renaissance, Modernism] managed to overcome physical blindness and see the ultimate truth, to reach into their innermost self and discover freedom. When phrasing the dizzying moment, Hav seems to imply exactly the same kind of moment that S. Kierkegaard described – when the soul settles inside one's being. Homer, Milton, and Borges triumphed over darkness thanks to this one possession – the golden key to genuine truth and freedom.

According to Niels Hav, poetry's first duty is to be an intimate talk with the single reader about the deepest mysteries of existence. One of the mysteries which he tries to uncover is the actual metaphysics of blindness. In the poem "Illumina-

tion”, Hav retakes a poet addressee, standing by the city hall window of the Danish town of Odense. The town unfolds in his eyes in dazzling lights, but the poet is unable to enjoy the lightflood and fanfare because of his physical pain. A seemingly trivial pain like a toothache , yet one of the most tormenting ones, generates tens of questions about the painful nature of being a poet along with the cause of such pain. Is the poet-prophet envisioning a different world, less illuminated, after a predictably temporary, dazzling light-show and merriment? In this particular context, the artificially bright happiness of the citizens strikes the poet with a negative impression, for it associates in his mind with a flash-in-the-pan excitement of crowds blinded by momentary euphoria; of people lacking the inclination to perceive or go catharsis-deep into enlightening their own souls, so that their “illumination” of joy and happiness be everlasting and not flickering until the torches die out. Regardless of a likely variety of subjective interpretations, one could very well be that the poet is painfully experiencing the superficial, ephemeral happiness borne of his fellow-beings’ mental unclarity. Could the crowds, delirious with fake lighting, fail to notice the drama of their poet fellow-man? If their fellow-man is in their midst and individual dramas go unnoticed, how can they even think of building collective happiness?! The answer would invoke two individuals from one and the same crowd, akin like two tear-drops, with one suffering his fellow’s blindness, unaware that, in the process, he himself is being blinded by his own mindset.

However, maybe, just maybe, the poet is a symbol of superior truths and, like a Messiah, chooses to suffer in his heart for the sins of the whole mankind, whereas the crowds not only react in irate rejection, but abandon him somewhere in loneliness, while themselves dancing their euphoric dance, under the dazzle of the torches that will soon die out and leave them,

yet again, back to darkness. The poet-prophet also appears as a frustrated being in his non-understood mission. The last four verses, which are also the most excruciating monologue of a poet's soul, are extracted from Andersen's diary:

"Instead of properly enjoying the happiness/of these minutes that will never return,/I looked at the song sheet to see how many verses/remained before I could be rid of the torture/the cold air forced me to suffer through my teeth".

These verses remind the reader of the same atmosphere rendered by the learned man's statement in the story-tale "The Shadow": "I write about the truth, the beautiful, and the good, but no one is interested...I am quite desperate...". Collective blindness may be tiresome to a genius; it may turn a lonely man into a great man and a tear-shedding man into a tragic one. Even if he is not thoroughly understood by the crowd, the poet or genius should not lose his patience, for otherwise he would end up a man like anybody else. The loss of a poet-prophet is equal to a whole collective loss. The drama of collective non-understanding also unfolds in the poem "The Hawthorn", where eternal beauty and divine truth [symbolized by the fir-tree, whose only season is greenery] are overlooked by human beings who, instead, are amazed by fancy transience, sudden bloom, and spiritual withering [symbolized by the hawthorn]. The life-long greenery of the fir trees may also be interpreted as a symbol of Paradise [Jannah] as described in the Qur'an, the Holy Book of Muslim believers. Whence it would follow that, in their confusion, modern human beings are incessantly abandoning their Paradise. The hawthorn, in this instance, stands as a symbol for temporary blooming or lost paradises.

"The hawthorn is blooming/hysterical /one week in May –/ that's the one /we love".

In the story-tale "The Shadow", the princess, even

though able to see too well, gets blinded by [fake] love, whereas the blind crowd readily subjects to the governance of a blind leader. The road to truth is always full of shady thorns and thistles, Hav warns, hence the need to handle light cautiously. The kind of love that blindfolds the being or transforms him/her into a directionless compass cannot be love, but only some sort of its opposite like e.g. disloyalty. It is a really thin borderline between the capacity to see and the ability to immediately dismiss the tempting game of ambiguity and darkness. The poem “The Blind Man’s Bluff” closes with the verses: “He stood bewildered /on the brink of tears, shocked by the light /that for a moment turned him completely blind”. Genuine light, the awakening from lethargic darkness, the shining truth – however distant it may appear – require an eagle’s eyesight. The poem “The Institute for the Blind”, an antipode reflection of “Illumination”, focuses on real-life, physically blind people who, nonetheless, are able to see through the thick darkness, into the dizzying moment, and to dance a tango just as dizzying, in their resilience to challenge their earthly destiny. A symbolic tango, a blind Al Pacino’s “Scent of a Woman”-type of tango, where all times seem to blend in and where, among such wonderful blindmen, one might find many Homers, Miltons or Borgeses! The town illuminated by transient torches or the other town, where blind love-stricken people cannot discern the godly angels as they ascend and descend, along with the Evangelist believer [in “When I Go Blind”], are here replaced by a residence ruled by metaphysics.

Niels Hav, the poet who affirms that “...poetry – the profession – is not for wimps. You have to face yourself and look at reality, God, or whatever it is, straight in the eye” , seems to adore this residence illuminated by superior truths, reverberating with music and dancing, same as in the heavenly king-

dom where angels sing their praises to God. Only under such a shelter, Hav can dance his brilliant tango, joining his spiritual forefathers, Kierkegaard and Andersen.

ROLI DHE RËNDËSIA E FNP “DITËT E NAIMIT” NË AFIRMIMIN E VLERAVE UNIVERSALE POETIKE DHE TË KULTURAVE TË POPUJVE

Xhelal ZEJNELI

Vlerat letrare-artistike janë urat më të forta të komunikimit midis njerëzve. Arti i mirëfilltë nuk njeh kufij. Ai është i pakufizuar në kohë. Gilgameshi i babilonasve, me vjetërsinë e tij 4000-vjeçare, lexohet edhe sot. Po kështu, edhe poemat homerike mbi heronjtë e Trojës.

Festivali ndërkombëtar i poezisë “Ditët e Naimit” gjatë veprimtarisë së tij 20-vjeçare i afirmoi vlerat poetike universale, por edhe kulturat e popujve. Duke sjellë krijues letrarë nga të pesë kontinentet e rruzullit, “Ditët e Naimit” bënë të mundur që shumë poetë të botës të takohen në një vend, në qytetin rrëzë Sharrit dhe të njihen ndër vete. Të komunikojnë me gjuhën artistike, me mjete shprehëse poetike dhe të përcjellin para publikut mesazhe të dashurisë, të lirisë individuale dhe të paqes mbarënjëzore.

Në “Ditën e Naimit” kanë ardhur 20 vjet me radhë, poetë nga të gjitha vendet e Evropës, nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës, nga Amerika Latine, nga vendet arabe, nga konti-

menti i Afrikës së nxehtë, nga vendet aziatike si dhe nga rajoni Ballkanit.

Në festivalin e sipërthënë kanë marrë pjesë edhe krijues letrarë-artistikë nga të gjitha trojet shqiptare, përfshi edhe ata të ngulimeve historike dhe të diasporës.

Mesazhe dashurie, lirie dhe paqeje, përcollën poetë nga Shqipëria, nga Kosova, nga Kosova lindore (Preshevë, Bujanovc, Medvegjë), nga Maqedonia, nga Mali i Zi, si dhe krijues çamë.

Vargjet poetike të arbëreshëve, siç janë Kate Xukaro, Zef Skiro di Maxho dhe shumë të tjerë, prore kanë ngjallur mallëngjim ndër adhuruesit e artit të fjalës.

Te Naimi takoheshin vargëzues, popujt e të cilëve, ndër shekuj dhe dekada kanë qenë dhe janë në konflikt. Aty i gjen poetët nga Izraeli dhe nga Palestina, hebrenj dhe arabë. Vargjet e tyre bëjnë thirrje për dashuri midis popujve, për paqe dhe për tolerancë. Arti i tyre bën thirrje për pajtim dhe është kundër zjarrit.

Te Naimi vijnë poetë nga vende të mëdha të planetit, nga ShBA-ja, nga Rusia, nga India, nga Gjermania, nga Italia, nga Franca, nga Britania e Madhe etj. Ndonëse u përkasin popujve të mëdhenj, këta mjeshtër të fjalës artistike shquhen për thjeshtësinë e tyre. Madhështore në ta, është shprehja poetike dhe porosia mbi lirinë e individit dhe të popujve.

Te përmendorja e Naimit, mu para pallatit të kulturës të qytetit të Pollogut dhe të Sharrit, takohen vargëzues të kulturave dhe të qytetërimeve të largëta, të racave dhe të religjioneve të ndryshme, të gjuhëve dhe të historive të dallueshme. Para Naimit, ata të gjithë afrohen me njëri-tjetrin, njihen ndër vete, komunikojnë dhe e kuptojnë njëri-tjetrin.

Ata flasin me gjuhën e pararendësit të simbolizmit, poetit amerikan Edgar Alan Poe, me figurat stilistike bodleriane, me stilin poetik të Pol Verlenit dhe të Artyr Rembosë. Ngandon-

jëherë, janë hermetikë si poezia e Stefan Malarmesë.

Poetët e botës të tubuar në “Ditët e Naimit”, flasin në një kohë kur kjo botë e egër, për çdo ditë tronditet nga zjarri i dhunës dhe nga flaka e forcës. Ata mbajnë nën sqetullat e tyre vargje, të cilat në këtë kohë të errët kërkojnë ndriçim nga fanari i Diogjenit dhe nga qiriri naimian.

Shumë krijues të këtij manifestimi, e njohin edhe veprën madhështore të bilbilit të gjuhës sonë – Naimit.

Naimi, ky apostull i shqiptarizmit, njohës i thellë i iluministëve francezë - Volterit, Rusoit, Denis Didërosë, D’Alamberit, në vargjet e veta kërkonte harmoni ndër popujt e gadishullit, të trazuar gjatë historisë.

Të impresionuar nga vargu naimian, poetët e botës, pjesëmarrës të këtij festivali, me shkronjat e tyre kërkojnë qiellin e kaltër, pëllumba të bardhë, dritë dhe diell për mbarë njerëzimin. Këta poetë vazhdojnë të mbajnë gjallë poezinë, madje edhe në këtë kohë të teknologjisë kompjuterike dhe të komunikimit internetik.

Poetët planetarë që vijnë në Sharr, kur kthehen në foletë e veta, nuk ngurrojnë t’i thurin vargje rilindësit tonë, i cili për të na bërë dritë, u tret si qiri.

Festivali ndërkombëtar i poezisë “Ditët e Naimit” njëzet vjet me radhë mbahet në Tetovë. Por, Drejtorja e saj e udhëhequr nga drejtori, njëherazi dhe poeti Shaip Emërllahu, i çon poetët pjesëmarrës edhe në Shqipëri dhe në Kosovë. Me një fjalë, arti i fjalës dëgjohet në një pjesë të madhe të botës shqiptare.

Derisa janë në Tetovë, poetët e botës i vizitojnë edhe vendet dhe objektet kulturore e historike të qytetit, në veçanti teqenë Arabati Baba, këtë tempull shpirtëror me vjetërsi shekujsh, të drejtuar prej shqiptarëve.

Mbrëmje letrare organizohen edhe në dy universitetet tona – në Universitetin e Tetovës si dhe në Universitetin e Ev-

ropës Juglindore, me ç'rast priten me interesim të veçantë nga pedagogët dhe nga studentët e këtyre tempujve të diturisë.

Edhe gjatë vizitave nëpër qytete të caktuara të Shqipërisë dhe të Kosovës, poetët e botës mbajnë mbrëmje letrare, me ç'rast i lexojnë, i deklamojnë, i recitojnë, e disa prej tyre edhe i këndojnë - vargjet e veta.

Gjatë vizitave të sipërthëna, ata i vizitojnë edhe vendet, monumentet dhe institucionet arsimore dhe shkencore, kulturore dhe historike të kombit shqiptar.

I vizitojnë muzetë kombëtarë, kështjellat e vjetra të periudhave ilire dhe romake, amfiteatrin e Durrësit apo të Butrintit si dhe godinat e tjera të lashtësisë.

Gjatë këtyre vizitave, gjithmonë të përcjella me organizim evenimentesh letrare, poetët që vijnë nga të pesë kontinentet e rruzullit, takohen edhe me qytetarët e rëndomtë.

Mbresat e tyre nga këto vizita dhe kontakte me shqiptarët e krahinave të ndryshme, me t'u kthyer në vendet nga kanë ardhur, shumë prej tyre i shfaqin në vargjet e veta, me vlera të larta artistike.

Ata janë të impresionuar me bujarinë dhe me fisnikërinë e shqiptarëve, e në veçanti me mikpritjen e pakrahasueshme.

Në ato vargje, ndonjëherë edhe bajroniane, shihet se ata janë të magjepsur sidomos me etnografinë shqiptare, dëshmi kjo e lashtësisë së këtij populli.

Nga ekspozitat që organizohen në foajenë e pallatit të kulturës, pjesëmarrësit njihen me veprat e artit figurativ, kryesisht të autorëve shqiptarë, me veshjet popullore shqiptare, me punimet artizanale të trevave të ndryshme shqiptare, me fotografitë artistike që janë dëshmi e krimeve makabre serbe në Kosovë. Manifestimi shoqërohet edhe nga vallet popullore shqiptare. Poetët, dhe jo vetëm ata, impresionohen nga koreografia shqiptare.

Ky ndërkomunikim midis botës shqiptare dhe poetëve

që vijnë vite me radhë nga mbarë bota, është në funksion të afirmimit të vlerave kombëtare dhe të virtyteve njerëzore të shqiptarëve.

Në “Ditët e Naimit” vijnë krijues letrarë artistikë nga e tërë hapësira etnike historike shqiptare. Takimi i tyre bën të mundur bashkimin shpirtëror shqiptar. Këto takime vijnë pas një periudhë të gjatë të ndarjes me kufi të hekurt e të pakapërcyeshëm. Takohen poetë, shkrimtarë, studiues letrarë, kritikë letrarë, historianë të letërsisë, teoricienë të letërsisë, intelektualë, akademikë, profesorë universitarë, atdhetarë që kanë vuajtur dënime burgu në kazamatet jugosllave për fjalën e lirë, për lirinë e shprehjes, për dritën e një populli të tërë.

Të gjithë mirëprehen nga adhuruesit e poezisë, nga studentë, nga nxënës, nga njerëz të arsimuar – dashamirë të fjalës artistike.

Manifestimi letrar ndërkombëtar “Ditët e Naimit”, gjatë veprimtarisë 20-vjeçare ka botuar dhjetëra libra, vepra letrare, përkatësisht antologji poezish. Në to janë përfshirë krijimet poetike të poetëve nga mbarë bota.

Shumë poezi të poetëve të botës, ky manifestim i ka përkthyer në gjuhën shqipe, duke kontribuar kështu në afirmimin e fjalës së bukur, të vargut artistik, të autorëve të shprehjes poetike, të vendeve nga vijnë ata si dhe të kulturave të popujve të ndryshëm të botës.

Manifestimi “Ditët e Naimit” poetëve që sjellin vargje me vlera artistike universale, u ndan edhe shpërblime. Vlerësimi i krijimeve letrare të laureatëve bëhet nga juria treanëtarëshe, njëri prej të cilëve është nga Shqipëria, tjetri nga Kosova, ndërsa i treti nga Maqedonia. Vlerësimi kryhet përjashtimisht me kritere estetike. Rrjedhimisht, kriteret jashtëletrare – përjashtohen.

Përbërja e jurisë nga anëtarë të trojeve shqiptare flet qartë për dimensionin gjithëkombëtar të “Ditëve të Naimit”.

Brenda këtyre 20 vjetëve, laureatë kanë qenë krijues nga kontinenti i vjetër, nga ShBA-ja, nga Amerika Latine, nga Lindja e Largët, nga vendet arabe, nga Izraeli, nga trualli ballkanik.

Laureatë të këtij manifestimi kanë qenë edhe poetë nga të gjitha trojet shqiptare, përfshi edhe poetët arbëreshë.

Shumë poetë apo shkrimtarë – të huaj dhe shqiptarë, janë shpallur anëtarë nderi të Festivalit ndërkombëtar të poezisë “Ditët e Naimit”. Midis tyre ka poetë të afirmuar në shkallë ndërkombëtare, të cilët kanë qenë të nominuar edhe për çmimin Nobel.

Janë lauruar apo janë shpallur anëtarë nderi krijues letrarë shqiptarë, personalitete eminente, të brezit të vjetër si dhe të brezit të ri. Ndër ta edhe gjiganti i letrave – Ismail Kadare.

KOMUNIKIMI POETIK SI UTOPI DHE VIZION

Ahmet SELMANI

1.

Secili festival poetik, përveç karakterit parësor të tij që, gjithsesi është synimi për t'i shfaqur vlerat artistike të krijuesve që marrin pjesë ose që e përfaqësojnë atë letërsi, po ashtu e ka edhe karakterin e një ekskursionit gjeografik, qoftë ai edhe brendakombëtar. Të mbledhësh pena krijuesish nga vise dhe regjione të ndryshme dhe t'i prezentosh ato para një auditori (lexues dhe dëgjues), është vërtet një shëtitje interesante dhe një zbulim i realitetit krijues dhe njerëzor. Kështu, edhe Festivali Ndërkombëtar i Poezisë deri tani ka bërë një prezentim të larmishëm poetik, duke arritur të sjellë rrëzë maleve të Sharrit me dhjetëra e dhjetëra poetë të huaj e shqiptarë, duke krijuar një ndërkomunikim të drejtpërdrejtë midis tyre. Kur të merret parasysh fakti se në të kanë marrë pjesë poetë edhe nga viset më ekzotike të botës, siç janë Karaibet apo India, atëherë aq më tepër dëshmohet se në edicionet e këtij festivali janë ngritur ura të shumta kulturore e letrare, është bërë një ndikim shpirtëror tek auditori artdashës i cili i ka përcjellë me vëmendje paraqitjen e vlerave që kanë shpalosur poetët e ndry-

shëm. Pra, brenda këtij festivali është bërë një ekskursion poetik shumë i gjerë. Ndaj kështu tradita e tij gjithnjë e më tepër është rrënjësuar në këto hapësira, për ta ruajtur vazhdimësinë me një intensitet të pazvogëluar, madje duke u përsorur në aspektin artistik dhe organizativ.

2.

Edhe në edicionin e nëntë të Festivalit Ndërkombëtar të Poezisë “Ditët e Naimit 2005” poezia do të jetë mbizotëruesja kryesore, formula magjike që i lidh njerëzit dhe popujt, që i shkund ndërgjegjet dhe që i trand shpirtërat, që e bën fjalën të jetë burkoria mahnitëse përmes së cilës e pamundshmja bëhet e mundshme. Këtu krijohet një rruzull poetik jashtëzakonisht i gjerë, i përshkuar me tema e motive nga më të ndryshmet, me gjuhë e mendësi të shumta, për t’u pikëtakuar në një emërues të përbashkët që quhet art. Këtu poetët e huaj sjellin frymëmarrjet e tyre, shqetësimet e shumta për qenien njerëzore dhe ekzistencën në përgjithësi. Natyrisht dallojnë qasjet dhe shprehjet, stilet dhe teknikat krijuese, por janë të njëjta shqetësimet ndaj njeriut dhe realitetit. Ata ngrenë mite dhe rrënojnë njëherësh, varësisht nga nevojat njerëzore. Me një fjalë, poetët flasin me gjuhën e zemrës, gjuhë e cila është e njëjtë kudo, pavarësisht nga gjuhët dhe racat. Edhe kur shumë popuj bëjnë luftë midis tyre, poezia e tyre përsëri është bashkë, ngaqë është e vetmja që e ruan arsyen e shëndoshë, thjesht është e paluhatshme gjatë ekzistencës së saj.

3.

Ashtu sikurse në çdo edicion tjetër, edhe kësaj radhe poezia shqiptare do të prezentohet me disa emra të cilët bartin me vete shqetësimet e tyre krijuese, për t’u rasdhitur në këtë mozaik të interkomunikimit të gjerë. Modusi i kësaj poezie është i veçantë, aq më tepër kur të merret parasysh se në këtë edicion

kryqëzohen poezi nga vise e regjione të ndryshme të botës, për ta dëshmuar vetveten se është trashëgimtare e një shpirti të trazuar nëpër kohë e hapësira të ndryshme. Thjesht, nuk është vetëm ajo që krijohet në trojet etnike, ku për afërsisht shfaqet me një fizionomi të njëjtë gjuhësore, por edhe ajo që krijohet jashtë tyre, siç është ajo që krijohet sot në mërgatën shqiptare të Italisë së Jugut, e cila me gjithë pamjen arkaike të saj mëton të ecë nëpër epokën moderne, sigurisht me një tis të ngjeshur artistik. Pra e tillë është poezia shqiptare, autoktone dhe ekzotike njëkohësisht, e lashtë dhe e re, e afërt dhe e largët etj. Edhe kjo sjell një freski në këto mjedise të brishta të botës shqiptare ku atmosfera iracionale ia zë frymën arsyes njerëzore. Mbase poezia do të jetë ajo që do ta thyjë atë për disa çaste.

4.

Festivali Ndërkombëtar i Poezisë “Ditët e Naimit 2005” edhe njëherë do të dëshmojë se ndërkomunikimi poetik është një metaforë e bashkëpunimit më të gjerë midis kulturave dhe gjuhëve. Është thënë e stërthënë kushedi sa herë se poezia nuk mund t’i ndryshojë gjërat fizike, nuk mund t’i rrënojë muret dhe pengesat e shumta, por ajo mund ta ndryshojë shpirtin, ta pasurojë atë dhe ta bëjë të kthjellët para situatave të ndryshme. Prandaj, përpjekja e poetëve të ndryshëm për të sjellë porosi dhe vlera në edicionet e këtij festivali nuk është një utopi, por një vizion i shëndoshë i cili do të jetësohet pak nga pak nëpër breznitë të ndryshme, duke shkundur ndërgjegjet e fjetura dhe duke i zgjuar njerëzit nga letargjia e panevojshme.

GJASHTËMBËDHJETË HERË – MALL PËR KULTURËN BOTËRORE

Dr. Agron TUFA

(Mbi edicionin e gjashtëmbëdhjetë të Festivalit Ndërkombëtar të Poezisë “Ditët e Naimit”, Tetovë 2008)

Një nga formulimet më interesante mbi rolin e traditave dhe shkollave poetike në shkëmbimin e përvojave dhe njohjen e ndërsjelltë të tyre, e ka dhënë, sipas meje, poeti rus Osip Mandelstam, i cili së bashku me Anna Ahmatovën përbëjnë emblemen e asaj shkolle poetike që njihet me emrin “Akmeizmi”. Kur e pyetën Mandelstamin se çfarë është për ju “akmeizmi”?, ai u përgjigj: “mall për kulturën botërore”.

Si shprehja më e lartë e shkallës së vetëdijes estetike e ontologjike të gjuhës, poezia është lloji që ka mbijetuar ndër kulturat e lashta të njerëzimit, duke shtegëtuar nga mijëvjeçari në mijëvjeçar, nga shekulli në shekull e nga epoka në epokë, dhe me një fshikje ringjallëse ka zgjuar ndër shprirtrat njerëzor frymën shtegëtuese të njeriut në të gjitha gjendjet e larmisë së tij përballë misterit, mahnisë, vdekjes, dashurisë e të gjitha problemeve të përjetshme metafizike.

Poezia, megjithë zhvillimet e arteve konkurruese, me gjithë shpikjet e realiteteve virtuale, megjithë përsosjen e teknologjive vizuale dhe auditive, mbetet siç ka qenë: nevojë e pashmangshme e një shpirti të uritur, e vetmja forcë që shquan “tej nënëtë perdes”, që krijon apologjinë e ngushëllimit, shpresës apo ngazëllimit individual mbi format e tjera të ekzistencës. Sepse poezia ka një sekret gjenetik të jetëgjatësisë, në ndryshim nga recipienti pasiv i audiovizual: poezia ka një origjinë që hapet pandërprerë në historinë e species tonë dhe rrënjët burimore të saj të çojnë pashmangshëm në Zanafillë, atëherë, kur kryesëpari poezia, në të gjitha versionet dhe popujt ka qenë Lutje. Këtë strukturë të lutjes, për veten, të afërmin, këtë lutje adresuar Zotave, Fatit, Fuqive përtej tij, poezia e ka trashëguar, qoftë në format e saj të drejtimit kah adresati konjret, qoftë drejtuar në vetvete, si rrëfim, si predikim, si shkarkim autor-rrëfimor drejtuar alter egos së tij.

Bota e lashtë dhe e re, trazuar nga pasionet, zbulimet, shpikjet dhe utopitë, nuk ka mundur të sajojë një armë më rezistente e më të efektshme se sa poezia, këngëzimi në vetvete; janë shembur pa nishan mbretër e perandoria të tëra janë bërë pluhur e hi, por ka mundur të shpetojnë “bllloqe” shumë më të pavdekshme se muret ciklpike të Mikenës, shumë më të pavdekshme se piramidat: ato janë bllloqet strofike apo strukturat e pashkatërrueshme nga koha të poetëve me poezitë e tyre. Kësisoj njeriu i të gjitha kulturave ka jetuar, është ngjizur dhe formësuar nga alkimia e formulave kombëtare të vargjeve të veta, siç janë paraskicuar dhe profilet e veçanta kombëtare nën plazmën supersticioze të eposeve nacionale, në pajtim me embrionin utopike që kanë ato.

Komunikimi me poezinë mbetet sfida më e vështirë e njerëzimit të sotëm. Jo për shkak të vështirësisë. Përkundrazi. Lehtësia e sotme e komunikimit me poezinë është më e mundshme e më banale se kurre. Por mbijetesa e një ndërtimi të qën-

drueshëm komunikativ duhet kërkuar në situatën e krijuar që rëndohet gjithë e më fort në civilizimin e sotëm, me shock-un e llojeve të komunikimit, me llavën përmbytëse virtuale, me përtacinë dhe pasivitetin e ripërtupjes së informacionit. Ka ndoshur ajo që Lyotard-i e ka konstatuar në “Gjendjen e Postmodernit: raport mbi dijen”: “revolucioni teknologjiko-informativ e rrit së tepërmi vëllimin e kujtesës sociale, por e bjerr cilësinë e saj”.

Por nuk duhet të harrojmë se cilësia e njerëzimit varet nga cilësia thelbësore e dialogut që ndërton, nga cilësia e kuvendimit shpirtëror dhe frymor. Kur filozofi i lashtë grek Parmenidi thoshte se “Përlasja është babai i të gjitha sendeve (ideve)”, ai me siguri, me këtë shprehje nuk ka patur parasysh përplasjen e “kungujve”. Dialogu shpirtëror e frymor i përvojave poetike të popujve, nuk është rutina burokratike e një konference a simpoziumi të financuar nga interesa po aq komerciale anëkënd botës. Përkundrazi ky lloj kuvendimi thelbësor, është një nevojë e domosdoshme dhe risjell edhe njëherë në trajtë baladeske rinjohjen me ëndrrat, frikërat, dëshpërimin dhe shpresat e njeriut. Ky kuvendim është përcaktues për profilin e njeriut të epokës sonë, pasi aty pikëtakohet njësia individuale me aspiratat dhe ëndrrat e vetrealizimit në histori me shprehjen e alegorike e të pavetëdijshme përmes imazheve dhe figurave të endrrave dhe aspiratave kolektive.

Poetët janë skicues të kontureve futurologjike, ata projektojnë dimensionin shpirtëror që na paraprin dhe në, ashtu si në një shërbim sinoptik, mund të gjykojmë mbi simptomat (apo sindromat) e asaj se çfarë ardhmërie i hapet kulturës dhe vetëdijes njerëzore në shekullin tonë.

Një ndër misionet që e bën të mundshme realizimin e një interkomunikimi të tillë, janë padyshim, Festalet e ndryshme Ndërkombëtare, si mundësitë më ideale për të realizuar njohjet e ndërsjellta dhe për të shquar se çfarë na lëviz përpara, cilat vlera, cilat frikëra, cilat bukuri ndjellëse e fisnikëruese. Ndo-

nëse jashtë vëmendjes së merituar nga instancat shtetërore e popblike, takimet e tilla, përveçse të dobishme e të domosdoshme, janë para së gjithash prekëse me ndjenjën e vetëdijshme të sakrificës.

Festivali poetik Ndërkombëtar “Ditët e Naimit” që zhvillohet tash 16 në Tetovë, në këtë “Cep të Ilirisë Verilindore”, siç mund të shprehej Mitrush Kuteli, është një prej këtyre sakrificave, të cilat vlejné shumë e më shumë se sa të gjitha “lloqet” që tjerin tutorët shtetërorë me propagandat e tyre. Ky Festival i Gjashtëmbëdhjetë, na flet me një gjuhë të njëkuptimtë, se Sakrificat kulturore bëhen pa bujë, me përunjësi, brishtësi dhe dashuri. Se, siç thotë në një poezi poetja Olga Sjedakova – “Vetëm dashuria është e brishtë, dhe vetëm brishtësia është e thellë”.

Prandaj, jo vetëm si poet shqiptar (si një ndër të shumtët) jam veçanërisht i gëzuar e krenar që për kulturën time kombëtare gjenden aty ku nuk pritëshin “dalëzotës” dhe “dashnorë adhures” të saj, që i mbajnë në këmbë shtyllat e Tempullit. Në një aspekt tjetër “gjeopoetik”, puna e palodhur dhe këmbëngulëse e këtij grupimi fisnik poetësh me emra konkretë – siç është veçanërisht puna qendrore e dy poetëve z. Shaip Emërlahu, Ahmet Selmani, e, padyshim, e shumë të tjerëve, - është një mësim dhe shembull praktik, është një model se si duhet të dalim nga rrethi vicioz i provincializmit dhe izolacionit kulturor kombëtar. Mësim që vjen jo nga qendra, por nga skajet e gjeokulturës sonë kombëtare – pikërisht aty ku Atdheu ynë gjuhësor e kulturor dhemb më shumë!

Me qëndrueshmërinë dhe me koherencën e gjashtëmbëshjetë edicioneve, me shumën e performancave leximore në ditët e Festivalit, me antologjitë poetike përkatëse të pjesëmarrësve për çdo Festival apo me promovimet e një rradhe të pafundme librash poetikë – kolana të këtij Festivali, - unë mendoj se janë shfaqur përmasat e një misioni kulturor që e

tejkalon Tetovën dhe çdo metropol tjetër të kulturës shqiptare. Gjykuar nga thellësia, përkushtimi, talenti dhe inteligjencia e krijuesve të Tetovës dhe gjithë arealit kulturor shqiptar në Maqedoni, gjykuar nga njohja ime e krijimtarisë dhe veprimtarisë së tyre kulturore, botuese, me revista e projekte ambicioze artistike, - kjo pjesë e gjeokulturës sonë, me një bashkëpunim edhe më të ngushtë e miqësor, mund të shndërrohet lehtë në një pol të kulturës sonë kombëtare që dikton dhe ndikon duke sjellë kontribute e vlera të paharrueshme në trashëgiminë letrare mbarëshqiptare, duke e pasuaruar atë edhe me përvojat e kulturave të huaja poetike, por edhe me idolet e vetë poezisë shqipe: një Naim Frashër në 3 m brozx në mes të Tetovës, çka nuk gjendet në asnjë metropol shqiptar, as në Tiranë, as në Prishtinë. A nuk kanë qenë në fillim arbëreshët e Italisë që kanë ushtruar një ndikim të tillë në formësimin e kulturës kombëtare në kohën e De Radës?

MBIJETESA E POEZISË

Dr. Agron TUFA

Si për të sfiduar të vërtetën e një vargu sentencial të Bertold Brehtit – “Është kohë e keqe për lirikën”

– Tetova edhe këtë tetor i mbledh për të trembëdhjetën herë zërat poetikë nga gjithë paralelet dhe meridianët e globit, pikërisht për të harmonizuar korin madhështor të ekstatizmit lirik.

Por, a është menjëmend, siç qe shprehur Brehti, “kohë e keqe për lirikën”? Nuk është vetëm imazhi dhe atmosfera e petaleve të brishta të lulekumbulave, të cilat e thellojnë raportin tëhuajësues në ajrin e nginjur me kutërbim të athët baruti; nuk është shkëlqimi i bajonetave, as të shtënat e largëta të artillerisë dhe uturima e kamionëve të luftës, pra nuk janë vetëm këto peisazhe mortore që e bëjnë të pamundur kohën e lirikës, krejt ashtu siç e ndjente poeti gjerman. Bertold Brehti nuk kishte si t’i parashikonte kohërat tona, që e vrasin jo më pak lirikën. Sepse, armiqtë e saj janë shtuar e shtohën ditaditës në masën e topitjes së shqisave të qytetërimit tonë, në masën e parajsave përtaçe të konsumit, në masën e vdekjes së ndjenjave autentike të përvujtnisë dhe përgjegjesisë.

Armiqtë e poezisë, në përgjithësi, shtohen përditë, e shpeshherë, brenda vetë “dashmirëve” të saj, të cilët me buzëqëshje recitojnë poezi, shkruajnë ndonjëherë vargje, botojnë dhe e ligjërojnë atë. Por, që të gjithë, pas shpinës së saj ngrenë dorën me kamën vdekjeprurëse, si dora e ngritur e Brutit mbi Cezarin.

Armiqtë e poezisë shtohen përditë dhe rreziku me të cilin përballet ajo bëhet përditë e më i vështirë, ashtu sikurse bëhet më e vështirë qëndresa e organizimit njerëzor përballë viruseve të reja. Poezisë nuk i duhet më të luftojë vetëm me armiqtë e saj të vjetër – shtetin, diktaturat, muzën e vënë në shërbim të ideologjive, burokracive dhe morgut të studuesve dhe lektorëve nëpër universitete. Poezisë i duhet të përballojë mefshtësinë dhe përtacinë shpirtërore të ferrit komunikativ bashkëkohor. Poezisë i duhet të luftojë me informacionin dhe automatizimin e shpirtit njerëzor, me gjithë atë masë të trashë viskoze që izolon shqisat tona për ndjenjën e perspektivës dhe projektimit tonë në të Vërtetat e Epërme.

Poezisë i duhet të mbijetojë vetveten. Të shpikë format e mbijetesës së saj. Të gjejë aleatët e një gjaku me të. Të heshtë, të ruajë higjenën e saj, të ëndërrojë e strukur në zhguallin e saj më të thellë. Poezisë i duhet të jetë më e guximshme se vetë ndërgjegjja e flijimit. Poezia, sot, duhet të dëshmojë se nuk është dobësi, siç mendon turma e pamend. Nuk është çmenduri, siç beson turma e panerv. Nuk është humbje kohe, siç mendon turma e pakohë. Nuk është e padobishme dhe praktike, siç mendon turma grykëse dhe anonime.

Të gjithë poetët e njëmendët, që i shërbejnë tem-pullit të vet, vetvetes në rradhë të parë, përnaltësojnë atë ngrehinë të shenjtë që Hyu e krijoi prej balte dhe qielli, harmonizojnë idenë e Demiurgut mbi trupin dhe shpirtin njerëzor, unitetin e lashtë trup e shpirt. Përndryshe, neutralizojnë vërshimin dhe marrjen përpjetë të një zanafille mbi tjetrën. Nga na vjen kjo bezdisje

dhe kjo vrajë në shpirt, ne, bashkëkohësve që jemi rritur me Homerin, Katulin, Danten, Pushkin apo Montalen? Sepse motivi i të gjitha lëvizjeve dhe rraskapitjeve të përditshmërisë tonë përreth nesh ka një origjinë trupore. Trupi është bërë idoli i ri, idhujtaria e re.

Poezisë i duhet të mbijetojë në një garë të pabarabartë realitetesh të ashpra e agresive. Rruga e saj duhet të kalojë në shmang, si rruga e oshënarit, jashtë kompromiseve dhe kompromentimeve. Rruga e saj është sakrificë, askeza, karantina që garanton pastërtinë e llojit.

Një udhë të ngjashme, një sakrificë të tillë përbën edhe njëra ndër format e mbijetesës së poezisë këtu në Tetovë. Sakrificë e trembëdhjetë, sa ç'ishte dhe numri i apostujve. Dikush duhet ta mbajë gjallë tem-pullin. Dhe shpesh harrohen pikërisht fjalët e mirënjohjes për mbajtjen gjallë të tempullit. Këtë na jep të drejtë të kujtojmë poeti tetovar, Shaip Emërllahu, që e mban gjallë frymën e poezisë shqipe dhe botërore, për të trembëdhjetën herë në këtë trevë të lashtë shqiptare. Atij ia kushtojmë dhe mirënjohjen tonë në këtë edicion të trembëdhjetë të Festivalit Ndërkombëtar të Poezisë "Ditët e Naimit", me bindjen tonë, se gjithmonë poezia do të ketë mbrojtësit e saj, se muza e saj që u ka mbijetuar ditëve të luftës, do të dijë të mbijetojë edhe në ditët e paqes.

Tiranë, 30. 09. 2009

DRITA E POEZISË...

Prof. Dr. Ymer ÇIRAKU

Në ngrehinën e Qendrës Kulturore Naim Frashëri të Tetovës, tek hyn, kur kthen djathtas, ndesh derën e një zyre, ku bie në sy mbishkrimi: Ditët e Naimit. Brenda kësaj zyre modeste, ngulur në tryezë, përballë ekranit të kompjuterit, takon z. Shaip Emërlahu, poet, dhe njëherazi Drejtor i Festivalit Ndërkombëtar të Poezisë Ditët e Naimit. Është festival i ideuar dhe drejtuar prej tij, deri tani për 14 vjet radhazi. Pa mëdyshje, mund të thuhet se, ky aktivitet ka marrë dimensionin e një institucioni të shquar kulturor, i pa konkurruar gjer më sot në hapësirat kulturore shqiptare, aktivitet ky, ku takohen jo thjesht poetët e vendeve të ndryshme të botës, por para së gjithash, kulturat e popujve, si dëshmi komunikimi, njohjeje e stime reciproke.

Qiriri profetik i Naimit, kjo ikonë drite e shenjtëruar, stampuar kryeherazi dhe në logon e aktivitetit, simbolizon qartazi dritën që arrin të përcjellë Poezia e vërtetë, e ardhur kjo poezi prej të gjitha kohërave e të gjitha gjuhët. Në këtë dritë, janë blatimet, huret dhe flijimet më të thekshme e më sublime, që përcjell çdo gjuhë me pasuritë e veta të papërsëritshme. Ashtu si e ka shprehur Joseph Brodsky në fjalën e tij gjatë ceremon-

isë së dorëzimit të çmimit Nobel: të shkruarit e poezisë nuk është tjetër veçse në thelb rënie e poetit në varësi të gjuhës, si të thuash, rënie vullnetare në vargonjtë e saj. Dhe po të kemi parasysh atë që thoshte Hajdegeri se, gjuha është streha e qënies, atëherë merret me mend se çfarë shtresimesh pafund – qytetërimesh e përjetime brezash - janë të depozituara aty. Dhe poeti, është ai eksploratori i dalldisur që mrekullohet pas gjurmimit të tyre. T'i gjesh e t'i gjallërosh në poezi ato shtresa, apo grimca të tejçmuara, do të thotë t'i bësh që ato të dalin përfundimisht nga përgjumja e errësira, të rrezatojnë kështu kumte të lloj-llojshme, pra, të bëhen dritë. Drita e poezisë ka të atillë pushtet e fatësi të sofistikuar sa bën që edhe dhimbja, trishtimi, ndarja, ...të ndrijnë në errësi ... , siç shkruan poetja polake E. Lipske, fituese e çmimit letrar 'Naim Frashëri' në këtë edicion.

Festivale si ky i organizuar në Tetovë, kanë domethënie e rrezatim pa skaj. Kjo për arsye se, këtu, kanë marrë pjesë poetë nga hapësira mbarëshqiptare si: I.Kadare, F. Arapi, A. Podrime, D. Mehmeti. Xh. Spahiu, A.Tufa, B.Çapriqi..., por dhe të tjerë nga Gjermania, Franca, Britania e Madhe, Danimarka, SHBA, Kanada, India, Paraguaj, Rumania, Italia, Koreja e Jugut, India, Japonia, Izraeli, Tunizia etj. Kësisoj, ky festival ka përcjellë natyrshëm dhe jehonën e poezisë e të kulturës shqiptare në këto vende, në të katër anët e rruzullit. Përveç kësaj, me të gjitha antologjitë e botuara poetike të krijuesve pjesëmarrës, me cikle poezish dhe informacione kritike, është krijuar një bibliotekë e vyer dhe serioze, ku mund të hetohen tendencat dhe rrugëtimet estetike të poezisë së sotme botërore.

Nisur nga sfidat e vështirësitë, drejtori i këtij festivali, në valën e punëve të shumta e tensionante, i shkon në mendje gjatë çdo edicioni se ky do të jetë doemos i fundit për të. Por është edicioni i 14-të e ai vazhdon të mendojë e të punojë për të, me po atë ritmëm dhe ngazëllim si me të parin. Kjo mosbindje e

vetvetes, me sa duket ka lidhje me një lloj varësie të krijuar mes tij e këtij festivali, tashmë historik, e ngjajshme kjo me varësinë e sipërpërmendur të Poetit me gjuhën, me ligjërimin poetik.

30. 09. 2010

PORTAT HUMANE TË POEZISË

Ndue UKAJ

Kur përmendim termin letërsi, zakonisht mendja na shkon tek ajo formë e shkrimit, që i referohet shkrimit imagjnativ. Ky shpjegim i thjesht, vjen e komplikohet, sa herë shtrohen pyetjet komplekse, pse lexojmë, çfarë është letërsia, cili është roli i poezisë në domenin e letërsisë, së këndejmi, a ka mision letërsia dhe cili është misioni i saj në bashkësinë njerëzore? Këto pyetje, bashkëjetojnë me letërsinë, që nga zanafilla, ashtu sikurse edhe përgjigjet për to, mbeten gjithmonë të paplota.

Një nga shpjegimet domethënëse, që prek në thelb interesimet tona për letërsinë dhe që na ndihmon të kuptojmë më mirë letërsinë në universin tonë, në thellësinë ontologjike, është përkufizimi që i bën shkrimtari i mirënjohur italian Cesare Pavese, kur shkruan: “letërsia është mburojë prej sulmeve të jetës”. Letërsia, është mburojë prej sulmeve të jetës dhe jo vetëm kaq, ajo është udhërrëfyese, që ndihmon hapjen e portave të humanizmit, duke e ndjekur funksionin dhe misionin e katharsisit aristotelian.

Shkrimtari dhe dijetari i letërsisë, T. S. Eliot në librin Për kritikën, duke diskutuar për poezinë, dhe duke përthith botëkup-

timet e disa poetëve dhe kulturorlogëve pararendës, do të shkruan: “poezia është forma më e lartë e aktivitetit intelektual”.

Letërsia, nëpërmjet poezisë, si forma më e lashtë dhe më e lartë e komunikimit estetik, arrin të ngritet në piedestalin e lartësive olimpike dhe bëhet komunikim estetik universal, si kundërvënie ndaj të keqes, si reflektim dhe rikonstruktiv i realitetit estetik, nëpërmjet një gjuhe orakujsh, që zbret në thellësi të shekujve dhe mbledh nektarin e thesareve të përbotshme, për të sfiduar kështu një botë të trazuar. Në këtë mënyrë, poezia bëhet një shprehje profetike, që ndjek aspiratat e individit, në labirintet e shkrirjes së tij me kolektiven.

Qiriu poetik i Naimit, ky fanar i pashuar i shpirtit të poetit iluminist shqiptar, që digjej për të ndriçuar të tjerët, në një kohë të errët, siç ishte koha kur jetoi dhe krijoi ai, është përjetësuar në një formë tjetër, në Tetovë, nëpërmjet Festivalit Ndërkombëtar të Poezisë “Ditët e Naimit”, që tashmë disa vite rrezaton dhe ndriçon, në rrethana tjera dhe me funksione tjera.

Naimi i besonte dritës së qiriut. Ai i besonte faktit se një qiri i vogël, duhej të ndriçojë, duhej të digjej, që të triumfojë ndaj territ të madh. Naimi i besonte asaj drite që rrezaton dhe këtë dritë, si iluminist që ishte, kërkonte ta vinte në ballë të çdo aktiviteti. Pikërisht këtij fanari, i beson edhe Shaip Emërllahu, i cili, tash e afro dy dekada me Drejtorinë e këtij festivali, mbledh në Tetovë, poetë, shkrimtarë, kritikë të letërsisë, aktorë të skenës, piktorë nga e gjithë bota, që të rrezatojnë mirësinë e Qiriut të Naimit, atij qiriut që kuptimësinë e vet e gjen, vetëm kur shkrihet për të tjerët, kur bëhet dritërrëfyese, me dëshirën që të ndriçojë nëpërmjet letërsisë. Kjo kohë, e cila ngarend pas gjërave materiale, egoizmit, vuan kaq shumë për ngrohtësinë e qiriut poetik, e mirësisë poetike, për të bukurën, për estetikën dhe ndjeshmërinë humane.

“Ditët e Naimit”, është një institucion letrar dhe kulturor, që

tubon shkrimtarë dhe dashamirë të artit e poezisë, duke u bërë një formë e veçantë e ndërkomunikimit kulturor, e afrimit të kulturave dhe shkrirjes së tyre, në detin e madh të letërsisë së përbotshme, të së bukurës së përbotshme, për të cilën gjë ndjejmë nevojë të gjithë, ashtu sikurse ndjejmë nevojë për ajrin. Ne gjithë kemi nevojë të njohim botën më mirë, por edhe vetveten, prandaj në këtë njohje, poezia është një nga portat më të sigurta, për të kaluar barrierat e ndryshme. Në këtë mënyrë, poezia në Tetovë, e ngrit flamurin e mirësisë, përballë flamujve tjerë, që shpeshherë janë shndërruar apo dinë të shndërrohen në tragjedi për njerëzimin, e sidomos për këto pjesë të trazuara të Evropës.

Poezia, në shekullin e ri, kur globalizmi ka arritur fazën kulminante, gjithnjë e më shumë priret nga ky qëllim: ndërgjegjësimi para tallazeve të jetës, thirrjen për liri, përballë jolirisë. Poetët, janë ato qenie, që si orakuj, përpiqen të ruajnë ekuilibrat e nevojshme humane, në një kohë të zorshme, siç është kjo jona. Në të vërtetë, poezia nuk ka qëllim praktik në vete dhe shkrimtarët shkruajnë me qëllime parësore estetike, për të krijuar kënaqësi, mirëpo kjo nuk është krejt esenca e letërsisë. Në substratin e vet, arti dhe poezia, që nga zanafilla, kanë mision të shumëfishta në shoqëri dhe poetët janë ata që dinë t'iu përgjigjen sfidave të shoqërisë, duke dhënë përgjigje të ndryshme e profetike, për dilemat e përhershme që lidhen me jetën, metafizikën, Zotin, dashurinë, përjetësinë, moralin, njerëzimin, vendin tonë në kozmos, dilemat e mëdha për lirinë etj. Poetët, duke krijuar në një formë të veçantë, me një gjuhë të veçantë, me një gjuhë orakujsh, luajnë rolin e një "navigator" për njerëzimin. Arti dhe letërsia, kësajsoj kanë pasur gjithmonë funksione të shumëfishta në edukimin e njeriut, sidomos në edukimin estetik të tij dhe e ushqejnë njeriun, duke e pri nga idetë e bukura dhe sublime, sepse, siç do të thoshte studiuesi i ditur shqiptar Arshi Pipa: "Arti asht kulturë e si i tillë rolin edu-

kativ e ka në vehte...”

Ky festival i poezisë, që mbahet tash sa vite në Tetovë, është bërë një tribunë kulturore, që ofron kultura dhe shuan dallime, që bashkon poetë të gjuhëve të ndryshme dhe ul flamujt e ndarjeve.

“Poezia është kurora e letërsisë imagjorative, sepse ajo është një mënyrë profetike”- shkruan Harold Bloom. Ç’është e vërteta, poezia është më shumë se kaq, ajo është kurora e të bukurës, është shpirti më fisnik i njerëzimit, prandaj të vëmë këtë kurorë në kokën e njerëzimit, sot, është të ngrehim flamurin e mirësisë, si kundërvënie ndaj të keqes.

Çfarë e bën letërsinë kaq të fisme në hierarkinë e vlerave njerëzore, në mos një thirrje e saj e përhershme për lirinë e ndërgjegjes, për triumfin e së bukurës, për sendërtimin e një raporti human, mes qenies dhe subjektit, mes idesë dhe realizmit të saj në logosin e fjalës.

Poezia në çdo kohë dhe në çdo shoqëri, ka ushtruar ndikim në transformimin e bashkësisë njerëzore dhe ngritjen e vetëdijës qytetëruese. Në historinë e kulturës shqiptare, prijësit dhe etërit e kombit i kemi shkrimtarë, të cilët, përveç pasionit për letërsinë, kthehet në misionar të kombit, për ta shpëtuar atë. Mirëpo, nëse shkojmë më tutje dhe gjurmojmë thesare te vlerave të përbotshme, pa njerëzit e artit, bota do të ishte me shumë boshllëqe, boshe dhe shumë e varfër.

Poezia, që të luaj rolin e saj, duhet të ndërkomunikojë me lexuesin, audiencën dhe kritikën letrare. Këtë funksion, tash e disa vite, e luan në mënyrë të jashtëzakonshme, Festivali Ndërkombëtar i Poezisë, “Ditët e Naimit”, duke botuar antologjinë e poezisë së poetëve pjesëmarrës të Festivalit, duke përkthyer poetë nga gjitha vendet e botës dhe anasjelltas, si dhe duke organizuar takime poetike, tribuna diskutimesh, promovime, prezantime etj.

Sivjet, ky festival, mbahet në prag të 100 vjetorit të krijimit

të shtetit shqiptar, të çlirimit të shqiptarëve nga Perandoria Otomane. Historia e kombit shqiptar, është një histori kra-
jatash dhe përpjekjeve të pareshtura për liri. Në këtë betejë,
prinë gjithmonë shkrimtarët, duke qenë fanari i vetëm i pash-
uar, jo vetëm i ruajtjes së shkrimit shqip, por edhe protago-
nistë të drejtpërdrejtë të ideve kombëtare. Kujtojmë këtu, se
idetë e rilindjes, që rezultuan me formimin e shtetit shqiptar, u
formësuan brenda një shtrati të begatshëm kulturor. Prandaj,
manifestimi i sivjetshëm, ka një përmasë më të madhe shtesë
në këtë vit jubilar për shqiptarët.

Çfarë e karakterizon poezinë e laureatës së sivjetshme të
festivalit “Ditët e Naimit” Tua Forsström?

Ajo është poete e kohës, që ndjen dhe bashkëndjen me
gjitha drithërimat e bashkohësisë, prandaj në poezinë e saj,
hasim tensionet e kohës, trazimet e shekullit dhe depërtimin
ontologjike e të thellë në psiken ekzistenciale të njeriut të
kohës. Ajo shkruan një poezi, që ngërthen në vete ambivalenca,
ambiguitet, tension, ironi, paradokse, thirrje. Poetja evokon,
nëpërmjet një gjuhë të kondenzuar, ku mendimet latohen dhe
përplotësohen me shtresa semantike e stilistike. Poezinë e saj,
e karakterizon një dinamikë e veçantë shprehëse, ndërkaq sis-
temi i saj poetik, priret nga tipi i poezisë narrative, ku subjekti
krijues rrëfen, si një orakull. Poetja poezinë e koncepton në
tërësinë e saj, e realizon nëpërmjet një poetike të përpunuar
mjeshtërisht, ku metaforat luajnë rol të rëndësishëm në kon-
struktimin e idesë dhe imazheve, mendimit dhe fjalës, e ku
fjala rrjedh si në një lum i qetë, për t’u derdhur prajshëm në
një det të madh. Ajo shkruan një poezi që të rrëmben, që të
cyt në labirintin e një botë specifike, ku ajo ndjen çdo ditë, me
imazhet e natyrës, me referencat e mëdha të letërsisë.

Tua Forsström (1947), është zë specifik i letërsisë dhe një
nga poetët ma të rëndësishëm të Finlandës, e cila i përket mi-
noritetit suedez atje dhe shkruan në suedisht. Ajo projektton

një botë të ndërgjegjes, përballë asaj që e rrethon. Krijimtaria e saj letrare, ka një shtrirje të gjerë dhe ajo ka fituar çmimet të rëndësishme poetike në vendlindjen e saj dhe vepra e saj u përkthye në danisht, gjermanisht, anglisht, italisht, finlandisht, frëngjisht, holandisht dhe shqip.

Poezia e Tua Forsström-it shquhet për mendimin konciz dhe imazhet e shumta, që sjellin referencat e mëdha të letërsisë, duke dëshmuar letërsinë si një libër të madh. Poezia e saj, e realizuar me një dramacitet të thellë human, shquhet po ashtu për një humor të këndshëm. Libri me poezi, “Efter att ha tillbringat en natt bland hästar” (1997) “Pas kalimit të një nate në mes të kuajve” (2000), fitoi çmimin më prestigjioz letrar skandinav dhe u përkthye pastaj në danisht, anglisht dhe holandisht. Poezia e Tua Forsström, evokon dhe komunikon. Ajo është një shkarkim, një thirrje, një britmë, një psherëtimë, një apel, një revoltë dhe një dritërrëfim. Kështu, ajo synon të realizoj aspiratën e saj poetike, duke iu ba ballë, me ndjeshmëri poetike dhe dimension human, tallazeve dhe sfidave të kohës.

Festivali Ndërkombëtar i Poezisë “Ditët e Naimit”, i cili e ruan vazhdimësinë, tashmë disa vite, është bërë një vendtakim poezie, ku aterojnë poetë të njohur nga e gjithë bota dhe lexojnë, performojnë, përkthehen, lexojnë dhe komunikojnë. Deri më tani, në këtë festival të bukur, ku kam pasur fatin të marrë pjesë edhe unë si poet, janë lauruar ndër të tjerë, këta autorë të njohur, si: Ismail Kadare, Desmond Egan (Irlandë), Thomas Tidholm (Suedi), Manlio Argueta (Salvador), Abdellatif Laabi (Marok), Peter Poulsen (Danimarkë), Lionel Ray, (Francë), Eva Lipska (Poloni), Craig Czury (SHBA), Drazhen Katunariq (Kroaci), Moon Cnuhg Hee (Kore e Jugut) Erik Stinus (Danimarke) Diti Ronen (Izrael) etj. Po ashtu, në këtë festival, kanë defiluar dhe përfaqësuar në antologji, poetë të shquar mbarëshqiptarë, si Fatos Arapi, Rrahman Dedaj, Ali Podrimja, Din Mehmeti, Abdylaziz Islami, Rudolf Marku, Besnik Mustafaj, Basri Çapriqi,

Milazim Krasniqi, Sadik Bejko, Abdullah Konushevcu, Agron Tufa, Ervin Hatibi, Mario Belici, Kujtim Shala etj. Në këtë mënyrë dhe me këtë nivel të lartë të përfaqësimit, ky festival, po ndërton ura komunikimi mes poezisë të krijuar në gjuhë të ndryshme dhe brenda kulturave të ndryshme dhe po shndërrohet në një mozaik të bukur të aureolës së poezisë shqipe, duke u bërë një qiri që ndriçon.

PALIMPSESTI ARTISTIK I FESTIVALIT

Ramadan MUSLIU

Prezantimet e llojit antologjik zakonisht presupozojnë një zgjedhje nga krijimet poetike që duhet bërë, duke rindërtuar një koncept hipotetik autorial, që do të nxirte në pah qëllimin e zgjedhjes, arsyen pse pikërisht është zgjedhur ajo lëndë për prezantim para një lexuesi të supozuar si elitar e veçmas për ta afirmuar një botëkuptim estetik të përvijuar si kriter themelor i seleksionimit.

Antologjia e poezive të prezantuara në Edicionin e XVII, të Festivalit Ndërkombëtar të Poezisë “Ditët e Naimit”, brenda këtij koncepti është më shumë një prezantim panoramik, domethënë të poezive që kanë qenë në objekt të vëmendjes së publikut si një zgjedhje autoriale, duke presupozuar një përfaqësim më të plotë të profilit krijues të gjithsecilit poet. Pra, kemi të bëjmë me një nyje kronologjike, sepse është përzgjedhje e një festivali të një viti, i cili duhet të ofrojë një si pasqyrë të aktualitetit poetik të një hapësire më të gjerë, duke qenë se në të përfshihen poetë nga një gjeografi e gjerë letrare që janë mbledhur në një festival poetik, që në fakt është një homazh

artistik i një figure letrare me peshë kombëtare, çfarë është Naim Frashëri. Prandaj, kjo lloj antologjie, duhet marrë si një panoramë e një gjendjeje poetike, insert i një procesi poetik që lë mbresa të një mozaiku të krijimeve letrare të bashkuara në një mbrëmje leximi.

*

Antologjia e Festivalit sjell një gamë të gjerë poetësh nga hapësira të ndryshme kulturore. Po edhe qëllimi i Festivalit është që të ndërtojë ura ndërkomunikimi kulturor midis letërsisë kombëtare shqipe me atë nga Ballkani, Europa dhe bota. Poezia shqipe përfaqësohet nga krijues pothuajse i të gjitha pjesëve të gjeografisë kulturore shqiptare (Maqedoni, Shqipëri, Kosovë, Mal i Zi). Kjo poezi e përzgjedhur për Festival nga hapësira, orientime dhe individualitete të ndryshme mundëson një ballafaqim me modele poetike që autorët e ndryshëm sjellin nga Maqedonia, Kroacia, Sllovenia, Mali i Zi, Bullgaria dhe Turqia, si letërsi e truallit Ballkanik, që si koncept dhe mentalitet pothuajse është analog me atë shqiptare, po edhe një ballafaqim në një plan më të gjerë, europian: Franca (Athanasios Vantchev de Thracy), Italia (Giuseppe Napolitano), Belgjika (Germain Droogenbroodt), Holanda (Mischa Andriessen), Gjermania (Silke Blumbach), Polonia (Krystyna Lenkowska), Danimarka (Klaus Handberg Kristensen), me atë nga kontinentet e tjera, sikurse që ndodh me prezantimin e autorëve kanadezë (Stéphane D'amour dhe Françoise Roy), meksikanë (Laura Solórzano dhe Leticia Villagarcia), portorikan (Juan A. Franqui), kostarikas (Randal Roque), pakistanez (Waqhas Khawaja), ukrainas (Lesia Mudrak), Rati Saxena (Indi). Nëse këtij fakti i shtojmë edhe atë se, të gjitha këto individualitete poetike janë të periudhave të ndryshme, duke përfshirë autorët që edhe me vepër i takojnë pjesës së dytë të shekullit të kaluar, por edhe autorë që arritën të afirmohen gjatë dekadave të këtij

shekulli, atëherë mund të flitet për një, do të thosha, kronotopi po ashtu heterogjone e që doemos se do të hetohet edhe në ndeshje konceptesh dhe pikëpamjesh estetike. Nëse poezia duhet të jetë një plazmim i ndjenjës dhe i mendimit në një rrjedhë kohore, që cilësohet për konstruktin e veçantë psiko-social, atëherë doemos se, edhe poezia duhet të shprehë këtë kontradiktë që vjen nga dy kohë të ndryshme. Nëse poezia e shekullit të kaluar në thelbin e saj përmban njeriun e tëhualjsuar në botën e sendeve, të cilën Lukaçi dhe Goldmani e definojnë si proces të reifikimit, domethënë të identifikimit të personës me sendin, shekulli ynë solli shkallën e depersonalizimit të njeriut përbrenda, një lloj dekonspirimi shpirëtor dhe aq më keq, prirjen për ta mbikqyrur dhe urdhëruar emocionalisht dhe mendërisht nga mekanizmat e një teknologjie të sofistikuar deri në perfeksionizëm, atëherë poezia e re e manifeston deri në fund këtë individualitet të përvetësuar dhe gati se, të shndërruar në instrument.

Prandaj, thelbi i poezisë, që bën ballafaqim konceptual nga fakti se vjen nga hapësira dhe kohë të ndryshme, është shfaqja e këtij kontradiksioni të thellë, që herë merrë trajtën e një lamenti lirik, herë të një proteste të hapur, në veçanti, poezia e krijuar në këtë shekull, në raport me ironinë, por edhe konceptualizmin, por edhe lirizmin që e harron trajtën klasike në të shfaqurit përmes një artikulimi modern.

*

Tradita tashmë e gjatë e Festivalit ka krijuar fizionominë e vet dhe emblemën identifikuese. Brenda konceptit të formuar të Festivalit është edhe prezantimi i personalitetit referencial të të gjithë aktivitetit. Ky personalitet sivjet është poeti francez me origjinë bullgare Athanase Vantchev de Thracy, që siç thuhet në tekstin prezantues “është pa dyshim njëri nga poetët më të mëdhenj bashkëkohorë francezë”. Një autor që bën

një simbiozë të tipareve gjenetike thrako, bullgaro sllave, të vëna në pulsime brenda një konteksti poetik francez, s'ka se si të mos na kujtojë truallin e fermentimeve poetike botërore, që nga simbolizmi, parnasizmi e deri te surealizmi, që i ka dhënë formë dhe përmbajtje substratit botëror të poezisë. Në truallin e parajsës së poezisë, si është Franca, Athanasë Vantchev de Thracy jo vetëm arrin të kapë këto fermentime, por të jetë një katalizator i këtyre zhvillimeve, sepse poezia e tij mton të hedhë një hap më tutje në këtë zhvillim, duke imponuar arketipin e vet gjenetik në atë hapësirë poetike, ku trajtat e imazheve primordiale arrijnë të marrin kromatikë moderne, të jenë në korrent me kohën dhe kërkesat e marrësit aktual të poezisë në trend. Prandaj, në poezinë e tij ndeshim procesin e transformimit të modernes në një lloj specifik të trajtave postmoderne, por gjithnjë duke ruajtur konstruktin bazik, frymën thelbësore të klasikës nga është formuar inicialisht.

*

Panorama poetike e poezisë së Festivalit këtë vit dëshmon edhe mbi dukuritë që po fermentohen në ndërgjegjen estetike të krijuesit të sotëm. Jemi mësuar që në poezinë e përparshme të kërkojmë subjektin e rebeluar, domethënë shfaqjen e një shprehje poetike që manifeston qenien e zhvedosur nga pozicioni ekzistencial i saj dhe që ai rebelim gjen një artikulum përmes ironisë. Nuk është e habitshme pse njohësi i mirë rrjedhave të poezisë moderne, Hugo Fridrih, pas një shtegëtimi nëpër poezinë më të arrirë të modernes, të pohojë se ai vërtetë ndjehet më komod në poezinë klasike. Po tani që kemi një rizhvendosje të njeriut nga ai pozicion i përparshëm, veçmas me mundësitë që ofron teknologjia informatike dhe kompjuterizimi i skajshëm i jetës, ku jeta virtuale nuk ka dallim të madh nga ajo reale, cila do të jetë ajo ndjenjë e orientimit në këtë realitet të dyzuar? Si do të revolucionarizohet poezia që të ketë piketat

e veta që e ndajnë nga modelet pararendëse, siç do të thoshte poeti nga Puerto Riko, Juan A. Franqui.

Me të drejtë thotë poeti pakistanez Ēaqhas Khaëaja nga Pakistani, se “Poezia nuk është e pavërteta / thjesht: është një zambak / i gërthyer në një qepë -/e çmbështjell / shtresë pas shtrese / kurse të njomen sytë / derisa të arrijsh më në fund / në zhardhokun mashtrues.”

Po a mund të fshihet gjithë ajo trashëgëmi nga e kaluara që ka lënë gërmadhën aq të madhe sa nuk mund të levizet nga ajo? Prandaj poetjai kanadeze Françoise Roy më të drejtë thotë: “Pluhuri dhe baroti janë ende fjala jonë dhe testamenti ynë” në poezinë që ia dedikon poetit dhe kreatorit të Festivalit, Shaip Emërllahu, në poezinë “Lule lufte”. Nëse njeriu i përparshëm është dukur ajo qenia e katandisur në botën kiekegardiane, njeriu i sotëm nuk është as më shumë e as më pak se një karikaturë e personazheve kafkane dhe orveliane, ngase ai, edhe më është i depersonalizuar deri në atë masë sa është dekonspiruar nga brenda, dhe jo vetëm kaq, por është i dirigjuar edhe në emocion. Prandaj në këtë prezantim kemi një poezi që shpreh kaosin e brendshëm dhe përpjekjen për të qenë vetëvetja në një realitet që qind për qind është kundër tij. Këtë ndjenjë e fitojmë nga poezitë e Mischa Andriessen nga Holanda, Stéphane D’Amour nga Kanadaja, italianit Giuseppe Napolitano, etj.

Prandaj zëri i kësaj poezie është thelbësisht i një kromatike të errët, që vjen si një lloj ekspresioni që qëllimish do ta mbulojë pjesën mbizotëruese të spektrit me ngjyra të tjera që duken të vjetruara dhe jofunksionale.

*

Po poezia shqipe, cila është në këtë kontekst? Ajo paraqet një amplitudë të gjerë modelesh, nga shprehja klasike që shfaq elementet qenësore të një formimi të hershëm klasik, siç është

rasti me Sulejman Maton, e deri te konceptualizmi i poezisë së Agron Tufës. Midis kësaj lepezë varirojnë format e llojllojshme, si aftësia ironifikuese e poezisë së Shaip Emërllahut, ngase çdo gjë që prek e shndërron në një ironi specifike poetike, poezia e një shprehjeje mobilizuese dhe ndërgjegjsuese në planin kolektiv e Hajredin Kovaçit, shpalosjes së hartës poetike urbane dhe të lirikave të Ndue Ukajt, drama ekzistenciale e njeriut që ka humbur rrugën në labirinthin e jetës të poezisë së Olimbi Velajt, etj.

Me një fjalë, poezia shqipe dëshmon praninë e shumësisë së modeleve sa edhe lidhjen me traditën, qoftë në planin e formave e aq me shumë në vetëdijën mbi fenomenet e jetës dhe vetë kohës si kategori dhe forme e eksistencës së njeriut.

*

Poezia e prezantuar në Festival dhe e përfshirë në këtë botim, si me shtrirjen e saj, nga poezia nacionale deri te ajo ndërkontinentale, si për funksionin e saj, jo vetëm si përfaqësuese e një momenti të procesit letrar – poetik, por edhe të komunikimit të drejtpërdrejtë me recipientin (dëgjues, lexues), si për nxitjen e urave të ndërkomunikimit të kulturave, bën një thyerje të stereotipit tradicional që presupozon përkthim-botimin e poezisë pa praninë e autorit, duke e riaktualizuar jo vetëm tekstin autorial, por edhe fizikun e autorit, komunikimin e drejtpërdrejtë, ku mesazhi i aritikuluar poetik bëhet më veprues. Prandaj, poezia në gjithë plotësinë e programit të Festivalit duket si një palimpsest, një teksti i rishkruar për të mbajtur mend si porosi e fundit por, që nuk e harron tekstin pararendës, atë inicial, kujtesën për rilindasin shqiptar, Naim Frashërin, gurthemelin e poezisë shqipe.

T'I JAPËSH EMRIN TËND, NJË YLLI...

Visar ZHITI

Sido që të duket dhe sado të kujtojmë se harrohet, - e kam fjalën për poezinë, - shekulli, që gjithmonë është më modern se paraardhësi, me shpejtësitë marramendëse që ka, që ua ka përcjellë gjërave dhe dukurive, ku çuditë shkencore dynden mbi të përditshmen duke e përthithur kohën e gjithsecilit me përbindshmërinë e Kronosit, në fund të fundit brenda njeriut mbetet diçka e ëndërrt, e përhershme dhe e pazvëndësueshme me asgjë, ku fjala, e krijuar në mijëvjeçarë që nga shpellat dhe deri në metropolet, që nga pergamena e deri tek kompjuteri, arrin të shndërrohet në poezi me kumte shpirti e duf jete.

Dhe ajo, poezia e njeriut kështu, vazhdimisht e ka paraprirë ecjen, si dëshirë dhe vegim, me flatra të padukshme drite dhe hijeje dhe ka mbërritur e para atje ku do të donim të ishim.

Shkurt, është ulur poezia e para në vendet ku kanë zbarkuar më pas shkencat dhe teknika, patjetër dhe artet e tjera...

Në fantazinë poetike të njerëzimit gjithçka ka qenë në zanafillë ndjesi ngacmuese për vazhdime ndryshe, shtesa e përmirësime të vetë realitetit. Ja, ashtu si qilimi fluturues i për-

rallave që ndolli aeroplanin...

.....

Po e ndërpres përsiatjen, se më bëhet se dëgjoj uturimë avioni, që largësia dhe imazhet qiellore e shndërrojnë në një si recitim universi, ku futen re dhe flatra, rreze, ylberë, psherëtime horizontesh, po, po, se mbahet Festivali, tashmë tradicional, i Poezisë në Tetovë dhe në aeroportin e Shkupit, nëpër stacione, mes udhëtarëve të shumtë, zbresin poetë më tepër se në sezonet e tjera. Priten nga miqtë dhe me taksì, vetura, autobus, motoçikleta nisen për atje, ku janë ftuar, si në çdo tetor.

Poetët nga bota kërkojnë të dinë më shumë për Poetin Kombëtar të shqiptarëve, Naim Frashëri, emrin e të cilit mban ky festival dhe duan t'ja shqiptojnë sa më drejt, ndalin para shtatorës së tij dhe sheshi përreth sikur mbushet me barin e blertë të metaforave...

Drejtori i Festivalit, poeti dhe studiuesi Shaip Emërllahu, duket se ka marrë porosinë e Naimit dhe, teksa ka ndezur qirin e tij simbolik mbi skrivani dhe ka hapur librin e madh dhe me pendën naimiane në dorë ka shkruar emrat e poetëve, të qëmtuar nga të 5 kontinentet, të atyre që sapo kanë ardhur të marrin pjesë në edicionin e 18-të të Festivalit, rishtarë, por dhe që kanë bujtur më parë këtu, një herë, dy apo më shumë, të miqësuar tashmë me Festivalin dhe Tetovën, që do të duan të vijjnë sërish.

Lexohen poezi, takohen poetë, bisedojnë dhe tregojnë, vizitojnë Universitetin shqiptar të Tetovës, i ngritur me mund, sakrifica e gjak.

Ndodh të ulen në një tryezë autorë, vendet e të cilëve janë në armiqësi me njëri-tjetrin, apo që nuk e njohin siç ndodh me Kosovën apo janë dhe në luftë midis tyre e poezia ndjell paqen, që do të vijë patjetër, spraps urrejtjet e dëmshme, mbjell mirëkuptimin e bukur.

Secili sjell diçka nga vendi i vet, aroma jete, profile të blerta

dëshirash, rrugëtime fatesh, përpjekje e trishtime njerëzore, plagë dhe gjak... të pasqyruara prajshëm apo shqetësueshëm tek fjala e gjuhës së secilit, por që nuk krijohet më Babilonia e vjetër, por Tetova e re. Një si metropol poezie.

Antologjitë e përvitshme të Festivalit shtohen në bibliotekat tona. Janë poezi nga bota, të gjuhëve të ndryshme, por tani të gjitha në gjuhën shqipe, “në gjuhën e perëndive” siç besonte Naimi dhe gjithë rilindësit tanë.

Naimi e dëshironte bashkëbisedimin poetik, ja ashtu me dorë në zemër, jo vetëm me lexuesin shqiptar, por dhe me fqinjët ballkanas dhe ende më gjerë, në kontinent e më tej. Prandaj dhe shkruante poezi dhe në greqisht, në gjuhën homerike, dhe në persisht, poezinë e të cilëve e çmonte shumë për shpirtin, por më e kultivuar i dukej poezia perëndimore dhe u thoshte shqiptarëve se “lind ku perëndon”. Dhe të tjerëve donte t’u tregonte për shqiptarët dhe trojet e tyre, për lashtësinë e dashamirësinë proverbiale. Dhe kërkonte si panteist dashurinë.

Ky festival, si të thuash, vazhdon dhe bën realitet, ja ashtu urtshëm, profecinë naimiane, duke mbledhur poetë në sofrën tetovare të poezisë, duke e zgjeruar edhe më komunikimin shqiptar me poezinë e botës.

Çdo vit Festivali vlerëson një nga të ftuarit me emrin e Naimit dhe të tjerë me çmime të tjera, sikur përndeç kështu entuziazmin, hedh prarime të qirinjtë të poezisë mbi gjindjen.

Kjo sikur i jep më solemnitet veprimtarisë, autorëve të pranishëm dhe dëgjuesve të tyre në sallën e madhe të teatrit të qytetit, aq sa, më pëlqen të kujtoj, se fituesi i vjetshëm, bullgaro-francezi Athanase Vantchev de Thracy botoi një libër të veçantë në Francë me poezi kushtuar të gjithë fituesve të mëparshëm, duke krijuar një poemë përbashkuese shpirttrash dhe imazhesh, me kumbime silabash të takimit, shkak i së cilës ishte Tetova jonë.

Me jehonë të brendshme më të gjerë janë dhe antologjitë e

veta që boton ky Festival, tashmë i shndërruar në një institucion, që meriton vëmendje dhe mbështetje të mëtejshme të institucioneve të shtetit.

Dialogu është shndërruar në poezi. Dhe sa më shumë jetë të sjellin poetët me poezitë e tyre, aq më shumë dhe poezia do të futet në jetë, përtej jetëve të tyre, në lexues dhe breza. Se jetët ia përcjellin njëra-tjetrës poezinë e jetës.

Në fund të fundit këtu mbahet një festival poezie, ku shpallosen emocione artistike, forma dhe ritme, metafora të befta, të ardhura nga thellësitë dhe nga larg, ngërthehen zëra, qetësia me të furishmen, shqetësimet me vegimtare, konfliktet me paqen, modernia vazhdon klasiken dhe i rikthehet ndryshe, vërtet “Ditët e Naimit” këtu i ngjanë një shkolle ku të gjithë jemi mësues dhe nxënës, poetë dhe dëgjues dhe rizbulojmë se poezisë i mjafton vetvetja, si bukuri dhe identitet, harmoni me veten dhe botën dhe që ajo, poezia, do ta shoqërojë njeriun deri në fundin pa fund.

Ndërkaq, mund të vazhdojmë të themi që Tetova bën festivalin e mirëkuptimit të lartësuar në dashuri njerëzore.

Dhe nuk është rastësi që fituesi i sivjetshëm i Çmimit “Naim Frashëri” u përzgjedh poeti italian Sebastiano Grasso, këngëtar modern i dashurisë. E përditshmja e njeriut, çastet e saj, ai dëshiron që të shndërrohen në poezi dhe fuqia e dashurisë duket sikur e çon këdo nga rrugët e zakonshme plot me vetura në qiejt me pegas.

T’i japësh emrin tënd një ylli...

shkruan ai në njërën nga poezitë e zgjedhura për në Tetovë. Ja pra, poeti që prek yjet me dorë, shumë më përpara se atje të shkojnë anijet kozmike, i jep secilit nga një yll dhe le t’i pagëzojnë me emra dashurie.

Dhe Tetova sikur shton konstelacione të reja në qiellin e saj,

mbi malet e Sharrit, nga erërat e të cilit vërshon ajër i pastër, nga ai që u bënte mirë mushkërive naimiane të poezisë, sjell ujëra të ftohtë e të kulluar, që ujin epitetet e risive.

Poetët e botës, që bujtën në Ditët e Naimit, marrin me vete diçka nga Tetova dhe e çojnë në vendet e tyre ashtu si një suvenir, një mbresë, një imazh mbrëmjeje, si mjekër e poetit apo agu si profeci mirësie, mjegull dhe mikpritje, biseda me diell, ndonjëherë bie dhe borë e butë si heshtje e bardhë, e mbar-tin si melodi, po kështu një copëz rruge tetovare, aulat universitare, bekimin e selisë bektashiane, urat që të çojnë në një zemër tjetër, buzëqeshjet... njohën shqiptarë, tani do t'i duan më shumë... dhe në përmbledhjet e ardhshme me poezi që do të dalin në vendet e tyre e gjuhët e tyre, mbase njëra nga poezitë a më shumë si varg të fundit do të kenë: Tetovë, Ditët e Naimit, 2014

KULTURA BOSHTI KRYESOR I NJË POPULLI

Reshat SAHITAJ

Festivali Ndërkombëtar i Poezisë « Ditët e Naimit », gjatë këtyre dy dekadave ka arritur që t'ï bashkojë një numër të madh krijuesish vendorë dhe ndërkombëtarë më renome botërore, të cilët i dhuronin publikut dhe lexuesit tonë vargjet e tyre që burojnë nga thellësia e shpirtit, e të skalitur në mendjën dhe vetëm me pendën e artistit.

Letërsia shqiptare është shumë e vonshme, po të krahasohët me letërsinë e popujvet të tjerë. Mirëpo, gjatë kësaj kohe të shkurtër ekzistojnë një numër i madh krijuesish që janë përkthyer në gjuhë të huaja. Bartësi dhe përfaqësuesi i letërsisë sonë në botë është shkrimtari Ismail Kadare, i cili përmes veprave tija, bëri që Shqipëria dhe kultura jonë të njihet në çdo kontinent. Letërsia jonë edhe pse shumë e vonshme në atdhe, rrënjët e krijimtarisë i ka të autorët me origjinë shqiptare në shumë vende të botës, dhe prej tyre emra botëror që fituan çmimin Nobel për letërsi. Nuk duhet të merret tendencioze nëse themi dhe konfirmojmë përmes dokumenteve historike se një pjesë e madhe e autorëve antikë të Greqisë janë me origjinë shqiptare dhe se « liliada » e Homerit është shkruar në ver-

zionin origjinal i ka mbi pesëmijë fjalë ilire.

Të gjithë krijuesit vendorë dhe ndërkombëtarë të cilët ishin pjesëmarrës në edicionet e mëparëshme “Ditët e Naimit”, në këtë hapësirë deklamuan fjalët më të bukura artistike të tyre të thurura në vargje, të cilat u grumbulluan dhe u sistemuan duke na e mundësuar që prej tyre të ngrejmë lartë permendoren e poezisë, që po vazhdon të ndërtohet me fjalët dhe gjuhët e popujve të mbarë botës, e cila do t’i qendrojë shekujve dhe do t’i shërbejë gjeneratave të ardhëshme, duke e përçarur mesazhin se, vetëm kultura është ajo e cila i bashkon popujt pa dallim race e gjinie, pa dallim religjioni e partie, pa dallim moshe e posti qeveritar. Kultura është boshti dhe ambasadori më i mirë i çdo shteti dhe populli.

Festivali Ndërkombëtar i Poezisë «Ditët e Naimit», ka filluar para dy dekadave në kushte shumë të vështira politike dhe ekonomike që asokohe e kishte kapluar hapësirën ballkanike, që askujt apo pakujt do i shkonte ndërmend për themelimin e një festivali të poezisë siç e kishte vendosur poeti dhe profesori Shaip Emërllahu, që në thellësinë e shpirtit të tij buronte dashuria për fjalën e shkruar artistike. Për t’u ngritur një festival i tillë, siç është Festivali Ndërkombëtar «Ditët e Naimit», drejtori Shaip Emërllahu është dashur të sfidonte pengesa të shumta të natyrave të ndryshme, që nuk kishin të bënin asgjë më poezinë dhe që kishin të bënin me poezinë. Më një përkushtim të pa krahasueshëm dhe më një dashuri ndaj artit dhe popullit, Shaip Emërllahu dhe ekipi i tij arritën që për më shumë se njëzetë vite të ngrehin tempullin që quhet Festivali Ndërkombëtar i poezisë «Ditët e Naimit» që aktualisht njihët si njëri ndër festivalët më të mëdha të poezisë në bote. Viktor Hygo (Victor Hugo) shkruante se «Poezia e një populli është elementi i progresit të atij populli». Shaip Emërllahu i brumosur më dy dashuritë; në dashurinë ndaj poezisë dhe në dashurinë ndaj popullit, do t’i tejkalonte të gjitha pengesat vetëm e

vetëm që poezia e popullit të tij të kalonte hapësirat shqiptare, dhe letërsia që zhvillohej në botë të depërtonte edhe në këtë pjesë të Ballkanit që dikur ishte djepi i civilizimit botëror.

Festivali Ndërkombëtar i Poezisë «Ditët e Naimit», është një udhëkryq i rëndësishëm i zhvillimeve letrare, jo vetëm për krijuesit vendorë, por për të gjithë poetët e mbarë botës, të cilët vit pas viti takohen në Tetovë duke na sjelle krijimet e tyre poetike më të mira, që bashkarisht t'i përjetojmë ato vargje, që bashkarisht t'i gëzohemi të arriturave të secilit prej nesh në këtë fushë të imagjinatës së krijuesëve te te gjitha kontinenteve.

Grumbullimi i poetëve në Tetovë gjatë Festivalit Nderkombetar te Poezise «Ditët e Naimit», është një pasurim shumëdimensional për të gjithë pjesëmarrësit ndërkombëtar dhe vendorë, sepse këtu gërshetohen kultura të ndryshme të vendeve më pak të zhvilluara, e më shumë të avancuara në letërsi, e të gjithë bashkë e përbëjnë një strumbullar të çmueshëm, i cili pastaj përçon mesazhe poetike në katër anët e globit. Poezia ndër artet më të bukura, i ka bashkuar në Tetovë në Festivalin Ndërkombëtar të Poezisë «Ditët e Naimit», jo vetëm thjeshtë poetët, por krijuesit e shumë vendeve të botës të cilët shpirtërisht janë hyjnorë siç shkruante Apollineri (Apollinaire)« Poezi e brishtë! Më e bukura art ndër artet! Ti që na nxitë pushtetin kreativ, na afron afër Hyjnisë”.

Në pamje të parë poetët nuk dallojnë prej njerëzve të thjeshtë, mirëpo në thellësinë e shpirtit të tyre ekziston një vullkan imagjativ krijues, i cili vlon brenda për brenda vetes duke mos e lënë poetin të bëjë gjumë të qetë siç bëjnë të tjerët, e as të bisedojë siç flasin të tjerët sepse dashuria për poezinë dhe inspirimi që akumulohët duhët të shperthejë për t'u shkruar në letër e të marrë dhenë. Sjelljet, qëndrimet dhe dashurinë e poetit e kuptojnë vetëm krijuesit, ndërsa për të tjerët krijuesit janë të pakuptueshëm. Në këtë tempull të po-

ezisë “Ditët e Naimit”, për çdo vjet mblodhën shpirtërat më të sinqertë hyjnorë, ku secili në mënyrën e tij përmes vargjeve brilante kontribuojnë në këtë fushë të letërsisë që e stolisin me perlat më të çmueshme të shumë shteteve dhe popujve të mbarë botës.

Festivali Ndërkombëtar i Poezisë “Ditët e Naimit”, ka për qëllim që t’i tubojë për çdo vjet një numër të madh poetësh të vendeve të ndryshme të botës, në mënyrë që poetët vendorë të njihën më zhvillimet kulturore në botë si dhe anasjelltas, krijuesit e huaj të informohen më kulturën dhe letërsinë shqiptare. Kontaktët sistematike që krijohen gjatë këtij festivali, kanë rendësi të veçantë, sepse shkëmbehen pervoja dhe stile të ndryshme që e pasurojnë njëri-tjetrin, nga se poezia nuk është art që qëndron në një vend, por ajo evoluon dhe pëson ndryshime të vazhdueshme, gjë që këtë art e bën të gjallë e të lëvizshëm drejt përsosshmërisë. Me plot të drejt mund të thuhet se, Festivali Ndërkombëtar i Poezisë “Ditët e Naimit”, është një urë e shtrirë horizontalisht që i grumbullon vlerat dhe autorët, poezitë dhe poetët, një urë që i lidhë shtetët dhe popujt e që kontribuojnë dukshëm jo vetëm në letërsi, por edhe në afrimin dhe bashkimin e krijesëve botëror.

Festivali ndërkombëtar “Ditët e Naimit”, çdo vit ndan disa cmime letrare. Disa prej tyre bartin edhe emrin dhe figuren e poetit tone kombetar. Cmimi letrar “Naim Frashëri” më të cilin shpërblehet çdo vjet një poet, është ndër çmimet më prestigjioze të këtyre trevave ballkanike dhe jo vetem. Në këtë konkurrencë tepër të madhe defilojnë emra shumë të respektuar dhe të rendësishëm në letërsinë botërore, ne mesin e te cileve edhe kandidatet për cmimin Nobel.

Festivali Ndërkombëtar i Poezisë “Ditët e Naimit”, gjatë këtyre dy dekadave më batica e zbatua qëndroi mbi themelet e veta, duke i përforcuar ato çdo vit me vargjet e bukura dhe duke i thyer të gjitha kufizimet e kufijve gjeografik, për ta ndërtuar

një hapësirë të pakufishme në këtë planet më një gjuhë të përbashkët që quhet poezi, e njërzitë që e flasin këtë gjuhë quhen Poetë. Krijuesit kanë shpirtin e pastër, që nuk njohin sisteme nënshtruese, por zërin e tyre të artikuluar përmes vargjeve e drejtojnë kundër çdo padrejtësie që ushtrohet mbi cilindo popull. Në imagjinatën e poetit nuk ekzistojnë padrejtësitë, shtypjet e torrturat, sepse për shpirtëra të tillë jeta është e barabartë për të gjithë njerëzit e këtij planeti. Nga mendja dhe fjalori i poetit rrjedh vetëm dashuri, paqe, tolerance dhe harmoni, e që të gjitha këto shprehen përmes vargjeve të secilit nga ju.

Prishtine, 9 tetor 2017

PËRMBAJTJA

| | |
|--|-----|
| EDICIONET E PARA TË ISTORI E SHQIPËRISË DHE SHQIPËRIA NGA NAIM FRASHËRI JANË BOTUAR NË SOFJE, BULLGARI..... | 5 |
| THE FIRST EDITIONS OF ALBANIAN HISTORY AND ALBANIA FROM NAIM FRASHERI ARE PUBLISHED IN SOFIA, BULGARIA..... | 9 |
| ПЪРВИТЕ ИЗДАНИЯ НА ИСТОРИЯ НА АЛБАНИЯ И АЛБАНИЯ НА НАИМ ФРАШЕРИ СА ОТПЕЧАТАНИ В СОФИЯ..... | 13 |
| JETOJMË NË NJË BOTË KAOSI DHE HUMBJEJE TË KUPTIMIT..... | 18 |
| NOUS VIVONS DANS UN MOND DE CHAOS ET DE PERTE DE SINGIFI- CATION..... | 21 |
| FESTIVALI I POEZISË “DITËT E NAIMIT” MIRËPRET POETET ME TË NJOHUR BOTËROR..... | 24 |
| SIKLI BUKURIA I NAIM FRASHËRIT..... | 29 |
| KODIFIKIMI POETIKO-ESTETIK..... | 29 |
| TESTAMENTI POETIK I NAIMIT..... | 36 |
| ‘DITËT E NAIMIT’ – MODEL I NDËRKOMUNIKIMIT..... | 41 |
| BASHKËKOHOR LETRAR E KULTUROR..... | 41 |
| “DITËT E NAIMIT – A MODEL OF CONTEMPORARY LITERARY AND CULTURAL INTERCOMMUNICATION..... | 49 |
| KOMUNIKIMET NDËRKULTURORE – SI KALEIDOSKOP I NDËRHAPË- SIRËS..... | 51 |
| КУЛТУРНИТЕ ИНТЕРКОМУНИКАЦИИ – КАКО КАЛЕИДОСКОП НА МЕГУПРОСТОРОТ..... | 57 |
| POEZI, MAGJI DHE DETYRAT E REJA..... | 63 |
| POETRY, MAGIC AND NEW TASKS..... | 65 |
| NAIM FRASHËRI: POET LIBERAL DHE LUFTËTAR KOMBËTAR..... | 67 |
| NAIM FRASHERI: LIBERAL POET..... | 75 |
| AND NATIONALIST FIGHTER..... | 75 |
| NAIM FRASHËRI DHE POEZIA TAJVANEZE..... | 83 |
| NAIM FRASHËRI AND TAIWANESE POETRY..... | 87 |
| FËSHFËRIMA E NDËRKOMUNIKIMIT..... | 91 |
| FESTIVALI NDËRKOMBËTAR I POEZISË “DITËT E NAIMIT”- SHEMBULL I NDËRKOMUNIKIMIT KULTUROR E LETRAR..... | 100 |

| | |
|--|-----|
| IL FESTIVAL INTERNAZIONALE DI POESIA “DITËT E NAIMIT”: | 103 |
| ESEMPIO DI INTERCONNESSIONE CULTURALE | 103 |
| FESTIVALET INTERKOMUNIKIM ME VLERA NDËRKOMBËTARE | 108 |
| NAIM FRASHËRI, FANARI I KULTURËS SHQIPTARE | 121 |
| NAIM FRASHËRI, THE LIGHT OF ALBANIAN CULTURE | 127 |
| METAFIZIKA E VERBËRISË NË LETËRSI. NIELS HAV DHE TEKSTI POETIK PALIMSEST. | 133 |
| THE METAPHYSICS OF BLINDNESS IN LITERATURE - NIELS HAV AND HIS PALIMPSESTIC POETIC MESSAGES. | 141 |
| ROLI DHE RËNDËSIA E FNP “DITËT E NAIMIT” | 150 |
| NË AFIRMIMIN E VLERAVE UNIVERSALE POETIKE | 150 |
| DHE TË KULTURAVE TË POPUJVE | 150 |
| KOMUNIKIMI POETIK SI UTOPI DHE VIZION | 156 |
| GJASHTËMBËDHJETË HERË – MALL PËR KULTURËN BOTËRORE | 159 |
| MBIJETESA E POEZISË | 164 |
| DRITA E POEZISË... | 167 |
| PORTAT HUMANE TË POEZISË | 170 |
| PALIMPSESTI ARTISTIK I FESTIVALIT | 177 |
| T’I JAPËSH EMRIN TËND, NJË YLLI... | 183 |
| | 188 |
| KULTURA BOSHTI KRYESOR I NJË POPULLI | 188 |

‘DITËT E NAIMIT’ DHE POETI KOMBËTAR NAIM FRASHËRI

‘DITËT E NAIMIT’ AND THE NATIONAL POET NAIM FRASHËRI

Boton:

Manifestimi Letrar Ndërkombëtar
“DITËT E NAIMIT” - Tetovë

Drejtor: Shaip EMËRLLAHU

Lektor: Shefki JASHARI

Korrektor: Ekrem AJRULI

www.ditetenaimit.org

Botimin e ndihmoi
Ministria e Kulturës e R. së Maqedonisë

Tirazhi: 1000 kopje

82-1:7.079(497.751):316.722(062)

325.83-05Фрашери, Н.(062)

821.18-1.09Фрашери, Н.(062)

FESTIVALIT ndërkombëtar të poezisë “Ditët e Naimit” (20 ; 2016 ; Tetovë)
“Ditët e Naimit” dhe poeti kombëtar Naim Frashëri : (ndërkommunikimet kulturore) = “Ditët
e Naimit” and the national poet Naim Frashëri : (cultural Intercommunications) / [redaktor:
Shaip Emërllahu]. - Tetovë : Ditët e Naimit, 2017. - 193 стр. ; 21 см. - (Biblioteka Hejza)

Konferenca shkencore: 20 vjet festival mbajtur më, (21 tetor 2016) në kuadër të edicionit
të XX të Festivalit ndërkombëtar të poezisë “Ditët e Naimit” --> преднасл. стр. - Дел од
трудовите со напореден превод на англ. јазик

ISBN 978-608-4769-09-5
COBISS.MK-ID 104444170